VLERËSIMI I PËRPJEKJEVE TË MAQEDONISË NË KUNDËRVËNIEN NDAJ EKSTREMIZMIT TË DHUNSHËM, PIKËPAMJE NGA SHOQËRIA CIVILE



Autorë:
Kaltrina Selimi
Filip Stojkovski

Ky projekt është pjesërisht i mbështetur me grant nga Ambasada e SHBA-ve. Mendimet, zbulimet dhe konkluzionet ose rekomandimet e paraqitura këtu janë të implementuesit/autorëve dhe nuk i reflektojnë domosdoshmërisht ato të Qeverisë së SHBA-ve.

Shkurtesat e përdorura:

KEDH – Kundërvënia ndaj Ekstremizmit të Dhunshëm

BFI – Bashkësia Fetare Islame

Shënim: Ky raport në formën e tij origjinale është shkruar në gjuhën angleze

PËRMBAJTJA

Hyrje 5

1. Metodologjia dhe përmbajtja 7

2. Konteksti 9

2.1 Luftëtarët e huaj 10

2.2 Ekstremizmi i dhunshëm me rrënjë në Maqedoni 11

2.3 Qytetarë maqedonas të dënuar jashtë vendit 13

2.4 Agjenda më e gjerë 14

3. Kundërpërgjigjia ligjore dhe institucionale 16

3.1 Definimi i kundërvënies ndaj ekstremizmit të dhunshëm / Parandalimi i ekstremizmit të dhunshëm 16

3.2 Korniza ligjore për kundërvënie ndaj ekstremizmit të dhunshëm në Maqedoni 17

3.3 Përgjigjia institucionale 19

3.3.1 Ministria e Punëve të Brendshme 19

3.3.2 Drejtoria për Siguri dhe Kundërzbulim (DSK) 19

3.3.3 Organi koordinues shtetëror kundër terrorizmit 20

Operacioni “Celula” 22

Operacioni gjyqësor “Celula” 23

3.3.4 Agjencioni i inteligjencës 26

3.3.5 Misioni i OSBE-së në Shkup 27

3.3.6 Ministria e Punëve të Jashtme 28

3.3.7 Bashkësia Fetare Islame (BFI) 29

3.3.8 Organizatat e Shoqërisë Civile (OShC) 30

3.3.9 Komunat lokale 30

4. Bashkëpunimi rajonal 31

4.1 Dimensioni rajonal i çështjes 33

4.2 Kundërvënia ndaj ekstremizmit të dhunshëm në Ballkan 35

4.3 Bosnja dhe Hercegovina 37

4.4 Kosovë 38

4.5 Shqipëria 42

5. Risocializimi dhe riintegrimi 45

6. Pikëpamje nga rajoni-me fokus kryesor në qytetet e Shkupit, Kumanovës dhe Tetovës 51

6.1 Shkup 56

6.2 Kumanova 63

6.3 Tetova 65

Përfundime 68

Rekomandime 70

Hyrje

Siç rriteshte intensiteti i luftës në Siri dhe numri i luftëtarëve të huaj nga Evropa ishte në rritje të sipër në vitet 2012 deri më 2015, shumë studiues dhe praktikues të fushës paralajmëronin për reperkusione të mundshme në rendin shoqëror kur luftëtarët e huaj do të fillonin të ktheheshin në shtëpi. Zyrtarë madje kanë identifikuar edhe se disa nga sulmuesit në sulmet terroriste në Paris më 13 nëntor 2015 dhe në Bruksel më 22 mars 2016, kanë qenë ish-luftëtarë të huaj[1]. Në vitin 2015, 687 të dyshuar janë arrestuar për terrorizëm fetarisht të frymëzuar në EU.[2]

> *Vendet anëtare duhet të jenë në përputhje me të drejtën ndërkombëtare, të parandalojnë "rekrutimin, organizimin, transportimin ose pajisjen e individëve të cilët udhëtojnë në një shtet tjetër nga shteti ku jetojnë apo kombësia për qëllimin e kryerjes, planifikimin ose pjesëmarrjen në akte terroriste apo dhënien ose marrjen e trajnimit për terrorizëm, ashtu si dhe financimin e udhëtimit të tyre apo të aktiviteteve të tyre.*
>
> *Rezoluta 2178, Këshilli i Sigurimit i OKB-së*

Kjo nuk vije si surprizë kur ekspertë të mirënjohur të terrorizmit, si Thomas Hegghammer kanë pohuar se "Siria do ta prolongojë problemin e terrorizmit xhihadist në Evropë për 20 vite," duke paralajmëruar se edhe po qe se norma e reperkusionit do të ishte e ulët, "numri absolut i sulmeve do të ishte thelbësor."[3]

Për të ilustruar dimensionin global të problemit të luftëtarëve të huaj, OKB-ja ka renditur luftimin e kësaj dukurie si një nga prioritetet e saj më kryesore. Kjo është e ekspozuar në miratimin e Rezolutës 2178 (2014) nga Këshilli i Sigurimit i OKB-së, ku ekstremizmi i dhunshëm është dënuar dhe masa veprimi janë propozuar për ta trajtuar atë. Përmes saj u bëhet thirrje vendeve anëtare të OKB-së për të siguruar rritjen e sigurisë kufitare dhe për të vrojtuar apo për të arrestuar luftëtarë të huaj që udhëtojnë ose që kthehen nga zonat e konfliktit. Në mënyrë kritike, ajo gjithashtu u kërkon shteteve të luftojnë ekstremizmin e

[1] New York Times. 'Uncovering the links between the Brussels and Paris attackers' (Duke i zbuluar lidhjet ndërmjet sulmuesve të Parisit dhe Brukselit). 9 prill, 2016. së fundi here e lexuar më 19 korrik, 2016. Gjendet në: http://www.nytimes.com/interactive/2016/03/23/world/europe/how-the-brussels-and-paris-attackers-could-be-connected.html

[2] Europol. "TE-SAT 2016. 20 korrik 2016. Së fundi here e lexuar më 21 korrik 2016. Gjendet në: https://www.europol.europa.eu/content/european-union-terrorism-situation-and-trend-report-te-sat-2016

[3] "Europe could feel the backlash from jihadist conflicts" (Evropa mund ta ndjejë reagimin nga konfliktet xhihadiste). BBC. 30 nëntor 2013. Së fundi here e lexuar më 20 nëntor 2015. Gjendet në: http://www.bbc.com/news/world-middle-east-25155188

dhunshëm, duke marrë masa parandaluese, të tilla si angazhimin me komunitetet në nivel lokal për të ndaluar përhapjen e ideologjive ekstremiste[4].”

Duke pasur parasysh se kërcënimi nga terrorizmi në tokën evropiane është rritur gjatë disa viteve të fundit, Komisioni Evropian (KE) më 2 dhjetor 2015, në prag të sulmeve në Paris, miratoi një paketë të dyfishtë në mënyrë që më mirë të adresojë këtë kërcënim[5]. Sipas një raporti të KE-së, luftëtarët e huaj kanë qenë të përfshirë në të paktën 6 sulme terroriste në BE gjatë vitit 2015. Sipas Komisionit, “Rregullat ekzistuese duhet të vendosen në një linjë, duke marrë parasysh kërcënimin terrorist me të cilin po përballet Evropa.”[6]

Grupet ekstremiste si ISIS, Boko Haram, el-Shebab e të tjerë kanë përdorur dhunë pa dallim se ndaj kujt dhe kanë shkelur të drejtat e njeriut në shumë raste. Pavarësisht aktiviteteve të tyre çnjerëzore, këto grupe ende arrijnë të tërheqin ndjekës. Ky fakt tregon se nuk mund të luftohen këto grupe vetëm duke iu kundërvënë akteve të tyre të terrorizmit, por gjithashtu duhet të adresohen dhe të luftohen ideologjitë e ekstremizmit të dhunshëm që ata i përhapin.

Është shumë e rëndësishme të kuptojmë idetë prapa fenomenit të ekstremizmit të dhunshëm dhe arsyet pse njerëzit bashkohen me këto grupe radikale. Politikëbërësit shpesh nuk e kuptojnë domosdoshmërisht plotësisht kompleksitetin e fenomenit dhe për këtë arsye mund pa dashje të marrin vendime politike që nuk janë domosdoshmërisht zgjidhja më e mirë apo të sigurojnë vetëm një zgjidhje të pjesshme, që mund të ketë pasoja negative.

[4] Mbledhja e 7272-të e Këshillit të Sigurimit. “Këshiili i Sigurimit në mënyrë unanime miraton Rezolutën që dënon ekstremizmin e dhunshëm, duke nënvizuar nevojën për të parandaluar udhëtimin, përkrahjen për luftëtarët e huaj terroristë”. 24 shtator 2014. Së fundi here e lexuar më 24 dhjetor 2015. Gjendet në: http://www.un.org/press/en/2014/sc11580.doc.htm

[5] “Propozim për DIREKTIVË NGA PARLAMENTI EVROPIAN DHE NGA KËSHILLI për luftimin e terrorizmit dhe zëvendësimin e Vendimit Kornizë të Këshillit 2002/475/JHA mbi luftimin e terrorizmit” nga Komisioni Evropian, 2 dhjetor 2015. Së fundi herë e lexuar më 15 shkurt 2016. http://ec.europa.eu/dgs/home-affairs/what-we-do/policies/european-agenda-security/legislative-documents/docs/20151202_directive_on_combatting_terrorism_en.pdf

[6] Ibid.

1. Metodologjia dhe përmbajtja

Ky studim i politikave synon të ofrojë një kuptim më të mirë të kësaj situate specifike në Maqedoni, më konkretisht për ekstremizmin e dhunshëm. Për më tepër, ajo tenton të ofrojë një skemë të trendit aktual të ekstremizmit të dhunshëm në Maqedoni dhe në rajonin e Ballkanit Perëndimor duke theksuar forcat lëvizëse të ekstremizmit të dhunshëm, ndërsa gjithashtu duke shikuar në përgjigjen institucionale dhe ligjore në vend në lidhje me ekstremizmin e dhunshëm. Më konkretisht, zbulon atë që deri më tani është bërë në mënyrë institucionale për të trajtuar këtë çështje, duke analizuar ndryshimet e fundit ligjore dhe duke shqyrtuar se çfarë efekte kanë prodhuar në terren, në mënyrë që të jenë në gjendje të ofrojnë rekomandime praktike dhe të politikave relevante për një numër të caktuar palësh të interesuara që punojnë direkt në temën e kundërvënies dhe parandalimit të ekstremizmit të dhunshëm fetar. Studimi i politikave gjithashtu vështron procesin e deradikalizmit dhe risocializimin e luftëtarët të huaj të kthyer.

Ky studim ofron rekomandime për praktikat më të mira kur është fjala për:

- Parandalimin e ekstremizmit, duke shtuar edhe përfshirjen e mundshme të komuniteteve lokale përmes bashkëpunimit me institucionet fetare;
- Zbatimin e ligjit dhe legjislacionit në lidhje me ekstremizmin e dhunshëm dhe luftëtarëve të huaj, si dhe duke analizuar se çfarë efekti mund të ketë tek njerëzit për ti dekurajuar për t'u bashkëngjitur në luftëra të huaja;
- Bashkëpunimin rajonal për kundërvenie ndaj ekstremizmit të dhunshëm apo si bashkëpunimi i institucioneve rajonale të sigurisë ushtrohet dhe inkurajohet, si dhe sa informacionet shpërndahen në mënyrë efektive dhe në kohën e duhur.

Kjo analizë e politikave mbështetet në informacione të marra nga burime të hapura të tilla si artikuj të mediumeve në lidhje me rastet e radikalizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm, debate publike me këtë temë, shkrime akademike dhe literaturë tjetër. Hulumtuesit që kanë punuar në këtë projekt kanë përdorur edhe informata publike në dispozicion në institucione të tilla si Ministria e Brendshme (MPB), të cilat janë të arritshme nëpërmjet Aktit mbi Lirinë e Informacionit, në lidhje me punën e tyre aktuale në këtë pyetje. Përveç kësaj, hulumtuesit e Analytica-s kanë kryer intervista me palë relevante, përmes të cilëve kemi marrë informacione të vlefshme. Së fundmi, takimet e grupeve të fokusit qenë zhvilluar në qytetet: Kumanovë, Shkup dhe Tetovë, duke i pasur në cak më të rinjët.

Ky dokument përbëhet nga gjashtë kapituj, ku secili kapitull merret me një çështje specifike që lidhet me luftimin e ekstremizmit të dhunshëm.

Kapitulli i parë ka të bëjë me kërcënimet që vijnë nga ekstremizmi i dhunshëm dhe dukuria e luftëtarëve të huaj në Maqedoni dhe rajon, ndërsa gjithashtu vë në dukje specifikat lokale.

Kapitulli i dytë shqyrton përgjigjet ligjore dhe institucionale ndaj dhunës së ekstremizmit dhe ndaj dukurisë së luftëtarëve të huaj. Në të vështrohen ndërhyrjet ligjore që kanë ndodhur si pasojë e shfaqjes së fenomenit.

Kapitulli i tretë trajton dinamikën rajonale të çështjes së luftëtarëve të huaj dhe ekstremizmit të dhunshëm. Ajo thekson rëndësinë e bashkëpunimit rajonal duke treguar se si ndërlidhet Ballkani Perëndimor kur është fjala për këtë kërcënim.

Kapitulli i rradhës thekson rëndësinë e procesit të risocializimit dhe riintegrimit, si dhe shpjegon pse këto janë aq të ndërlikuara. Në të vështrohen masat e ndërmarra nga autoritetet politike dhe fetare për të ndihmuar në proceset e risocializimit dhe riintegrimit. Hulumtuesit tanë e krahasojnë këtë me atë që ne besojmë se janë praktika të mira, të përdorura në gjithë Evropën.

Kapitulli në vijim tregon gjetjet nga fokus grupet që janë mbajtur me të rinjtë nga tri qytetet më të mëdha që kanë pasur disa raste të luftëtarëve të huaj të cilët kishin shkuar në Irak dhe Siri (Kumanovë, Shkup dhe Tetovë).

Në kapitullin e fundit përmbledhim gjetjet tona dhe nxjerrim në pah aspektet kryesore. Ofrojmë rekomandime praktike dhe relevante për politikat publike të bazuara në gjetjet e studimit tonë.

2. Konteksti

Për njerëzit të cilët jetonin në ish-Jugosllavi, terrori dhe radikalizmi kanë qenë koncepte të huaja; këto janë perceptuar si çështje që thjesht nuk kanë ndodhur në këtë rajon.[7].

Nga fillimi i viteve 1990 e tutje, shumë bamirësi të huaja myslimane, kryesisht arabë, gjetën rrugën e tyre për në rajon duke përdorur mungesën e stabilitetit politik dhe ekonomik si rezultat i rënies së socializmit për të përhapur ide ekstremiste. Burimet e tyre të mëdha financiare u ndihmonin atyre të arrijnë në bashkësi të varfra, që ishin targeti kryesor i tyre[8].

Shumica e këtyre organizatave kanë qenë bamirëse dhe nuk kanë pasë motive ideologjike. Mirëpo, për fat të keq, disa organizata më radikale kanë arritur të fshihen pas këtij fluksi për të ngritur praninë e tyre në Ballkan dhe pastaj janë përpjekur të fitojnë pasues. Për shembull, ekstremizmi në Bosnjë ka përjetuar një rritje të ndjeshme gjatë luftës në Bosnjë, kur disa mijëra muxhahidë qenë bashkëngjitur anës boshnjake[9].

Aktualisht, Ballkani është një rajon potencialisht i cenueshem sa i përket fenomenit të luftëtarëve të huaj dhe ekstremizmit të dhunshëm. “Komisioni i 11 Shtatorit”[10], qysh më 2010 ka paralajmëruar se vendet e Ballkanit përballen me sfidat e rajonit të paraqitura nga prania e grupeve ekstremiste[11], e ajo ishte qysh para se të shfaqej ISIS-i.[12]

Megjithatë, është interesante të përmendet se kur nxjerr nga ekuacioni sulmet terroriste të cilat ndërlidhen me konfliktet e armatosura në shtete që pasuan pas ish-Jugosllavisë, thjesht mund të konkuldojmë nuk kanë qenë shumë. Gjithashtu, kur këto lloj sulmesh kanë

---

[7] “Countering Islamist Radicals In Eastern Europe” (Kundërvënia ndaj radikalëve islamistë në Evropën Lindore”, fq. 2 Gyorgy Lederer (Giorgi Lederer). Së fundi herë i qasur më 20 dhjetor 2015, Gjendet në: http://www.investigativeproject.org/documents/testimony/33.pdf

[8] “No widespread support for religious extremists in Macedonia and the Balkans” (Nuk ka mbështetje të gjerë për ekstremistët fetarë në Maqedoni dhe në Ballkan), Filip Stojkovski, Think Thanku Analytica. Së fundi herë e qasur më 20 dhjetor 2015:
http://www.analyticamk.org/images/Files/Commentary/comm201509_63a40.pdf

[9] “Bosnia: The cradle of modern jihadism?” (Bosna: djepi i xhihadizmit modern). BBC. 2 korrik 2015.
http://www.bbc.com/news/world-europe-33345618

[10] Komisioni i 11 Shtatorit ishte një komision i pavarur dypartiak i cili u krijua nga Kongresi i ShBA-së, me miratimin e ish-presidentit amerikan Xhorxh Bush. Qëllimi i tij kryesor ishte të përgatisë raport të plotë të rrethanave të 11 shtatorit 2001 të sulmeve terroriste. Ai gjithashtu ka mandat të ofrojë rekomandime që do të zbusin kërcënimin prej sulmeve të mundshme në të ardhmen.

[11] KONGRESI I 111-TË ME RADHË. Sesioni i dytë H. R. 4728 NË SHTËPINË E PËRFAQËSUESVE “Teksti i Aktit të luftimit të ekstremizmit dhe sigurisë në Ballkan”. 2 mars 2010. I qasshëm më 20 dhjetor 2015.
https://www.govtrack.us/congress/bills/111/hr4728/text

[12] Komisioni Nacional për Sulmet Terroriste në Shtetet e Bashkuara. Ueb-faqja zyrtare është ngrirë më 20 shtator 2014. Tani për tani një regjistër federal u mundësia në Arkivet Nacionale dhe në Administratën e Regjistrave. I qasshëm më 21 dhjetor 2015.
http://www.9-11commission.gov/

ndodhur, ata kanë qenë kryesisht sulme individuale, ku asnjë grup i veçantë nuk ka qëndruar pas atyre sulmeve. Gjithashtu mund të shohim se nuk ka pasur sulme të mëdha me shumë viktima. Fakti që asnjë rrjet i madh fetar me motive terroriste nuk është krijuar tregon se grupet ekstremiste në të kaluarën nuk kanë mundur të mobilizojnë mbështetës dhe për këtë arsye ka qenë relativisht të dobët.

2.1 Luftëtarët e huaj

Edhe pse kërcënimi nga ekstremizmi i dhunshëm nuk ka qenë i lartë, është e rëndësishme të theksohet se kërcënimi megjithatë është në rritje graduale.. Një zhvillim i kohëve të fundit që ka fituar vëmendjen është çështja e luftëtarëve të huaj nga Ballkani Perëndimor, të cilët kryesisht luftojnë në Siri dhe Irak. Për shkak të kompleksitetit të fenomenit, është e vështirë për të dhënë një vlerësim të saktë të numrit të luftëtarëve të huaj nga Maqedonia dhe pjesa tjetër e Ballkanit. Megjithatë, kërcënimi që paraqesin në rajon është real dhe kjo ka çuar autoritetet përkatëse të përshtasin rregulla të reja në luftën kundër ekstremizmit të dhunshëm.

Sipas të dhënave të paraqitura nga Presidenti i Maqedonisë, Gjorgje Ivanov, më 22 qershor 2016, ka 110 luftëtarë nga Maqedonia në Siri dhe, përveç tyre, edhe 25 janë vrarë në Siri, kurse 86 luftëtarë janë kthyer tashmë në Maqedoni[13]. Nga luftëtarët e huaj nga Maqedonia janë 3 femra, ndërsa 3 luftëtarë të tjerë të huaj janë meshkuj dhe kanë marrë familjen e tyre të afërt në Siri[14].

Sipas shifrave nga Grupi Soufan, Kosova dhe Bosnja ka pasur 232 dhe 330 raste respektivisht.[15] Çështja e ekstremizmit të dhunshëm dhe luftëtarëve të huaj për këtë arsye është lartë në agjendat e Maqedonisë dhe vendeve të tjera të Ballkanit.

Këto shifra mund të duken të larta, por duhet të kujtojmë se ka një total prej 6.5 milionë mysliman që jetojnë në vendet e Ballkanit Perëndimor. Kjo tregon se, si përqindje, numri i myslimanëve të Ballkanit që u bashkohen këtyre grupe nuk është shumë alarmant. Qendra e Kosovës për Studime të Sigurisë (QKSS) në studimin e tyre “Raport për shkaqet dhe pasojat e përfshierjes së qytetarëve të Kosovës si luftëtarë të huaj në Siri dhe Irak” jep numra të luftëtarëve nga vendet në botë. Kosova dhe Bosnja kanë 125 gjegjësisht 85 luftëtarë të huaj për një milion qytetarë. Kjo i vë këto dy vende në vendet si më të lartat të rangut në listën e ofruar nga QKSS. Megjithatë, kur vihen këto numra sa u përket luftëtarëve të huaj për popullsinë

[13] Ueb-faqja e Presidentit të Republikës së Maqedonisë. “Fjalim i Presidentit Ivanov” më 22 qershor 2016. I qasshëm më 13 korrik 2016.
http://www.president.go v.mk/mk/2011-06-17-09-55-07/2011-07-19-10-40-39/3849.html
[14] Intervistë me zyrtar të lartë në DSK. E realizuar më 19.07.2016.
[15] Newsweek (Njuzvik). “Report: Number of foreign fighters in Iraq and Syria double to 31000” (Raport: Numri i luftëtarëve të huaj në Irak dhe Siri u dyfishua në 31.000). 12 gusht 2015. I qasshëm më 12 gusht 2015.
http://europe.newsweek.com/foreign-fighters-syria-and-iraq-double-31000-86-countries-report-402084?rm=eu

myslimane (për milion), Kosova dhe Bosnja nuk janë edhe në krye të dhjetë më të lartëve në të njëjtën listë.[16]

Një fenomen interesant është se në fillim disa prej këtyre luftëtarëve nga vendet e Ballkanit Perëndimor nuk kanë shkuar në baza fetare, siç supozohet shpesh, por në fakt janë bashkuar në luftë duke u solidarizuar kundër qeverive që ata mendonin se janë despotike në Siri dhe Irak[17]. Së këndejmi, ata i janë bashkëngjitur grupeve të moderuara, siç janë Ushtria e Lirë Siriane.

Luftëtarët që u bashkëngjiten grupeve ekstremiste si ISIS dhe Xhebhat el-Nusra janë dënuar nga autoritetet politike dhe fetare në Ballkanin Perëndimor. Kreu i Bashkësisë Islame të Bosnjës, Husein Kavazoviç, denoncoi ISIS-in, duke thënë se "nuk ka 'por' në dënimin e atyre krimeve"[18] dhe u kërkoi autoriteteve t'ua marrin shtetësinë luftëtarëve boshnjakë që janë në ISIS. Bashkësia Fetare Islame në Maqedoni ishte e shpejtë për të dënuar sulmet e Charlie Hebdo (Sharli Hebdos), duke deklaruar: "Ky sulm nuk ka të bëjë me Islamin. Ne besojmë se nuk ka fe në botë që justifikon këto akte."[19]

2.2 Ekstremizmi i dhunshëm me rrënjë në Maqedoni

Çështja e luftëtarëve të huaj nuk është fenomen i ri për Maqedoninë. Qytetarët e Maqedonisë në numër shumë të vogël u janë bashkëngjitur grupeve të huaja ekstremiste disa dekada me radhë. Janë raportuar raste të individëve që u janë bashkëngjitur grupeve që kanë luftuar në Bosnje e Hercegovinë , Afganistan, dhe Pakistan.[20]

Alarmet e para në lidhje me ekstremizmin e dhunshëm janë ngritur kohët e fundit në Maqedoni, kur filluan të vijnë raporte për më shumë qytetarët të Maqedonisë të vrarë në Siri duke luftuar për grupet ekstremiste. Raporti i parë i një shtetasi të Maqedonisë që është vrarë

[16] Qendra e Kosovës për Studime të Sigurisë (QKSS), "Raport për shkaqet dhe pasojat e përfshierjes së qytetarëve të Kosovës si luftëtarë të huaj në Siri dhe Irak", fq. 25, tabela 1. 25 prill 2015. I qasshëm më 29 nëntor 2015.

[17] Prishtina Insight (Prishtina Insajt). Rekrutuesit e ISIS-it nga Maqedonia të lidhur me liderë kryesorë të tyre. 28 mars 2016. I qasshëm më 6 qershor 2016. http://prishtinainsight.com/exclusive-details-macedonias-isis-recruits/

[18] Newsmax (Njuzmaks). "Muslim Clerics Lash out at ISIS Over Pilot's Execution" (Klerikët myslimanë kritikojnë ISIS-in për ekzekutimin e pilotit). 6 shkurt 2015. I qasshëm më 29 nëntor 2015. http://www.newsmax.com/World/GlobalTalk/isismuslim-clerics-lash-out/2015/02/06/id/623249/

[19] Zëri i Amerikës-Maqedoni. Borjan Jovanovski "Македонија реагира на нападот во Шарли Ебдо" (Maqedonia reagon për sulmin në Sharli Hebdo). 8 janar 2015. I qasshëm më 29 nëntor 2015. http://mk.voanews.com/content/voa-macedonian-macedonia-reactions-charlie-paris/2590750.html

[20] Intervistë me Toni Jakimovskin – Ish-Koordinator për Luftim Nacional të Terrorizmit. E bërë më 3 maj 2016.

në Siri erdhi në maj të vitit 2013[21] dhe kjo erdhi si një e papritur për publikun e gjerë. 28-vjeçari R.Z., nga një fshat afër Gostivarit, qe vrarë duke luftuar për Xhebhat el-Nusra, dega siriane e al-Kaedës. Një goditje e mëtejshme për publikun ishte kur në një nga video-propagandat e ISIS-it lëshuar më 12 qershor 2014 mund të shihej një grup i luftëtarëve të ISIS shqyenin pasaportat e tyre (një prej tyre ishte një pasaportë maqedonase dhe gjithashtu dy pasaporta kosovare) dhe duke hequr dorë nga identitetet e tyre kombëtare dhe etnike.[22]

Këta luftëtarë përbëjnë një kërcënim për vendet në të cilët ata kthehen. Në analizën e shkurtër We did Criminalize it – now what? Western Balkans response to the foreign fighters threat" (E kriminalizuam – tash çfarë? Përgjigjja e Ballkanit Perëndimor për kërcënimin e luftëtarëve të huaj[23]), Andreja Bogdanovski jep disa arsye se pse kjo paraqet kërcënim. Tre nga arsyet e tij më të rëndësishme janë: ata mund të veprojnë si një medium për rekrutim, ata kanë marrë aftësi luftarake dhe terroriste dhe, në fund, ata mund të veprojnë si ujqër të vetmuar. Edhe pse jo të gjithë këta individë do të marrë rrugën e dhunës, kur ata kthehen në vendet e tyre është e rëndësishme të trajtohet çështja për shkak të madhësisë së mundshme të dëmit që mund të shkaktojnë.

Shumica e rekrutimit nga grupet si ISIS nuk është bërë nëpërmjet një njësie qendrore; ajo është kryer në nivelin bazë, i cili është rasti i Maqedonisë. Së fundmi, është e rëndësishme të theksohet se edhe në qoftë se luftëtarët e huaj nuk do të kthehen në vendet e tyre, ata ende përbëjnë një kërcënim me mundësinë e radikalizimit të të tjerëve në internet, gjë që mund të bëhet nga kudo në botë.

Strategjia e Maqedonisë kryesisht përqendrohet në kompetencat ekzekutive dhe gjyqësore, me pak ose aspak angazhim të komunitetit. Autoritetet maqedonase kanë tendencë të sekuritizojnë çështjen dhe ta vështrojnë nga perspektiva e zbatimit të ligjit. Kjo demonstrohet nga fakti se nuk ka strategji të veçantë për luftim të ekstremizmit të dhunshëm, por luftimi i ekstremizmit të dhunshëm është parë si pjesë e strategjisë më të gjerë kundër terrorizmit.

Tema e radikalizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm ka qenë lart në agjendën e institucioneve në vend. Presidenti Ivanov pas një takimi me përfaqësues të Bashkësisë Fetare Islame të Maqedonisë (BFI) theksoi kërcënimin që përballet Maqedonia në drejtim të radikalizimit, duke shtuar se burimet e kufizuara të Maqedonisë janë duke u shpenzuar në trajtimin e refugjatëve dhe migrantëve, gjë që u lejon autoriteteve maqedonase të punojnë

---

[21] Utrinski. "Гостиварец загина во Сирија (Gostivarasi që ndërroi jetë në Siri)". 28 maj 2013. I qasshëm më 2 dhjetor 2015.
http://www.utrinski.mk/?ItemID=3125F63C9C8F31489EE8E3A3F7E8E7A6

[22] Brif. "Џихадист од Македонија го искина пасошот (Xhihadisti nga Maqedonia që e shqeu pasaportën). I qasshëm më 2 dhjetor 2015.
http://brif.mk/?p=154809

[23] Andreja Bogdanovski, Analytica Think Tank. "We did criminalize it- now what? Western Balkans response to the foreign fighters threat" (E kriminalizuam – tash çfarë? Përgjigjja e Ballkanit Perëndimor për kërcënimin e luftëtarëve të huaj). Shtator 2014. E qasur më 3 dhjetor, 2015.
http://www.analyticamk.org/images/stories/files/2014/Foreign_Fighters.pdf

vetëm në parandalimin e eskalimit të radikalizimit në vend se të merren me këtë çështje[24] në rrënjët e saj.

BFI-ja gjithashtu ka folur publikisht kundër ISIS-it, duke deklaruar se ISIS-i nuk përfaqëson Islamin dhe se BFI-ja gjithmonë ka qenë kundër këtyre luftërave. Ata dënuan të gjitha format e dhunës dhe ekstremizmit, duke vënë në dukje se terrorizmi, sidomos kur bëhet në emër të fesë, nuk do të tolerohet.[25]

Është e rëndësishme të theksohet se numri i luftëtarëve të huaj nga Maqedonia është në rënie. Kjo mund të jetë pjesërisht për shkak të faktit se rekrutuesi më i zëshëm për ISIS-in, Rexhep Memishi, është arrestuar.[26] Megjithatë, kjo nuk do të thotë se idetë ekstremiste kanë ndaluar të qarkullojnë. Është e mundshme që shkaku i shtypjes së qeverisë të rekrutimit për grupe të huaja, ekstremistët janë në mshehje dhe kanë filluar të udhëtojnë për në Siri dhe Irak me më shumë kujdes apo thjesht fokusohen në forcimin e mbështetjes së tyre në vend.

2.3 Qytetarë maqedonas të dënuar jashtë vendit

Ka pasur disa raste të qytetarëve të Maqedonisë të dënuar ose të arrestuar në vende jashtë shtetittë Maqedonisë për shkak të pjesëmarrjes në grupe ekstremiste të huaja apo të rekrutimit për të. Rasti më i njohur është ai i Muhamed Zekirit nga Ohri, i cili u dënua me burgim të përjetshëm në Turqi më 15 qershor 2016[27]. Zekiri dhe tre xhihadistë të tjerë ishin duke ardhur nga një kamp trajnimi në Siri, kur ata u ndaluan në një pikë kontrolli në Anadoll (Turqi). Ata hapën zjarr dhe vranë dy policë dhe një shofer kamioni. Një shtetas tjetër i Maqedonisë, A.V, u arrestua në afërsi të Venedikut (Itali) për rekrutim për në ISIS-in. Gjatë operacionit të policisë ata kishin gjetur se disa xhihadistë qenë rekrutuar nga A.V.[28] dhe pjesa tjetër e rrjetit të tij tashmë kishte udhëtuar në Siri nga Italia. Në mesin e tyre ishin dy qytetarë boshnjakë dhe një nga Maqedonia.

---

[24] MKD MK. “Иванов: И Исламската верска заедница треба да се вклучи во справувањето со радикализацијата (Ivanov: Bashkësia Fetare Islame e Maqedonisë duhet të bashkëngjitet në luftimin e radikalizimit). 1 dhjetor 2015. I qasshëm më 15 dhjetor 2015. http://m.mkd.mk/makedonija/politika/ivanov-i-islamskata-verska-zaednica-treba-da-se-vkluchi-vo-spravuvanje-so

[25] Telegraf MK. “ИВЗ: ИСИС не го претставува Исламот (BFIM – ISIS-i nuk e përfaqëson Islamin)”. 6 gusht 2015. I qasshëm 15 dhjetor 2015. http://www.telegraf.mk/aktuelno/makedonija/ns-newsarticle-295793-ivz-isis-ne-go-pretstavuva-islamot.nspx

[26] Intervistë me Toni Jakimovskin – Ish-Koordinator Nacional për Luftim të Terrorizmit. E bërë më 3 maj 2016.

[27] Radio Evropa e Lirë në gjuhën maqedonase. ‘Tre anëtarë të ISIS-it dënohen në Turqi’. 16 qershor 2016. I qasshëm më 19 qershor 2016. http://www.slobodnaevropa.mk/a/27801582.html

[28] Ansa në anglishte. ‘Një maqedonas arrestohet për rekrutim xhihadistësh’. 26 shkurt 2016. I qasshëm më 15 qershor 2016. http://www.ansa.it/english/news/2016/02/26/police-arrest-macedonian-for-recruiting-mujahideen-4_b006fe25-c144-4e29-8b23-8edabc2dabcd.html

2.4 Agjenda më e gjerë

Raportohet se luftëtarët aspirues të cilëve iu është ndaluar fluturimi kanë vozitur ose kanë marrë autobusë nëpër Ballkan për të arritur në Turqi. Është shumë e rëndësishme për autoritetet rajonale të bashkëpunojnë me njëri-tjetrin dhe me vende të tjera perëndimore me qëllim të parandalimit të këtyre individëve që të arrijnë në destinacionet e tyre përfundimtare.[29] Bashkëpunimi duhet të mbështetet në shpërndarje të informacioneve të mbledhura nga shërbimet e inteligjencës, ndërsa në të njëjtën kohë duke krijuar besim ndërmjet autoriteteve.

Kur është fjala për pengimin e udhëtimeve terroriste, shkëmbimi i informacionit është shtylla kryesore e një qëndrimit të fortë të sigurisë. Vëllimi i madh i udhëtarëve xhihadistë e ka bërë të vështirë për autoritetet të ndjekin gjurmët e individëve të cilët paraqesin kërcënim dhe për ta kthyer vëmendjen nga ata të cilët nuk paraqesin. Një mjet i rëndësishëm potencialisht mund të jetë një dokument analitik i Interpolit për "luftëtar të huaj terrorist", që është në dispozicion për të gjitha 190 vendet anëtare të INTERPOL-it, ku çdo vend anëtar mund të ketë qasje në bazën e të dhënave dhe mund të kontrollon për të zbuluar luftëtarët e huaj që përpiqen të hyjnë në territorin e tyre. Ka megjithatë ankesa se disa vende anëtare nuk i japin informacionet apo thjesht nuk i shpërndajnë në shpejtësinë e mjaftueshme[30].

Autoritetet maqedonase pretendojnë se shfrytëzojnë bazën e të dhënave të Interpolit dhe përditësimin e informacionit mbi të në mënyrë të rregullt.[31] Megjithatë, Presidenti Ivanov ka deklaruar se Maqedonia ka një mungesë të qasjes në bazat e të dhënave të BE-së mbi luftëtarët e huaj.[32]

Maqedonia, që nga fillimi i konfliktit në Siri, u është bashkëngjitur qeverive të tjera perëndimore në përkrahje të përpjekjeve të komunitetit ndërkombëtar për t'i dhënë fund dhunës. Maqedonia i bashkohet komunitetit ndërkombëtar duke dënuar përdorimin e armëve kimike nga regjimi i Bashar el-Asadit. Ministria e Punëve të Jashtme e Maqedonisë ka

[29] International Business Times. "How foreign fighters joining ISIS travel to the Islamic State Group's Caliphate" (Si luftëtarët e huaj që i bashkëngjiten ISIS-it udhëtojnë në Kalifatin e Grupit të Shtetit Islam). 3 mars 2015. I qasshëm më 21 dhjetor 2015. http://www.ibtimes.com/how-foreign-fighters-joining-isis-travel-islamic-state-groups-caliphate-1833812

[30] Interpol. "Interpol Chief says 'unprecedented' foreign terrorist fighter threat requires global action" (Shefi i Interpolit thotë: luftëtari i huaj terrorist "i papresedan" kërkon aksion global. 29 maj 2015. I qasshëm më 22 dhjetor 2015. http://www.interpol.int/News-and-media/News/2015/N2015-067

[31] Ministria e Punëve të Brendshme, Informacion i marrë duke e përdorur Ligjin për Qasje të Lirë për Publikun. Informacion i dërguar më 21.12, kërkesa nr. 233/15.

[32] Makfaks. 'Иванов: На ЕУи се потребни безбедни и стабилни трети држави (Makfaks, Ivanov: EU-së i duhen shtete të treta stabile dhe të sigurta), 19 shtator, 2016 http://makfax.com.mk/makedonija/nadvoresna-politika/ivanov-na-eu-i-se-potrebni-stabilni-i-bezbedni-treti-zemji

deklaruar se krimet e tilla nuk duhet të mbeten pa u ndëshkuar.[33] Maqedonia është poashtu pjesë e koalicionit anti-ISIS.[34]

Shumë prej tyre kanë marrë në pyetje implikimet e sigurisë së krizës së refugjatëve në Ballkan, pasi ajo është një zonë kryesore e tranzitit për refugjatët. Ka pasur spekulime se ekziston një numër i konsiderueshëm i ekstremistëve në mesin e refugjatëve, të cilat kontribuan në sjelljen e vendimit për mbylljen e kufijve. Gjithashtu, merrja me krizën e refugjatëve është një tendosje shtesë në burimet tashmë të kufizuara që i kanë autoritetet. Devijimi i burimeve në trajtimin e migrantëve dhe parandalimin e kalimeve të paligjshme mund të nënkuptojë se nuk do të ketë burime të mjaftueshme për mbikëqyrjen e të gjithë individëve të dyshuar se janë radikalizuar.

Vetë refugjatët, megjithatë, po ikin prej luftës dhe ekstremizmit. Ata nuk i mbështesin grupet ekstremiste; në fakt besohet se ata po ikin prej tyre. Këto grupe të dhunshme gjithashtu tashmë kanë një numër të konsiderueshëm të simpatizantëve në Evropë dhe është e vështirë të thuhet se terroristët do të marrin udhëtimin e migrimin, i cili përbëhet nga mijëra kilometra udhëtime. Një kërcënim më i besueshëm ndoshta do të jetë radikalizimi gradual i individëve nga komuniteti i refugjatëve sirianë që jetojnë në Evropë, që sipas të gjitha gjasave predikues radikalë të cilët janë tashmë atje do të tentojnë ta bëjnë këtë. Megjithatë është e rëndësishme të theksohet se një nga sulmuesit nga sulmet e Parisit në nëntor 2015, i cili është qytetar i BE-së, me sa duket kishte udhëtuar rrugën e migrantëve që vijnë nga Siria duke përdorur një pasaportë fallco.[35] Kjo do të thotë se mundësia e të pasurit terroristë në mesin e migrantëve, edhe pse e ulët, ekziston. Është e vështirë për autoritetet qeveritare përgjatë rrugës të kontrollojnë të gjithë migrantët në mënyrë efektive, kjo për shkak të numrit enorm të migrantëve dhe burimeve dhe kapaciteteve të kufizuara të autoriteteve. Është e nevojshme për shpërndarje më të mirë të informacionit dhe bashkëpunim më të mirë në mes të shteteve përgjatë rrugës migrantëve kur bëhet fjalë për kontrollin e refugjatëve dhe migrantëve për terrorist potencial që t mund të jetë fshehur në mesin e tyre.

[33] A1. “Македонија ги осудува насилствата во Сирија (Maqedonia e dënon dhunën në Siri)”. 31 gusht 2015. I qasshëm më 23 dhjetor 2015. http://a1on.mk/wordpress/archives/198349

[34] The Washington Post. ‘What the 60 members of the anti Islamic State coalition are doing’ (Çfarë janë duke bërë 60 anëtaret kundër Shtetit Islam). 25 shtator 2014. I qasshëm më 8 mars 2016. https://www.washingtonpost.com/news/checkpoint/wp/2014/09/25/what-the-60-members-of-the-anti-islamic-state-coalition-are-doing/

[35] BBC. ‘Paris Attacks: Who are the attackers?’ (Sulmet e Parisit: Kush janë sulmuesit?). 27 prill 2016. I qasshëm më 25 maj 2016. http://www.bbc.com/news/world-europe-34832512

3. Kundërpërgjigjia ligjore dhe institucionale

3.1 Definimi i kundërvënies ndaj ekstremizmit të dhunshëm / Parandalimi i ekstremizmit të dhunshëm

Kundërvënia ndaj ekstremizmit të dhunshëm është një proces kompleks që kërkon përfshirjen e një numri të institucioneve (shtetërore, lokale, fetare), dhe shoqërinë civile së bashku me komunitetet lokale. Kundërvënia ndaj ekstremizmit të dhunshëm kërkon një qasje gjithëpërfshirëse duke inkuadruar të gjithë aktorët përkatës dhe jo vetëm institucionet e sigurisë. Vetëm me një qasje të tillë tërësore mund të zbulohen dhe pastaj të adresohen faktorët që i nxisin njerëzit në të dhe ti bashkangjiten rrugës së ekstremizmit të dhunshëm. Në procesin e luftimit të ekstremizmit të dhunshëm, bashkëpunimi në mes të gjithë aktorëve të përfshirë është vendimtar. Që ky bashkëpunim të jetë në nivelin e duhur, duhet fillimisht të ketë një nivel të caktuar të besimit në mesin e palëve të përfshira.

Kur flasim për kundërvënien ndaj ekstremizmit të dhunshëm, asociacioni i parë për shumë njerëz është zbatimi i ligjit dhe sistemi i drejtësisë penale. Një aspekt kyç i kundërvënies ndaj ekstremizmit të dhunshëm është azhurimi i ligjeve ekzistuese për të adresuar më mirë fenomenin e luftëtarëve të huaj dhe ekstremizmin e dhunshëm që të shpie në terrorizëm. Sistemi i drejtësisë penale duhet të jetë në gjendje për t'iu përgjigjur aktiviteteve të lidhura me terrorizmin, me hetim të drejtë dhe efektiv, përndjekje dhe dënime në rastet fatkeqe që ato mund të ndodhin[36]. Është gjithashtu e nevojshme që të ketë një qasje që përfshin masa parandaluese të tilla si ndjekjen e individëve për përpjekje, bashkpunim, financimin, rekrutimin dhe trajnimin.

Edhe pse aspekti i zbatimit të ligjit është gjithmonë i rëndësishëm, masat parandaluese janë njësoj, nëse jo më të rëndësishme. Është e rëndësishme që më shumë përqëndrim është vënë në aspekte të tjera, si "ndërtimi i qëndrueshmërisë së komunitetit ndaj radikalizmit, promovimin e kundërthirrjeve, promovimin e rolit të të rinjve dhe grave si udhëheqëse të shoqërisë civile, [dhe] ngritjen e rolit të zërave të moderuar fetare".[37] Kjo është me rëndësi, meqë ua vështirëson ekstremistëve afrimin dhe rekrutimin e njerëzve për kauzën e tyre.

[36] Global Counterterrorism Forum. "The Rabat Memorandum of Good Practices for Effective Counterterrorism Practice in the Criminal Justice Sector" (Memorandumi i Rabatit i Praktikave të mira për praktika efektive kundër terrorizmit në sektorin e drejtësisë penale). 24 maj 2012. I qasshëm më 10 shkurt 2016.
https://www.thegctf.org/documents/10162/38299/Rabat+Memorandum-English

[37] U.S Department of State "U.S State Department and USAID Supported Initiatives to Counter Violent Extremism" (Departamenti i Shtetit Amerikan përkrahu iniciativat për të luftuar ekstremizmin e dhunsëm). 19 shkurt 2015. I qasshëm më 10 shkurt 2016.
http://www.state.gov/r/pa/prs/ps/2015/02/237647.htm

3.2 Korniza ligjore për kundërvënie ndaj ekstremizmit të dhunshëm në Maqedoni

Politikëbërësit në Maqedoni, në përputhje me vendet nga Ballkani Perëndimor dhe vendeve të tjera evropiane, kanë vendosur t'i azhurnojnë ligjet e saj, në mënyrë që të luftojnë në mënyrë më të përshtatshme rekrutimin e luftëtarëve të huaj.[38]

Edhe pse korniza ligjore e Maqedonisë përmbante dispozita kundër terrorizmit para rishikimit, nuk kishte dispozita të veçanta që penalizonin rekrutimin dhe pjesëmarrjen në ushtri të huaja. Legjislacioni i Maqedonisë që mbulon fushën e terrorizmit kryesisht vjen nga neni 394-a, 394-b, 394-c të Kodit Penal[39] dhe nga Ligji për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit.[40]

Me zhvillimin e luftës në Siri, fenomeni i luftëtarëve të huaj u bë një çështje e rëndësishme, meqë shtete nga i gjithë globi u morën me çështjen e qytetarëve të cilët i bashkohen këtyre grupeve. Luftimi i fenomenit të luftëtarëve të huaj dhe ekstremizmit të dhunshëm u bë prioritet i lartë për komunitetin ndërkombëtar. Për këtë arsye ishte e rëndësishme të ketë ndryshime në ligjet ekzistuese që do të adresonin në mënyrë specifike çështjen e luftëtarëve të huaj.

Sipas ndryshimeve që janë miratuar më 3 shtator 2014, neni 322-a tani thotë se pjesëmarrja në forca ushtarake apo paraushtarake të huaja, rekrutimi, trajnimi ose transportimi i luftëtarëve në çfarëdo mënyre është e dënueshme me ligj me heqje lirie prej së paku 5 vitesh.[41] Ligji nuk zbatohet në mënyrë retroaktive. Në rastin e Bosnjës dhe Hercegovinës, dënimi me burg varion nga jo më pak se 3 vite për pjesëmarrje në grupe të huaja dhe prej 1-10 vite për rekrutim për grupe të tilla[42], përderisa në Kosovë është më shumë, gjegjësisht deri më 15 vite.[43]

---

[38] Kosova e kaloi Ligjin për Ndalim të pjesëmarrjes në konfikteve të armatosura jashtë territorit në mars të vitit 2015, kurse Serbia shtoi amendamente sa u përket luftëtarëve të huaj në kodin penal në tetor të vitit 2014.

[39] Republika e Maqedonisë, Kodi Penal. "Neni 394-a. I qasshëm më 5 nëntor 2016. https://www.unodc.org/res/cld/document/mkd/1996/criminal_code_html/FYROM_Criminal_Code.pdf fq. 155-157

[40] Direktorati për inteligjencë financiare "Ligji për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit". I qasshëm më 10 shkurt 2016. http://ufr.gov.mk/files/docs/Zakon.pdf

[41] Neni 322-a.

[42] Kodi Penal i BeH, neni 162-b. I qasshëm më 28 prill 2016. Http://www.coe.int/t/dlapil/codexter/Country%20Profiles/Legislation/BiH%20Criminal%20Code%20Article%20162b%20-%20draft.pdf

[43] Library of Congress. "Treatment of Foreign Fighters in Selected Jurisdictions: Country Surveys." (Trajtimi i Luftëtarëve të Huaj në jurisdikcione të zgjedhura: anketa të vendit.) I qasshëm më 28 prill 2016 https://www.loc.gov/law/help/foreign-fighters/country-surveys.php#_ftn162

Në ligjin e Maqedonisë është specifikuar se nuk do të ketë ndëshkim për individët të cilët kanë shtetësi nga vendet në ushtrinë e rregullt apo në formacionin policor në të cilat ai/ajo merr pjesë apo nëse është anëtar i formacioneve ushtarake të cilat janë nën kontrollin e qeverive të njohura ndërkombëtarisht ose organizatave ndërkombëtare.

Megjithatë, luftëtarët që u janë bashkëngjitur rebelëve të moderuar në Siri, si ato që i bashkëngjitën ushtrisë së Koalicionit Kombëtar për Forcat Siriane Revolucionare dhe Forcave të Opozitës, të cilët kanë qenë të njohur si përfaqësuese legjitime të popullit sirian nga 89 vende, por jo nga Maqedonia, ende përballen me pasoja të njëjta ligjore, si ata që iu bashkëngjiten grupeve ekstremiste.

Është e rëndësishme që legjislacioni të jetë fleksibil dhe i azhuruar me zhvillimet më të fundit nga fushëbetejat e botës kur është fjala për fenomenin e luftëtarëve të huaj, për shkak të kompleksitetit të situatës. Ka pasur disa raste kur prokurorët publikë të vendeve të BE-së u kanë lejuar qytetarëve të vet t'u bashkëngjiten grupeve që luftojnë kundër ISIS-it, njëri rast ka qenë ku disa anëtarë nga një grup motociklistësh nga Holanda të quajtur "Jo dorëzimit" iu bashkëngjitën forcave kurde nga Peshmerga në Irak[44].

Për të parandaluar në të ardhmën luftëtarët e huaj ti bashkohen kësaj lufte, autoritetet në Maqedoni nuk do të lejojnë udhëtimin jashtë vendit për individë të dyshuar për lidhje me grupet e huaja ekstremiste.[45]

Strategjitë e Maqedonisë dhe vendeve të tjera të Ballkanit Perëndimor kryesisht përqëndrohen në kompetencat ekzekutive dhe gjyqësore, me pak ose aspak fokus për angazhim të komunitetit. Ky është problem pasi që kjo zgjidhje nuk përfshinë parandalimin e radikalizimit, por vetëm merret me pasojat e tij. Angazhimi i komunitetit është i nevojshëm për adresimin e rrënjëve të problemeve, duke marrë një pasqyrë se pse njerëzit marrin rrugën e ekstremizmit të dhunshëm dhe paraqet mundësi për të punuar në parandalimin e radikalizimit.

[44] The Australian "Dutch and german biker gangs join the kurds in the battle against ISIS" (Grupe holandezë dhe gjermanë iu bashkëngjiten kurdëve në betejën kundër ISIS-it). I qasshëm më 20 prill 2016. http://www.theaustralian.com.au/news/world/the-times/dutch-and-german-biker-gangs-join-the-kurds-in-the-battle-against-isis/news-story/1db5987bd89956ce78f39405a38387e0

[45] Ministria e Punëve të Brendshme, informacion i marrë duke përdorur Ligjin për Qasje të Lirë të informative me karakter publik i dërguar më 22 mars 2016, me numër kërkese 7410/2.

3.3 Përgjigjia institucionale

3.3.1 Ministria e Punëve të Brendshme

Ministria e Punëve të Brendshme (MPB) në Maqedoni është përgjegjëse për aspektin e zbatimit të ligjit për kundërvënie ndaj ekstremizmit të dhunshëm, e cila përbën pjesën më të madhe të përpjekjeve të luftimit të ekstremizmit të dhunshëm të ndërmarrë nga autoritetet maqedonase. Drejtoria për Siguri dhe Kundërzbulim (DSK), agjencia e inteligjencës së brendshme të vendit, kur bëhet fjalë për këtë çështje, është e ngarkuar me grumbullimin e të dhënave dhe monitorimin e individëve të dyshuar për mbështetjen e grupeve të esktremiste të dhunshme në çfarëdo mënyre, pasi t'i jenë bashkëngjitur luftës, duke planifikuar për t'iu bashkëngjitur apo merren me rekrutim për këto grupe.

Një sfidë institucionale sipas një këshilltar në MPB është se aktualisht Ministria e Brendshme është shumë e fokusuar në mbledhjen e informacioneve përmes SIGINT (mbledhjen e inteligjencës me përgjimin e sinjaleve) dhe si rrjedhojë kanë mungesë të kapacitetit për HUMINT[46] (mbledhja e inteligjencës nëpërmjet resurseve njerëzore). HUMINT në rastin e luftimit të ekstremizmit të dhunshëm është shumë i rëndësishëm. Një sfidë tjetër është edhe mungesa e personelit që flasin arabisht, që mund të jetë një pengesë e madhe në grumbullimin e të dhënave.[47]

MPB-ja e Maqedonisë duket të jetë një hap prapa homologëve të saj në Kosovë. MPB-ja e Kosovës ka zhvilluar strategjinë e tyre të kundërvënies ndaj ekstremizmit të dhunshëm në konsultim me OShC-të përkatëse në Kosovë, gjë që nuk shihet në rastin e Maqedonisë. Kjo është një shenjë pozitive që OShC-të e Kosovës pohojnë se autoritetet i shohin ata si partnerë të barabartë në kundërvënien ndaj ekstremizmit të dhunshëm dhe kontributi i e tyre vlerësohet.[48] Autoritetet e Kosovës kanë qenë edhe më të përgjegjshëm në këtë temë dhe më transparentë në marrëdhëniet e tyre. Zyra për informim e Policisë së Kosovës iu përgjigj pyetjeve tona që kishin të bëjnë me kundërvënien ndajekstremizmit të dhunshëm nëpërmjet postës elektronike, brenda disa ditësh, gjersa marrja e ndonjë informacioni nga MPB-ja e Maqedonisë doli të jetë një proces shumë i vështirë.

3.3.2 Drejtoria për Siguri dhe Kundërzbulim (DSK)

Shërbimi i kundërzbulimit i Maqedonisë (DSK) është shumë i rëndësishëm për aspektin e zbatimit të ligjit për kundërvënie ndaj ekstremizmit të dhunshëm pasiqë ky shërbim kryen aktivitete të lidhura me mbrojtjen nga terrorizmi, kryesisht përmes grumbullimit informacioneve përmes shërbimit të inteligjencës së brendshme. Është e rëndësishme për DSK-në të kenë shërbim inteligjence të mirëfillt në atëse çfarë janë duke bërë individë të

[46] Intervistë me një këshilltar në MPB e bërë më 22 dhjetor 2015.
[47] Intervistë me Sinisha Aleksovskin, këshilltar i sigurisë në Kabinetin e Presidentit. E bërë më 21 dhjetor 2015.
[48] Intervistë me Lulzim Pecin, drejtor ekzekutiv në KIPRED. E bërë më 19 shkurt 2016.

caktuar që kanë treguar prirje për ekstremizëm të dhunshëm dhe nëse ata paraqesin kërcënim konkret për sigurinë kombëtare.

Kjo është veçanërisht e rëndësishëm për misionin e monitorimit të aktiviteteve të luftëtarëve të huaj që janë kthyer në Maqedoni para se ligji i miratuar në vitin 2014 të r penalizonte pjesëmarrjen në ushtritë e huaja.. Shumica e luftëtarëve të huaj qenë kthyer para kalimit të këtij ligji. Duke qenë se këta individë nuk mund të vihen nën gjykim, DSK mund vetëm të monitorojë aktivitetet e tyre dhe qarqet shoqërore për të përcaktuar nëse ata përbëjnë kërcënim.[49]

Përveç anës shtypëse dhe reaktive, DSK-ja ka punuar edhe në një masë më të vogël në anën e parandalimit të çështjes, ku ata përpiqen të kthejnë mendjen e individëve nga bashkimi në grupet e huaja ekstremiste me anë të angazhimit në bisedë me familjet e tyre ose edhe përmes kontaktit me luftëtarë të huaj potencialë. Deri më tani ata kanë arritur të ndryshojnë mendjen e 6 individëve përmes bisedës me ata.[50] Megjithatë, ata nuk mund të jenë aktori i vetëm përgjegjës për parandalimin dhe madje edhe në DSK ka një konsensus që është duke munguar strategji koherente për parandalimin nga institucionet e tjera relevante.[51]

Zyrtarët e DSK-së pretendojnë se kanëbashkëpunim shumë të fortë me institucionet e tjera të sigurisë në Maqedoni për këtë çështje dhe thonë se ata janë vazhdimisht në kontakt me institucionet e tjera për t'i informuar ata për çdo kërcënim të mundshëm. Ata në të kaluarën kanë informuar Ministrinë e Arsimit se disa arsimtarë të shkollave të mesme dhe fillore në Maqedoni janë të lidhur me grupe lokale ekstremiste[52] dhe për këtë arsye paraqesin rrezik të mundshëm duke u përpjekur të indoktrinojnë nxënësit e tyre.

Është interesante të theksohet se DSK-ja ka pasur diskutime për çështjet e kundërvënies ndaj ekstremizmit të dhunshëm me kryetarin e komunës të Shkupit, por jo edhe me kryetarët e komunave që janë më të rrezikuara, si Çairi.[53] Diskutimet e tilla duhet të inkurajohen për shkak se ato mund të çojnë në bashkëpunim më të mirë dhe shkëmbim të informacioneve.

3.3.3 Organi koordinues shtetëror kundër terrorizmit

Në mënyrë për të trajtuar më mirë kompleksitetin e luftimit të terrorizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm autoritetet maqedonase krijuan Organin Koordinues Kundër Terrorizmit. Është menduar që ky organ të jetë një grup i pavarur që do të punojë në luftimin e terrorizmit dhe të ketë të punësuar nga institucione të ndryshme (MPB, Agjencia e Inteligjencës, Inteligjenca Ushtarake, Doganat, Zyra e të Ardhurave Publike si dhe Prokuroria

[49] Intervistë me zyrtar të lartë në DSK. E bërë më 19.07.2016.
[50] Ibid.
[51] Ibid
[52] Ibid.
[53] Ibid.

Publike) duke punuar aty dhe duke ndarë njohuri, përvojë dhe informacione.[54] Ky organ do të punojë për njohjen e formave të kërcënimeve terroriste në Maqedoni dhe të vendosë në atë se çfarë masa duhet të ndërmerren si kundërpërgjigje.

Më 15 mars 2016 Strategjia kombëtare për luftimin e terrorizmit është miratuar nga qeveria. Një sfidë e madhe mund të jetë fakti se nuk ka një strategji të veçantë për kundërvënie ndaj ekstremizmit të dhunshëm, pasiqë organi koordinues kundër terrorizmit ka përfshirë kundërvënien ndaj ekstremizmit të dhunshëm në kuadër të strategjisë për luftë kundër terrorizmit. Kjo qasje e sekuritizimit të çështjes mund të rezultojë si një pengesë në përpjekjet afatgjata në kundërvënien ndaj ekstremizmit të dhunshëm. Nuk ka përpjekje të konsiderueshme në krijimin e kundërthirrjeve dhe ngritjen e vetëdijes, gjë që është vërejtur edhe në raportet apostafate për shtetet e ndryshme të Departamentit të Shtetit – SHBA, mbi terrorizmin për 2015.[55]

Në një pikënisje pozitive, flitet për plane ku mendohet të përfshihen edhe institucioneve të tjera relevante shtetërore si Ministria e Arsimit dhe Ministria e Punës e Politikës Sociale, si dhe shoqëritë civile e institucionet fetare në planin e veprimit në të cilin ky organ është duke punuar. Kjo është një shenjë inkurajuese se rëndësia e këtyre institucioneve ka filluar të çmohet. Është gjithashtu inkurajuese se autoritetet kanë në qëllim të tyre të punojnë me radikalët jo të dhunshëm të cilët mund të jenë një ndihmë e rëndësishme në procesin e kundërvënies ndaj ekstremizmit të dhunshëm.

Një zhvillim tjetër pozitiv është se organi koordinativ kombëtar kundër terrorizmit ka gjithashtu në plan rekomandimin e masave për risocializimin dhe riintegrimin e ekstremistëve të dhunshëm, si dhe edukimin e nëpunësve civilë që punojnë në objektet përmirësuese dhe në sektorin e arsimit. Për momentin ky pozicion është i lirë dhe nuk ka asnjë informacion nëse do të plotësohet në kohë të afërt.

[54] Intervistë me Toni Jakimovskin. Ish-koordinator Kombëtar kundër terrorizmit. E bërë më 3 maj 2016

[2] SHBA Departamenti i Shtetit Byroja e Antiterrorizmit dhe Kundërvënies ndaj ekstremizmit të dhunshëm. "Raporte nga Vendi mbi terrorizëm 2015". Qasur më 13 korrik 2016. http://www.state.gov/j/ct/rls/crt/2015/257516.htm

[55] SHBA Departamenti i Shtetit Byroja e Antiterrorizmit dhe Kundërvënies ndaj ekstremizmit të dhunshëm. "Raporte nga Vendi mbi terrorizëm 2015". Qasur më 13 korrik 2016. http://www.state.gov/j/ct/rls/crt/2015/257516.htm

Operacioni “Celula”

Autoritetet maqedonase si pjesë e betejës kundër ekstremizmit të dhunshëm nisi një operacion të quajtur “Celula”[56]. Në kuadër të këtij operacioni më 6 gusht 2015 ata arrestuan 9 persona nën dyshimin e organizimit dhe rekrutimit të luftëtarëve për ushtritë e huaja. 27 individë të tjerë ishin të pakapshëm dhe për 20 prej tyre u supozua se iu kanë bashkuar ISIS-it në Siri. MPB-ja ka bërë bastisje në qytetet e Shkupit, Gostivarit, Tetovës, Kumanovës dhe Strugës. Ata kanë kontrolluar disa shtëpi private, OJQ, internet-kafe dhe një xhami. Ata gjithashtu arrestuan një imam i cili sipas policisë ishte personi prapa rekrutimit të individëve për t’u bashkuar me grupet ekstremiste. Policia gjithashtu ka konfiskuar një numër të artikujve gjatë këtyre bastisjeve duke përfshirë kompjuterë, laptopë, tableta, kartela memorizuese, një armë, dokumente të udhëtimit, dhe sende të ngjashme.

Në të njëjtën ditë që u zhvillua operacioni “Celula”, Ambasada e SHBA-së në Shkup ka shprehur mbështetjen e saj duke pretenduar se ky veprim paraqet një kontribut të rëndësishëm në përpjekjet rajonale dhe globale për t’i dhënë fund terrorizmit. Ata gjithashtu theksuan se nga të dhënat që ata posedojnë ky operacion është kryer pas një hetimi të gjatë dhe të kujdesshëm nga ana e policisë dhe në përputhje me ndryshimet e reja antiterroriste të bëra në ligj[57].

Për këtë mision ishte tejet e rëndësishme që të kryhet me kujdes, pasi Maqedonia është një shoqëri ku marrëdhëniet ndëretnike janë ende të brishta dhe çdo gabim në akcion mund të interpretohet prejgrupeve të caktuara fetare si problematike dhe mund të krijojë tension. Duke ndjekur këtë mënyrë të menduarit është edhe një deklaratë nga BFI-ja, ku ata mbështesin kundërvënien ndaj ekstremizmit të dhunshëm, duke i kujtuar të gjithëve se BFI-ja duhet të shihet si një partner në këtë përpjekje, por duke paralajmëruar autoritetet maqedonase me maturi të mos politizojnë me këtë agjendë[58]. Që nga arrestimet e 6 gushtit 2015, edhe tetë të dyshuar të tjerë janë gjetur dhe janë arrestuar, duke numërurar rastin e fundit më 21 tetor 2015.[59]

---

[56] 24 Vesti. ‘Полициска акција ‘ќелија’ на МВР, уапсени 9 терористи, 27 се во бегство’(Operacioni policor Celula, 9 të arrestuar, 27 në ikje). 6 gusht, 2015. E qasur më26 korrik, 2016. http://24vesti.mk/policiskata-akcija-%E2%80%9Ekjelija%E2%80%9C-na-mvr-uapseni-9-teroristi-27-se-vo-begstvo

[57]Telma. “Амбасада на САД во Македонија ја поздравија акцијата ‘Ќелија’ (Ambasada e SHBA-së mbështet operacionin "Celula") ". 6 Gusht 2015. E qasur më 15 janar 2016. http://telma.com.mk/vesti/ambasada-na-sad-vo-makedonija-ja-pozdravi-akcijata-kjelija

[58] Zëri i Amerikës në gjuhë maqedone “Реакции на операцијата ’Ќелија’(Reagime ndaj operacionit Celula)”. 7 gusht, 2015. E qasur më 15 Janar, 2016. http://mk.voanews.com/content/article/2906454.html

[59] Telma. “Полицијата уапси македонски припадник на ИСИС (Policia ka arrestuar një anëtar të ISIS-it nga Maqedonia "). 21 tetor 2015. E qasur më 15 janar 2016. http://telma.com.mk/vesti/policijata-uapsi-makedonski-pripadnik-na-isis

MPB-ja filloi operacionin “Celula 2” më 9 korrik 2016 dhe arrestoi 4 persona të dyshuar për pjesëmarrje në organizatat e huaja paraushtarake[60]. Të dyshuarit ishin të moshës 23-38-vjeçare dhe kishin përvojë luftarake nga koha e tyre e kaluar në Siri, të ciët mund të jenë kërcënim potencial i sigurisë së Maqedonisë dhe rajonit.

Një kritikë ndaj këtij operacioni është ngadalsia e tij. BFI-ja ka kërkuar ndihmën e policisë që nga gushti 2014, pasi ata publikisht kishin pranuar se nuk kanë asnjë kontroll mbi disa xhami në Maqedoni dhe se predikuesit radikalë kishin filluar të veprojnë në këto xhami[61].

Autoritetet nga vendet e tjera të rajonit kanë lansuar operacione të ngjajshme për shtypjen e rrjeteve për rekrutim një vit më parë se Maqedonia. Autoritetet kosovare, më 11 gusht 2014 arrestuan 40 persona të dyshuar se kanë lidhje me ISIS-in dhe al-Nusra-n[62], ndërsa autoritetet boshnjake arrestuan 15 persona të dyshuar për financimin e terrorizmit dhe rekrutimin e luftëtarëve më 3 shtator 2014.[63] Në këtë periudhë kohore ka pasur kritika në rritje ndaj autoriteteve maqedonase që nuk kanë ndërmarrë asnjë veprim të ngjashëm. Një tjetër kritikë ka qenë mungesa e transparencës në periudhën e pas-operacionit Celula. Shumë informata të kufizuara janë dhënë për publikun e gjërë sa i përket procesit gjyqësor kundër të dyshuarve. Mungesa e transparencës mund të çojë në dyshime të panevojshme në mesin e popullatës civile rreth motiveve pas këtij akcioni policor, duke shkaktuar frikë në mesin e popullatës se kjo mund të jetë një proces i motivuar politikisht.

Operacioni gjyqësor “Celula”

Më 25 mars 2016, gjashtë prej të dyshuarve në operacionin ‘Celula’ u dënuan me heqje lirie në sesionin e parë gjyqësor të hapur për këtë rast. Këta gjashtë persona u shpallën fajtorë dhe arritën një marrëveshje me prokurorinë. Më 16 maj pesë të dyshuar të tjerë (Isa Fuga, Abdullah Abdullahi, Eroll Rrustemi, Muhamed Imeri, dhe Stefan Stefanovski) u deklaruan gjithashtu fajtorë, edhe pse fillimisht nuk e kishin pranuar fajin. Më poshtë është një profil i 11 personave të dënuar.

[60] Vecer. “ Детали за операција ‘Ќелија 2’(Detaje mbi operacionin 'celula 2')". 9 korrik 2016. E qasur më 9 korrik 2016. http://vecer.mk/makedonija/detali-za-kjelija-2-eve-koi-se-uapsenite-pominale-voeno-teroristichka-obuka-vo-sirija

[61] 24 vesti. “ИВЗ не контролира две џамии, бара помош од МВР (BFI nuk ka kontroll mbi dy xhami, kërkon ndihmë nga MPB "). 19 gusht 2014. E qasur më 16 janar 2016. http://24vesti.mk/BFI-ne-kontrolira-dve-dzamii-bara-pomosh-od-mvr

[62] BBC. "Policia e Kosovës neto Irak dhe Siri dyshuar 'militante'". 11 gusht 2014. Qasur më 18 janar 2016. http://www.bbc.com/news/world-europe-28739084

[63] Dojçe Vele. "Policia boshnjake arrestuan më shumë se dhjetra persona për mbështetjen e terrorizmit në Irak, Siri." 3 shtator 2014. Qasur më 18 janar 2016. http://www.dw.com/en/bosnia-police-arrest-more-than-a-dozen-for-supporting-terrorism-in-iraq-syria/a-17896851

Rexhep Memishi, 36 vjeç, imam nga xhamia famëkeqe Tutunsus në Shkup. Dënuar me 7 vjet burg për rekrutim për organizatat e huaja paraushtarake që i nënshtrohen nenit 322-a të kodit penal. Memishi, i cili është i martuar dhe ka dy fëmijë, nuk ka të dhëna të mëparshme penale. Ai konsiderohet si rekrutuesi kryesor për ISIS-in në Maqedoni.

Ahmet Dardhishta, një punonjës qeveritar 31-vjeçar u dënua me 5 vjet e gjysmë burg për organizimin dhe financimin e rekrutimit dhe transportit për organizatat e huaja paraushtarake që i nënshtrohen nenit 322-a të kodit penal.

Sejfula Evdemovski 32 vjeç, u dënua me 5 vjet burg për logjistikë dhe u përpoq në pjesëmarrjen në organizatat e huaja paraushtarake, që i nënshtrohet nenit 322-a të kodit penal. Ai u përpoq për t'iu bashkuar luftës në Siri, por u ndalua në aeroportin e Stambollit dhe dëbohet për në Maqedoni.

Resul Saiti në moshën 22-vjeçare është më i riu nga të gjithë të dënuarit. Ai u dënua me 5 vjet burg për ndihmë logjistike për qytetarët nga Maqedonia të cilët iu bashkuan luftës në Siri, i nënshtrohet nenit 322-a të kodit penal.

Fazli Sulja, një argjendar 23 vjeçar, u dënua me 5 vjet burg për pjesëmarrje në organizatat e huaja paraushtarake që i nënshtrohen nenit 322-a të kodit penal. Ai udhëtoi për në Siri nëpërmjet aeroportit të Shkupit në 21 shkurt 2015. Gjatë kohës së tij atje ai ngarkoi fotografi nga përpara në profilet nëpër rrjete sociale.

Muhamed Shehu, një 27 vjeçar i papunë nga Gostivari u dënua me 5 vjet burg për pjesëmarrje në organizatat e huaja paraushtarake që i nënshtrohen nenit 322-a të kodit penal. Shehu nuk ka të dhëna të mëparshme penale dhe, si Fazli Sulja, kishte ngarkuar fotografi nga përpara deri në profilet nëpër rrjete sociale.

Isa Fuga, 24 vjeçar nga Shkupi nuk ka të dhëna të mëparshme penale. Është dënuar me 4 vjet e gjysmë burg për pjesëmarrje në një organizatë të huaj paraushtarake i nënshtrohet nenit 322-a të kodit penal.

Abdulah Abdulahi, 27-vjeçar nga Tetova i cili është i martuar dhe është baba i 5 fëmijëve. Ai nuk ka të dhëna paraprake penale. I dënuar me 3 vjet e 1 muaj në burg për pjesëmarrje në një organizatë të huaj paraushtarake i nënshtrohet nenit 322-a të kodit penal.

Erol Rustemi, 36-vjeçar i papunë u dënua me 6 vjet burg për organizimin e transportit për luftëtarë të huaj dhe gjithashtu mori pjesë në një organizatë të huaj paraushtarake i nënshtrohet nenit 322-a të kodit penal.

Muhamed Imeri, 38-vjeçar shofer taksi nga Shkupi i dënuar me 2 vjet burg për pjesëmarrje në një organizatë të huaj paraushtarake i nënshtrohet nenit 322-a të kodit penal.

Stefan Stefanovski është i vetmi i dënuar me etnicitet maqedonas në rastin "celula". Ai është 32 vjeç dhe është mjek. Ai u thirrë në betimin e Hipokratit gjatë gjykimit, duke thënë se nuk ka asgjë të keqe në dhënien e ndihmës mjekësore njerëzve pavarësisht nga besimi i tyre, raca dhe kombësia. Ai është dënuar me dy vjet burg për pjesëmarrje në një organizatë të huaj paraushtarake i nënshtrohet nenit 322-a të kodit penal.

Burimet: www.akademik.mk[64]; www.faktor.mk[65]

[64]Akamedik. "Случај 'Ќелија': Казни затвор од 5 до 7 години за признание за учество во паравоена формација(Rasti Celula, dënime 5 deri 7 vite heqje lirie për pranim për pjesëmarrje në formacione paraushtarake)".25 Mars, 2016. E qasur poashtu më 25 Mars, 2016 http://www.akademik.mk/sluchaj-kjelija-kazni-zatvor-od-5-do-7-godini-za-priznanie-za-uchestvo-vo-paravoena-formatsija/

[65] Faktor. "Случај 'Ќелија': Ќе се оценува дали ќе има судење за осомничените исламски регрутатори. (Rasti Celula: Evaulim se a do të ketë gjykim për rekrutuesit islamik) 25 Mars,

Shumëllojshmëria e profileve të të dënuarve në operacionin “Celula” na tregon se rruga drejt ekstremizmit të dhunshëm nuk është gjetur gjithmonë nga llojet e veçanta të personave me lloje të caktuara të së kaluarës. Kjo në njëfarë mase demaskon supozimin se ekstremistët e dhunshëm dhe luftëtarë të huaj vijnë nga varfëria, nuk janë të arsimuar mirë dhe kanë të dhëna paraprake penale. Ne shohim se këto atribute, edhe pse të vërteta në disa raste, nuk janë një e dhënë e saktë. Fakti që ekziston një mjek, një punonjës i qeverisë, një argjendar, si dhe njerëz shumë të rinj dhe më të pjekur, tregojnë vështirësi dhe gabime në përcaktimin e një kategorie të caktuar të njerëzve.

2016. E qasur poashtu më 25 Mars, 2016 http://faktor.mk/2016/03/25/sluchaj-kelija-ke-se-otsenuva-dali-ke-ima-sudene-za-osomnichenite-islamski-regrutatori/

3.3.4 Agjencioni i inteligjencës

"Agjencioni është themeluar dhe është vazhdimisht në zhvillimin të mekanizmave të përshtatshme për parandalimin, parashikimin, paralajmërimin e hershëm dhe vlerësimin e rreziqeve. Informon autoritetet shtetërore të Republikës së Maqedonisë për proceset që gjenerojnë kërcënime për sigurinë kombëtare dhe për parimet e përhershme dhe jetike për të krijuar një mjedis të qëndrueshëm të sigurt dhe zhvillim të qëndrueshëm afatgjatë."

Burimi: Uebfaqja e Agjencionit të Inteligjencës. http://ia.gov.mk/nadelzni.html

Agjencioni për Kundërzbulim (AI) është agjencion i Maqedonisë për tubimin e inteligjencës së jashtme. AI mbledh inteligjencë dhe informacione, jashtë territorit të Maqedonisë, që është me rëndësi për sigurinë e Maqedonisë. Është e rëndësishme që AI është e përfshirë në luftimin e ekstremizmit të dhunshëm, pasi që ajo mund të marr informacione për qytetarët e Maqedonisë që udhëtojnë për qëllime të bashkimit në ushtritë e huaja dhe në formacionet paraushtarake dhe të vlerësojë rrezikun e shtetasve të huaj që udhëtojnë në Maqedoni (të përcaktojnë nëse ato kanë lidhje me grupet ekstremiste). Është e rëndësishme që procesi i shpërndarjes së informatave të Agjencisë së Inteligjencës dhe mes DSK-së dhe MPB-së të jetë në nivelin e duhur, në mënyrë që dy institucionet e fundit të mund të reagojnë ndaj informatave të marra nga Agjencia për Inteligjencë.

AI ka ndjekur zhvillimet e radikalizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm për vite me radhë dhe ka një drejtori të veçantë që merret me këtë çështje. AI mbledh informacione nëpërmjet bashkëpunimit dypalësh me agjencitë miqësore dhe partnere nëpërmjet shkëmbimit multilateral të zbulimit në kuadër të komunitetit të shërbimeve të inteligjencës juglindore evropiane[66]. Kur Agjencioni i Inteligjencësmerr informacione në lidhje me qytetarët e Maqedonisë në Siri, ose ata që udhëtojnë atje, ata ndajnë këtë informacion me DSK-në dhe MPB-në, përveç rasteve kur ky informacion nuk mund të ndahet për shkak se është marr nëpërmjet marrëveshjeve specifike për ndarjen e inteligjencës me agjencitë e huaja.

Sipas Agjencisë së Inteligjencës, ndarja e inteligjencës në temën e luftëtarëve të huaj dhe ekstremistëve të dhunshëm në rajon është në një nivel të mirë, kurse e njëjta nuk mund të thuhet sa i përket shpërndarjes së inteligjencës mbi tema të tjera.[67]

[66] Intervistë me një punëtorë në AI. E bërë më 23 mars 2016.
[67] Intervistë me një punëtorë në AI. E bërë më 23 mars 2016.

3.3.5 Misioni i OSBE-së në Shkup

Që nga viti 2011, Misioni i OSBE-së në Shkup ka mbështetur forcimin e kapaciteteve të Ministrisë së Punëve të Brendshme në luftën kundër terrorizmit duke ofruar kurse trajnimi në fushat kyçe, duke përfshirë 'Parandalimin e radikalizmit dhe rekrutimit të terroristëve të mundshëm.'

Në fund të vitit 2014, OSBE-ja në Maqedoni filloi një projekt që fokusohet në zbulimin e hershëm të radikalizmit. Projekti është i bazuar në CoPPRa (PKPR -Policimi në Komunitet dhe Parandalimi i Radikalizimit) një projekt që është vënë në veprim që nga viti 2010 për të ndihmuar në zhvillimin e mjeteve për kundërvënie ndaj ekstremizmit të dhunshëm me zbulimin e hershëm të radikalizmit. Për këto qëllime ishte krijuar një grup pune që përbëhej nga DSK-ja dhe policia e uniformuar. Është e rëndësishme që OSBE-ja ishte në gjendje të bashkojë DSK-në dhe policët e uniformuar. Ky grup pune ka bërë doracakë për t'i mësuar reaguesit e parë në lidhje me shenjat e radikalizimit[68].

Projekti përqëndrohet në trajnimin e policëve të cilët do të ushtrojnë kolegë të tjerë dhe të ndajnë njohuritë e fituara. Njohja e radikalizmit në fazat e hershme është kritike pasi është shumë më e lehtë për të zhbindur dikë që të kryejë ndonjë akt të terrorit në qoftë se individi është ende në fazën e hershme të radikalizmit. Kjo është faza ku individët ende nuk e kanë kryer ndonjë akt dhune dhe ata madje mund të mos parashikojnë të ndjekin rrugën e dhunës. Është e rëndësishme që të mos i trajtojmë këta individë si terroristë dhe të mos i diskriminojmë e t'i izolojmë. Në vend të kësaj, fokusi duhet të jetë për t'u ndihmuar të zhvillojnë aftësitë e të menduarit kritik, të cilat mund të ndihmojnë ata të sfidojnë rrëfimet radikale ndaj të cilave janë tërhequr.

Katër trajnuesit dhe njëzet polic të rangut të lartë nga Ministria e Brendshme kanë kaluar në një trajnim njëvjeçar në kuadër të policimit në Komunitet dhe parandalimin e programit të radikalizmit. Ky është një zhvillim pozitiv, pasi që këta 24 persona kanë marrë trajnimin e duhur në njohjen e shenjave potenciale të terrorizmit apo ekstremizmit në komunitetet ku ata punojnë. Për fat të keq, për momentin OSBE-ja në Shkup nuk është duke u angazhuar me komunitetet lokale, por ata e kanë synim planet e tyre në të ardhmën. OSBE-ja ka për qëllim të zgjerojë projektin e tyre për të përfshirë të gjitha shtyllat e komunitetit, si udhëheqësit fetarë, mësuesit dhe prindërit[69]. Kjo është shumë e rëndësishme, pasiqë është e rëndësishme për t'u angazhuar komunitetet si një e tërë, me objektiv të përfshirjes së komunitetit në identifikimin dhe të kuptuarit e problemeve dhe së bashku të punojnë në zgjedhjen dhe masat parandaluese që do të jenë më të përshtatshme për komunitetin e theksuar. Është gjithashtu e rëndësishme që të krijohet një ndjenjë besimi në mes të zbatimit të ligjit dhe komunitetit.

---

[68] Intervistë me një këshilltar të lartë për trajnimin e policisë në OSBE. E bërë më 16 dhjetor 2015.

[69] Intervistë me një këshilltar të lartë për trajnimin e policisë në OSBE. E bërë më 16 dhjetor 2015.

3.3.6 Ministria e Punëve të Jashtme

Ministria e Punëve të Jashtme gjithashtu luan një rol të rëndësishëm në procesin e kundërvënies ndaj ekstremizmit të dhunshëm. Kompleksiteti i radikalizmit do të thotë se përpjekjet për kundërvënie ndaj ekstremizmit të dhunshëm duhet të jenë të koordinuara mes vendeve përmes bashkëpunimit rajonal dhe si pjesë e një strategjie globale. Shtetet duhet të punojnë në mënyrë bilaterale dhe multilaterale për të mbështetur dhe forcuar luftimin e terrorizmit dhe kapacitetet për kundërvënie ndaj ekstremizmit të dhunshëm dhe për të ndarë praktikat e mira dhe mësimet e nxjerra në adresimin e kërcënimit. Në dritën e kësaj, pritet që MPJ-a do të bashkohet me nismat rajonale dhe të punojë në rritjen e bashkëpunimit në rajon sa i përket kundërvënies ndaj ekstremizmit të dhunshëm.

Në kuadër të MPJ, Sektori Ndërkombëtar dhe rajonal Politik/Bashkëpunimi i Sigurisë është përgjegjës për bashkëpunim me vendet nga rajoni në temën e kundërvënies ndaj ekstremizmit të dhunshëm. Në mbledhjet e grupit të Adriatikut 5[70], në të cilën Maqedonia është anëtare, çështja e luftëtarëve të huaj dhe kundërvënies ndaj ekstremizmit të dhunshëm është gjithmonë lartë në agjendë[71]. Maqedonia është gjithashtu anëtare e iniciativës së BE-së në Ballkanin Perëndimor kundër terrorizmit, një iniciativë e BE-së që ka për qëllim “eliminimin e dublimeve të mëtejshme dhe përsëritjes së aktiviteteve në luftën kundër terrorizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm në rajonin e Ballkanit Perëndimor.” [72]

Maqedonia është pjesë e koalicionit kundër ISIS-it e udhëhequr nga SHBA-ja. Megjithatë ka informacione të pamjaftueshme mbi atë se si pikërisht Maqedonia kontribuon në këtë koalicion. Maqedonia në mënyrë të ngjashme është bashkuar në sanksionet e BE-së kundër qeverisë siriane dhe u pajtuan për masat kufizuese[73]. Vendet e tjera të Ballkanit si Shqipëria[74] dhe Kroacia[75] janë raportuar t’u kenë dërguar armë rebelëve në Siri.

---

[70]Adriatik 5 është një organizatë e themeluar më 2 maj të vitit 2003, aktualisht përbëhet nga Kroacia, Maqedonia, Shqipëria, Mali i Zi dhe Bosnje-Hercegovinës krijuar me qëllim që të ndihmojë përpjekjet e tyre për t'u bashkuar me NATO-n. Shqipëria dhe Kroacia ndërkohë iu bashkuan NATO-s më 1 prill 2009.

[71] Intervistë me Vilma Pektovskën, Asistent drejtor i sektorit për bashkëpunim ndërkombëtar rajonal për Politikë/Siguri në MJP. E bërë më 15 dhetor 2016.

[72] Këshilli i Bashkimit Evropian. “BE - Ballkani Perëndimor nisma kundër terrorizmit: plani integrues i veprimit”.4 dhjetor 2015. E qasur më 20 shkurt 2016.
http://www.statewatch.org/news/2015/dec/eu-council-western-balkans-antiterrorism-13887-15.pdf

[73] Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë. Numër 133. 26 shtator 2013. E qasur më 19 shkurt 2016.
http://www.slvesnik.com.mk/Issues/0d60d644027547028dfcbd154fbf180e.pdf .

[74] Balkan Insight. 'Shqipëria fillon të shkëmbej armë me kurdët e Irakut ". 27 gusht 2014. E qasur më 19 shkurt 2016.
http://www.balkaninsight.com/en/article/albania-starts-delivery-of-weapons-to-iraqi-kurds

[75] ‘SHBA dhe Evropa në transportin ajror të madh të armëve rebelëve sirianë nëpërmjet Zagrebit. 8 mars 2013. E qasur më 20 shkurt, 2016.’
http://www.telegraph.co.uk/news/worldnews/middleeast/syria/9918785/US-and-Europe-in-major-airlift-of-arms-to-Syrian-rebels-through-Zagreb.html

3.3.7 Bashkësia Fetare Islame (BFI)

Udhëheqësit fetarë dhe ata lokal janë aktorë kyç për kundërvënie ndaj ekstremizmit të dhunshëm, pasi që ata janë anëtarë të besuar të komunitetit që janë të mirëvendosur brenda komuniteteve sa i përket marrëdhënieve me komunitetet, por edhe në aspektin e pranisë së tyre fizike dhe mund të këshillojnë dhe mbështesin zhvillimin e iniciativave të duhura për kundërvënie ndaj ekstremizmit të dhunshëm. Ata gjithashtu mund të rekomandojmë bashkëbisedues të besueshëm që mund të marrin pjesë në këto aktivitete[76]. Për këtë arsye është e rëndësishme që udhëheqësit fetarë të jenë të angazhuar në mënyrë aktive në komunitetet e tyre dhe tëpërhapin kundërthirrje. Udhëheqësit fetarë duhet të punojnë edhe me zbatimin e ligjit në zhvillimin e strategjive të duhura kundër radikalizmit. Në këtë fazë është e rëndësishme që institucionet shtetërore të njohin rëndësinë e bashkëpunimit me udhëheqësit fetarë në komunitetet përkatëse. BFI-ja është komuniteti zyrtar fetar islam në Maqedoni. Ata propagandojnë një zë mesatar të Islamit dhe janë kundër përdorimit të dhunës në emër të çdo feje. BFI-ja ka qenë aktive në aspektin e të folurit kundër bashkimit të njerëzve në grupe të dhunshme dhe ka zhvilluar një propozim për një projekt për parandalimin e radikalizimit dhe përfshirje në terrorizëm, në bashkëpunim me organizatën humanitare Hilal. Strategjia e projektit të tyre është fuqizimi i zërave të moderum nëpërmjet ndërgjegjësimit publik dhe të pranisë së tyre në komunitetin musliman në Maqedoni, duke punuar edhe në risocializimin e ish-luftëtarëve të huaj. Projekti kishte për qëllim të kundërshtojë thirrjet në "versionin e shtrembëruar të Islamit" i predikuar nga radikalët. BFI-ja beson se forcimi i zërit fetar që përcjell atë mesazh që sipas tyre është porosia e drejtë e Islamit tek muslimanët në Maqedoni duhet të jetë ndërhyrja e parë dhe e menjëhershme brenda kongregacioneve muslimane[77].

Projektpropozimi gjithashtu përmbante edhe elemente të mbështetjes për familjet që kanë pasur ndonjë anëtar që u është bashkuar ushtrive të huaja. Këto familje përballen me një barrë të madhe psikologjike dhe stigmatizim shoqëror nga komuniteti. Shtylla finale e projektit ishte lehtësimi i ri-integrimit në shoqëri të luftëtarëve të huaj që janë kthyer në Maqedoni. Ky projekt megjithatë kurrë nuk arriti të merr fondet e kërkuara dhe është për momentin në pritje. Përfaqësuesit e BFI-së janë ankuar se autoritetet shtetërore nuk bashkëpunojnë me ta në çështjen e kundërvënies ndaj ekstremizmit të dhunshëm dhe ata kanë qenë të ftuar vetëm ne një takim lidhur me luftimin e ekstremizmit të dhunshëm[78] (me presidentin Ivanov). Sipas tyre, shkalla e lartë e papunësisë dhe gjendja e përgjithshme e keqe ekonomike për të rinjtë në Maqedoni është një nga arsyet kur është fjala për radikalizimin. Në një situatë ku të rinjtë nuk shohin asnjë shpresë për një të nesërme më të mirë, ata paraqesin objektiva të lehta për manipulim. [79]

---

[76] Hedayah. "Rolet e familjeve dhe komuniteteve në Forcimin e qëndrueshmërise në komunitet kundër ekstremizmit të dhunshëm". Maj 2014. Qasur më 20 shkurt 2016.
[77] Parandalimi i radikalizmit dhe përfshirjes në terrorizëm (STOP radTerr) Propozimi i projektit. Organizata Humanitare Hilal
[78] Intervistë me zyrtar të rangut të lartë në BFI Maqedoni. E bërë më 17 shkurt 2016
[79] ibid

3.3.8 Organizatat e Shoqërisë Civile (OShC)

Organizatat e shoqërisë civile nuk kanë lidhje me përfaqësimin, por kanë lidhje me pjesëmarrjen dhe kanalizimin e zërave të ndryshëm brenda shoqërisë. Ato mund të krijojnë platforma të dialogut dhe të sigurojnë gjithëpërfshirjen e nevojshme në shoqëri si një përgjigje ndaj përjashtimit që mund të çojë në radikalizimin e dhunshëm.

Përfundim nga punimi "Shoqëria Civile e angazhuar në Luftën Kundër Ekstremizmit të Dhunshëm" nga Qendra Ndërkombëtare Kundër Terrorizmit-Hagë

Sektori i shoqërisë civile është duke u njohur si një aktor i rëndësishëm në Parandalimin / Kundërvënies ndaj Ekstremizmit të Dhunshëm, mënyra se si ajo i vëzhgon dhe trajton kushtet që e bëjnë përhapjen e ideve të dhunshme më të lehtë, ndërsa gjithashtu të jetë në gjendje të veprojë si një ndërmjetës në mes të popullatës civile dhe qeverisë, sidomos në zonat ku ka një mungesë të dukshme të besimit n[institucionet shtetërore. Sektori i shoqërisë civile mund të veprojë si një monitorues i strategjisë për kundërvënie ndaj ekstremizmit të dhunshëm, sikur se edhe qeveria, pavarësisht qëllimeve të mira; seriozisht shkelin mbi të drejtat dhe liritë e njeriut me taktikat e tyre për kundërvënie ndaj ekstremizmit të dhunshëm. Shoqëria civile në Maqedoni, për dallim nga ajo e Kosovës, nuk njihet nga institucionet shtetërore dhe nuk participon në mënyre aktive dhe partnere relevante në Kundërvënien ndaj Ekstremizmit të . Si rrjedhoje, ato janë pak apo aspak të përfshira në këtë proces. Numri i organizatave që punojnë në këtë temë është mjaft i limituar. Po aq e rëndësishme është të përmendet mungesa e dijës në këtë temë në mesin e organizatave. Think Tanku Analitika duket të jetl e vetmja organizatë në shtet që ofron të dhëna apo hulumton çështjen e ekstremizmit të dhunshëm.

3.3.9 Komunat lokale

Parandalimi i ekstremizmit të dhunshëm kërkon një strategji të "angazhimit dhe fuqizimit të individëve dhe grupeve në nivel lokal për të ndërtuar qëndrueshmëri kundër ekstremizmit të dhunshëm"[80]. Komunitetet kanë një rol kyç në njohjen dhe kundërvënien ndaj ekstremizmit të dhunshëm, pasiqë është diçka që ndodh në lagjet e tyre, njerëzve të cilët janë të afërmit e tyre, miqtë e tyre dhe njerëzit që i njohin. Prandaj, është e rëndësishme për të pajisur komunitetet me aftësi dhe mjete të duhura në mënyrë që ata të mund të merren me këtë kërcënimin që po dëmton komunitetin e tyre. Autoritetet lokale në Maqedoni për fat të keq nuk kanë asnjë iniciativë kur është fjala për kundërvënien ndaj ekstremizmit të dhunshëm. Këshillat lokal për parandalimin që janë vendosur nëpër komuna nuk kanë funksionuar si duhet; ata takohen rregullisht, mirëpo çështja e kundërvënies ndaj ekstremizmit të dhunshëm nuk është në agjendën e tyre kur takohen.

[80] Shtepia e Bardhe. "Fuqizimi i partnerëve lokalë për të parandaluar ekstremizmin e dhunshëm në Shtetet e Bashkuara". Gusht 2011. E qasur më 15 prill 2016. https://www.whitehouse.gov/sites/default/files/empowering_local_partners.pdf

4. Bashkëpunimi rajonal

Kjo pjesë shqyrton dinamikat rajonale të çështjes së luftëtarëve të huaj dhe radikalizimit që mund të çojë në ekstremizëm të dhunshëm. Ajo thekson rëndësinë e bashkëpunimit rajonal duke treguar se sa i ndërlidhur është rajoni kur është fjala për këtë kërcënim. Gjithashtu thekson specifikat lokale të shteteve nga rajoni.

Kërcënimi nga rritja e radikalizmit dhe luftëtarëve të huaj është një shqetësim i përbashkët për të gjitha shtetet e Ballkanit Perëndimor. Për shkak të natyrës globale të ekstremizmit të dhunshëm, është e pamundur që shtetet të merren me këtë çështje të vetëm.

Rritja e radikalizimit nuk është vetëm një çështje e sigurisë kombëtare për shtetet individuale; por gjithashtu kërcënon stabilitetin rajonal duke polarizuar më tepër ndarjet fetare në një rajon të njollosur nga marrëdhëniet e brishta etnike.

Kjo është arsyeja pse bashkëpunimi rajonal në të gjitha nivelet është i nevojshëm, për të luftuar me sukses radikalizimin dhe rekrutimin e luftëtarëve të huaj. Kjo është veçanërisht e vërtetë në një rajon si Ballkani Perëndimor, ku shtetet ndajnë probleme të ngjashme të sigurisë. Autoritetet në rajon përballen edhe me sfida tjera të përbashkëta ndaras nga ai i problemit me luftëtarët e huaj, siç janë krimi i organizuar, korrupsioni, nacionalizmi, normat e larta të papunësisë në veçanti në mesin e të rinjve, dhe shumë të tjera.

Një zhvillim pozitiv është se duket se i gjithë rajoni është dakord kur është fjala për të bërë përpjekje për të luftuar fenomenin e luftëtarëve të huaj dhe ekstremizmit të dhunshëm. Vendet e rajonit kanë ndryshuar kodet e tyre penale në mënyra të ngjashme, si dhe mekanizma të tjera ligjore që lejojnë ndërhyrje e që kanë për qëllim frenimin e rekrutimit dhe pjesëmarrjes së shtetasve të tyre në konflikte të armatosura jashtë vendit. Në të njëjtën kohë, të gjithë liderët nga rajoni janë zotuar të kryejnë përpjekje të fuqishme për të luftuar ISIS-in. Ka pasur disa takime të nivelit të lartë që përfshijnë autoritetet nga rajoni në këtë temë. Më 1 tetor 2015, ministrat e Punëve të Jashtme të vendeve nga Evropa juglindore kanë pasur një takim jozyrtar në Nju Jork në margjinat e Asamblesë së Përgjithshme të KB-së, ku kanë rënë dakord për t'i koordinuar aktivitetet e tyre kundër ekstremizmit të dhunshëm. Ata e pranuan propozimin e Këshillit të Bashkëpunimit Rajonal për të formuar një platformë për bashkëpunim rajonal kundër ekstremizmit të dhunshëm dhe fenomenit të luftëtarëve të huaj[81].

Edhe pse iniciativat rajonale janë të vendosura, disa përfshijnë vetëm disa shtete të rajonit dhe disa që shtrihen përtej kufijve të rajonit, mirëpo ekziston nevoja për bashkëpunim më të ngushtë, jo vetëm në nivel politik, por edhe në nivel teknik. Në raportin nga 5 maj 2014

[81] Nova Tv. "Земјите од ЈИЕ заеднички ќе се борат против насилниот екстремизам и тероризам (Vendet e Evropës Juglindore do të luftojnë ekstremizmin e dhunshëm dhe terrorizmin së bashku). Qasur më 20 dhjetor 2015. http://novatv.mk/index.php?navig=8&cat=5&vest=24678

nga Koordinatori i BE-së Kundër Terrorizmit në Këshillin e BE-së, thuhet se Ballkani Perëndimor kërkon bashkëpunim më të ngushtë. Raporti i përshkroi gjithashtu iniciativat e mundshme që do të mbështesnin këtë bashkëpunim më të ngushtë rajonal[82].

Maqedonia dhe vendet e rajonit janë pjesë e "Iniciativës anti-terroriste të BE-së për Ballkanin Perëndimor: Plan integrues i veprimit i iniciuar nga Këshilli i Bashkimit Evropian". Kjo iniciativë ka për qëllim të "eliminojë dublime të mëtejshme dhe përsëritje në luftën kundër terrorizmit dhe aktiviteteve kundër ekstremizmit të dhunshëm në rajonin e Ballkanit Perëndimor"[83]. Kjo iniciativë është bazuar në supozimin se kundërvënia ndaj ekstremizmit të dhunshëm në Ballkan kërkon një qasje të koordinuar të të gjithë aktorëve që veprojnë në rajon. Dhe, duke marrë parasysh se vendet e rajonit kanë burime të kufizuara për Kundërvënie ndaj Ekstremizmit të Dhunshëm, është gjithashtu e rëndësishme që këto burime të përdoren në mënyrë efikase. Iniciativa ka përcaktuar disa objektiva:

- **OBJEKTIVI 1:** Të rrisë komunikimin dhe shkëmbimin e informacionit (funksional/strategjik) në mes të palëve të relevante në rajon;
- **OBJEKTIVI 2:** Të mbështesë zhvillimin e kapaciteteve kombëtare të Rrjetit të ndërgjegjësimit të radikalizmit (RAN); parandalimin dhe komunikimin strategjik në rajon me mbështetjen e ekspertizës RAN të BE-së;
- **OBJEKTIVI 3:** Identifikim më të mirë të rreziqeve në kufi, luftëtarëve të huaj terroristë dhe mangësive në ushtrimin e masave operative;
- **OBJEKTIVI 4:** Parandalim të financimit të terrorizmit;
- **OBJEKTIVI 5:** Rritjen e kapaciteteve analitike dhe efikasitetit të masave operacionale;
- **OBJEKTIVI 6:** Të fitojë një kuptim më të mirë të situatës momentale, boshllëqeve dhe nevojave për të rritur efikasitetin e veprimeve, të rregullojë planifikimin dhe parandalimin e dublimit dhe mbivendosjes;
- **OBJEKTIVI 7:** Të ngrisë vetëdijen dhe shkëmbimin e praktikave më të mira për Riintegrim dhe Rehabilitim;

[82] Council of the European Union "Foreign fighters and returnees from a counter-terrorism perspective, in particular with regard to Syria: state of play and proposals for future work." (Këshilli i Bashkimit Evropian "Luftëtarët e huaj dhe të kthyer nga një perspektivë kundër terrorizmit, në veçanti në lidhje me Sirinë: gjendja dhe propozime për punën në të ardhmen.") 5 Maj, 2014. Qasur më 20 dhjetor 2015. http://www.statewatch.org/news/2014/may/eu-council-coter-syrian-fighters-9280-14.pdf

[83] Council of the European Union "EU Western Balkan counter-terrorism initiative: integrative plan of action". 4 dhjetor 2015. (Këshilli i Bashkimit Evropian ":Plani integrues i veprimit "). Qasur më 21 dhjetor 2015. http://www.statewatch.org/news/2015/dec/eu-council-western-balkans-antiterrorism-13887-15.pdf

- **OBJEKTIVI 8:** Të zhvillohet komunikim strategjik dhe kapacitete monitorimi nëpërmjet internetit;

- **OBJEKTIVI 9:** Të miratojë/zbatojë strategji për Luftë kundër Terrorizmit/ Kundërvënie ndaj Ekstremizmit të Dhunshëm, plane të veprimit dhe të shkëmbejë ose përdorë praktika të mira të cilat do të ndikojnë në shumë nga objektivat e mësipërme.

Për secilin objektiv ka aktivitete dhe masa të caktuara që duhen të ndërmerren. Kjo iniciativë është e rëndësishme sepse ajo trajton aspekte të ndryshme të procesit të Kundërvënies ndaj Ekstremizmit të Dhunshëm dhe punon në tejkalimin e pengesave duke rritur kapacitetet kombëtare dhe duke e forcuar si dhe duke e bërë më efikas bashkëpunimin rajonal.

4.1 Dimensioni rajonal i çështjes

Rajoni i Ballkanit gjatë dy dekadave të fundit ka qenë i përfshirë në krijimin dhe bashkimin e platformave të ndryshme për luftimin e krimit transnacional. Shembujt përfshijnë rrjetet sikur INTERPOL, EUROPOL, Organizata Botërore e Doganave (OBD), Grupi Këshillues i prokurorëve të Evropës Juglindore (SEEPAG), Këshilli për Bashkëpunim Rajonal (RCC), dhe Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE), ndër të tjera. Këto janë platformat që veprojnë më së shumti në rajon, pa bërë dallim se a kanë mbështetur reformat e sektorit të sigurisë në mënyrë direkte ose në qoftë se ato kanë shërbyer vetëm si platforma rajonale për vendosjen e dialogut midis shteteve. Për më tepër, disa prej tyre shërbejnë edhe herë pas here për të lehtësuar bashkëpunimin ndër-institucional si dhe shkëmbimin i informacionit, gjë që shpesh është treguar të jetë vendimtare për trajtimin e veprimtarisë kriminale ndërkufitare.

Megjithatë, duhet të kemi parasysh historinë e rajonit dhe armiqësitë që janë trashëguar pas shpërbërjes së Jugosllavisë gjatë fillimit të viteve 1990, me serinë e trazirave politike dhe konflikteve që rajoni përjetoi. Marrëveshje të reja bilaterale për bashkëpunim në çështjet e sigurisë duhej të rivendosen me çdo shtet të ri të pavarur. Për shembull, që nga viti 1996, Maqedonia dhe Serbia kanë nënshkruar mbi 60 marrëveshje dypalëshe, nga të cilat 53 tashmë janë duke u zbatuar[84]. Në mesin e atyre marrëveshjeve të nënshkruara në mes të institucioneve të sigurisë të Serbisë dhe Maqedonisë, janë ato në lidhje me patrullat e përbashkëta të policisë, të cilat u përdoren për herë të parë në vitin 2013 gjatë muajve të verës në qytetin e Ohrit, kur aty kishte një numër më të madh të turistëve serbë[85], dhe gjatë vitit 2015 në zonën

[84] Ministry of Foreign Affairs of Republic of Macedonia, “Diplomatic Relations with Serbia” (Ministria e Punëve të Jashtme e Republikës së Maqedonisë, "Marrëdhëniet diplomatike me Serbinë") Vizituar për herë të fundit: 12.06.2016 http://www.mfa.gov.mk/index.php/mk/nadvoresna-politika/bilateralni-odnosi/sosedstvo

[85] Македонски и српски полицајци заедно патролираат низ Охрид (Policë maqedonas dhe serbë së bashku do të patrullojnë në Ohër) http://bit.ly/1VUP44R, Publikuar më 19.07.2013

kufitare mes Maqedonisë dhe Serbisë, me qëllim të ndalimit të kalimit të paligjshëm të emigrantëve[86].

Kosova shpalli pavarësinë e saj në vitin 2008, dhe Maqedonia duhej të ri-vendoste bashkëpunim institucional ndërmjet shteteve duke filluar pothuajse nga fillimi. Marrëveshje bilaterale ende janë duke u nënshkruar në mes të dy vendeve. Marrëveshja e fundit u nënshkrua në vitin 2016, në lidhje me lëvizjen e lirë vetëm me letërnjoftime[87]. Një tjetër, e nënshkruar në vitin 2013, në lidhje me menaxhimin e integruar të kufirit, me rastin e hapjes së kalimit të parë kufitar mes Kosovës dhe Maqedonisë "Belanovcë – Stançiç" (rajoni i Kumanovës)[88]. Me Shqipërinë, shumë prej marrëveshjeve bilaterale të Maqedonisë u nënshkruan shumë më herët; për shembull, Menaxhimi i Integruar i Kufirit dhe protokollet për patrulla të përbashkëta policore dhe pika kufitare kanë qenë në përdorim që nga viti 2012[89]. Këto lloj të marrëveshjeve dypalëshe ndërmjet shteteve fqinje të rajonit të Ballkanit janë të rëndësishme për luftimin e krimit të organizuar ndërkombëtar dhe ato hapin rrugën për operacione të ardhshme të përbashkëta policore, apo në rastin e Kundërvënies ndaj Ekstremizmit të Dhunshëm, çmontimin e grupeve potenciale rekrutimore ndërkufitare.

Bashkëpunimi ndërmjet autoriteteve maqedonase të sigurisë dhe ato të Kosovës është parë si i pamjaftueshëm dhe është përballur me mjaft kritika si në Prishtinë ashtu edhe në Shkup. Ka pasur raste në Kosovë ku luftëtarë të huaj të dënuar me burg kanë udhëtuar me autobus nga Kosova në Shkup, dhe pastaj kanë fluturuar nga Shkupi për në Turqi[90]. Këto raste kanë ndodhur pa u vënë re pasi që duket se ka mungesë të rrjedhës së informacionit në përgjithësi, dhe sasia e kufizuar e informacioneve që shpërndahet, nuk shpërndahet në mënyrë të duhur në mes të institucioneve të sigurisë të të dyja vendeve. Kjo mund të shihet me "Përleshjet e Kumanovës" në maj të vitit 2015[91], ku një grup i armatosur nga Kosova u përlesh me policinë maqedonase në qytetin e Kumanovës, Maqedoni. Presidenti Ivanov deklaroi se aparati i sigurisë në Maqedoni kishte njohuri në lidhje me grupin e armatosur që

---

[86] Patrullë policore Serbo-Hungareze në kufirin mes Serbisë dhe Maqedonisë[Српско-унгарски полициски патроли на границата меѓу Србија и Македонија] http://www.novamakedonija.com.mk/DetalNewsInstant.asp?vestInstant=50074, Publikuar më 29.06.2015

[87] Maqedonia dhe qytetarët e Kosovës do të kalojnë kufirin vetëm me letërnjoftime [Граѓаните на Македонија и Косово ќе ја преминуваат границата само со лична карта] http://tv21.tv/mk/?p=79522, Publikuar më: 17.04.2016

[88] MPB: Realizim i suksesshëm i konceptit të Menaxhimit të Integruar të Kufirit [МВР:Успешна реализација на концептот на интегрирано гранично управување] http://vlada.mk/node/8326; 15.02.2014

[89] Agreement between Council of Ministers of Republic of Albania and Government of Republic of Macedonia for opening the join border "Trebisht-Xhepisht" (Marrëveshja ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Maqedonisë për hapjen e kufirit të përbashkët "Trebisht-Xhepçisht") http://www.dogana.gov.al/sites/default/files/Marreveshje.pdf, 23.2.2012

[90] Three Kosovars sentenced for terrorism [Dënohen me burg tre kosovarë për terrorizëm]http://koha.net/?id=27&l=105068; 25.03.2016

[91] "Macedonia killings exacerbate political crisis" (Vrasjet në Maqedoni përkeqësojnë krizën politike) http://www.dw.com/en/macedonia-killings-exacerbate-political-crisis/a-18443806, 11.05.2015

nga fillimi i vitit 2015, por nuk është e qartë se pse kjo nuk ishte adresuar dhe si ishte trajtuar ky rast mes Maqedonisë dhe Kosovës, dhe nëse dështimi i parandalimit ishte për shkak të bashkëpunimit të dobët.

4.2 Kundërvënia ndaj ekstremizmit të dhunshëm në Ballkan

Shumica e shteteve të Ballkanit kanë ndërmarrë hapa të ngjashëm në drejtim të ndërtimit të një qasjeje efektive për t'u marrë me fenomenin e luftëtarëve të huaj. Të gjitha shtetet e Ballkanit Perëndimor kanë filluar këto hapa duke adoptuar masa shtypëse. Për shembull, secili prej shteteve ka kriminalizuar pjesëmarrjen në luftëra të huaja, Shqipëria[92] dhe Bosnja e Hercegovina[93] kanë bërë ndryshime në kodet e tyre penale në vitin 2014 në mënyrë që të jenë në gjendje të ndjekin penalisht individët që marrin pjesë në konflikte të armatosura jashtë kufijve të vendit, Kosova kriminalizoi pjesëmarrjen në konflikte të armatosura jashtë kufijve të vendit në prill të vitit 2015[94], ndërsa Maqedonia i miratoi ndryshimet legjislative në shtator të vitit 2014[95], por nuk ka ndërmarrë asnjë veprim konkret deri në një vit më vonë, në gusht të vitit 2015 me operacionin policor të quajtur "Celula"[96].

Kriminalizimi i pjesëmarrjes në luftëra të huaja u pasua me ndërhyrje të ngjashme të policisë në rajonin e Ballkanit Perëndimor, dhe një vendim i gjykatës për herë të parë ka ndodhur në mars të vitit 2015 në Bosnjë dhe Hercegovinë në bazë të trafikimit me qenie njerëzore, pasi i dënuari ishte identifikuar si një person kyç në transportin e individëve të sapo ardhur nga Bosnja dhe Hercegovina në Siri. Personi u dënua me gjashtë vite burg[97].

Edhe pse këto operacione policore ndodhën menjëherë pas ndryshimeve në legjislacion, strategjitë zyrtare për Kundërvënie ndaj Ekstremizmit të Dhunshëm u zhvilluan shumë më vonë në të gjitha vendet e Ballkanit Perëndimor. Shqipëria miratoi Strategjinë e saj kombëtare për kundërvënie ndaj ekstremizmit të dhunshëm në fund të vitit 2015 (kriminalizimi ndodhi

---

[92] Religious Radicalism and Violent Extremism in Albania (Radikalizëm religjioz dhe ekstremizëm të dhunshëm në Shqipëri) http://idmalbania.org/wp-content/uploads/2015/07/Religious-Radicalism-Albania-web-final.pdf, pg 15, IDM Tirana 2015

[93] Vlado Azinović and Muhamed Jusić, "THE LURE OF THE SYRIAN WAR: THE FOREIGN FIGHTERS - BOSNIAN CONTINGENT"(Vlado Azinović dhe Muhamed Jusić , "JOSHJA E LUFTËS SIRIANE: LUFTËTARËT E HUAJ – KONTIGJENTI BOSHNJAK") http://bit.ly/1XTdwp6, pg. 37, Sarajevo 2015

[94] Official Gazette of Republic of Kosovo, Law nr, 05/L For prohibition for joining armed conflicts outside the state's territory (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Ligji Nr, 05 / L Për ndalimin e bashkimit në konflikte të armatosura jashtë territorit të shtetit) http://bit.ly/1PZ1PKH, Prill 2015, Republika e Kosovës

[95] Burg për pjesëmarrje në ushtri të huaja [ЗАТВОР ЗА УЧЕСТВО ВО СТРАНСКИ ВОЈСКИ] http://www.akademik.mk/balkanot-4/, 05.09.2014 qasur për here të fundit më 04.07.2015

[96] Nëntë persona të arrestuar në një akcion anti-terrorist të MPB [Приведени девет лица во антитеристичката акција на МВР] http://alsat.mk/News/207907/privedeni-devet-lica-vo-antiteroristichkata-akcija-na-mvr, 06.08.2015 Qasur më 04.07.2015

[97] Vlado Azinović and Muhamed Jusić, pg 38.

në vitin 2014)[98], Kosova miratoi një Strategji për parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizimit që shpie në terrorizëm në shtator të vitit 2015, pesë muaj pasi u kriminalizua[99] dhe Bosnja dhe Hercegovina miratoi Strategjinë kundër terrorizmit në vitin 2016. Është e rëndësishme të theksohet se Kosova, Shqipëria dhe Mali i Zi miratuan Strategji për kundërvënie ndaj ekstremizmit të dhunshëm, ndërsa Bosnja e Hercegovina, Serbia dhe Maqedonia përmirësuan strategjitë e tyre anti-terroriste me një rol dytësor të adresimit të Kundërvënie ndaj Ekstremizmit të Dhunshëm dhe parandalimit të radikalizimit dhe të ekstremizmit të dhunshëm.

Kjo tregon për një dallim në qasjet e zgjedhura në strategjitë e miratuara në shtetet e Ballkanit Perëndimor, pavarësisht nga fakti se të gjitha shtetet nga Ballkani Perëndimor janë anëtare të koalicionit anti-ISIS, i cili i bën të gjithë njëlloj objektiv potencial të një sulmi terrorist[100]. Disa prej tyre kanë adoptuar strategji për Kundërvënie ndaj Ekstremizmit të Dhunshëm (Kosova dhe Shqipëria), ndërsa të tjerat (Bosnja dhe Hercegovina, Serbia dhe Maqedonia) kanë miratuar strategjitë për Luftë kundër Terrorizmit. Nuk dihet arsyeja e saktë se pse shtetet kanë vendosur ta shohin këtë kërcënim ndryshe, por kur bëjmë një krahasim, shtetet të cilat miratuan strategjitë për Luftë kundër Terrorizmit, ekstremizmin e dhunshëm e shohin si një kërcënim më të drejtpërdrejtë dhe strategjitë fokusohen më tepër në përforcimin e kapacitetit të shteteve në parandalimin e sulmeve apo menaxhimin e pasojave prej tyre. Nga ana tjetër, shtetet që miratuan strategjitë për Kundërvënie ndaj Ekstremizmit të Dhunshëm morrën një qasje më parandaluese dhe zgjodhën masa më të buta në misionin e tyre kryesor të zbatojnë në mënyrë aktive kundër-thirrje dhe forcimin e komuniteteve lokale, duke i dhënë çështjes një dimension më social. Sigurisht, ajo që është në letër dhe ajo çfarë është duke ndodhur në realitet janë dy gjëra të ndryshme. Për shembull, në rastin e Kosovës dhe Shqipërisë, numri dhe madhësia e veprimeve policore kundër luftëtarëve të huaj dhe rekrutuesve kanë qenë mjaft të forta. Edhe pse kërcënimi nga sulmet nuk mund të përjashtohet plotësisht, ekziston një argument që përdoret shpesh kundër këtij pretendimi e ai është se sulmet nuk do të ndodhin në teritorin e Ballkanit, pasi që kjo mund të ketë një efekt negativ në rekrutimet e ardhshme të luftëtarëve të huaj.[101]

Ajo që ka kontribuar në vendimin e miratimit të strategjive për Luftë kundër Terrorizmit në Maqedoni dhe Serbi nuk mund të shpjegohet vetëm duke theksuar një ose dy faktorë.

---

[98] Official Gazette of Republic of Albania(Gazeta Zyrtare e Republikës të Shqipërisë) http://www.qbz.gov.al/botime/fletore_zyrtare/2015/PDF-2015/203-2015.pdf, Nr. 203, 25.11.2015

[99] The strategy for Prevention of Violent Extremism (PEO) and Radicalisation that leads to Terrorism 2015-2020 (STRATEGJIA PËR PARANDALIMIN E EKSTREMIZMIT TË DHUNSHËM DHE RADIKALIZMIT QË SHPIE NË TERRORIZËM 2015 –2020) http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/STRATEGJIA_parandalim_-_SHQIP.pdf, Kosovo

[100] Isis official calls for 'lone wolf' attacks in US and Europe during Ramadan (ISIS bën thirrje për sulme vetmitare në SHBA dhe BE gjatë Ramazanit) http://www.independent.co.uk/news/world/middle-east/isis-official-calls-for-lone-wolf-attacks-in-us-and-europe-during-ramadan-a7042296.html, 22.05.2016 qasur për herë të fundit më 04.07.2016

[101] Qehaja, Florian – Securitization, an (un) thought consequence [Sekuritizimi, pasojë e (pa)menduar] http://sbunker.net/op-ed/33935/sekuritizimi-pasoje-e-pa-menduar/, 17.08.2015

Megjithatë, sa edhe që kjo mund të jetë e ndërlikuar, nuk mund të injorohet ndikimi i krizës së migrantëve mbi vendimin e këtyre shteteve të marrin qëndrime më mbrojtëse. Njëri nga sulmuesit në Paris kishte përdorur rrugën migrante ballkanike për të arritur në BE[102], gjë që rezultoi në rritjen e shqetësimit në Maqedoni, ku presidenti Ivanov disa herë ngriti alarme për rrezik në lidhje me përzierjen e ekstremistëve të mundshme me grupet e migrantëve[103]. Ndonëse është e rëndësishme të diskutohet mbi dimensionin e sigurisë në raport me rrjedhën e migrantëve dhe ndikimet që kjo gjendje mund ti ketë mbi shtetin, është e vështirë për të kuptuar pse migrantët të lidhur disi me ekstremistët, realisht do të parashtrojnë një kërcënim për Maqedoninë dhe qytetarët e saj, duke marrë parasysh se pjesa më e madhe e migrantëve kanë kaluar kufirin e vendit në 24-48 orë në kulmin e rrjedhës së migrantëve.

Duke pasur parasysh faktin se një nga sulmuesit në Paris ishte i regjistruar si azilkërkues në Greqi dhe Serbi[104], mungesa e rrjedhës së informacionit dhe dështimi për të regjistruar në mënyrë efektive migrantët portretizon një paaftësi tjetër kur vjen puna për komunikimin midis shteteve të Ballkanit. Për më tepër, pas sulmeve në Paris në nëntor 2015, të gjitha shtetet e rajonit shtuan masat e tyre të sigurisë, duke vendosur oficerë të armatosur rëndë të policisë dhe të ushtrisë për ruajtjen e objekteve vitale, të tilla si aeroportet dhe institucionet shtetërore.[105]

Një model tjetër që shoqëroi vendimin e Maqedonisë, Serbisë dhe Bosnjës dhe Hercegovinës për të përqafuar qasjen anti-terroriste është se mund të identifikohet se në të gjitha tre shtetet kohezioni social ka qenë dhe ende konsiderohet të jetë i brishtë. Këto vende në të kaluarën shpesh kanë përjetuar trazira ndëretnike, dhe besimi në mes të institucioneve të sigurisë dhe grupeve minoritare ende konsiderohet të jetë i ulët.

4.3 Bosnja dhe Hercegovina

Bosnja dhe Hercegovina ka zgjedhur një qasje multi-institucionale për të trajtuar fenomenin e ekstremizmit të dhunshëm, e cila mund të shihet në aktivitetet e planifikuara në strategjinë e Bosnjës dhe Hercegovinës. Për secilin aktivitet, është dhënë gjithashtu edhe institucioni i cili është përgjegjës për kryerjen e kësaj veprimtarie. Megjithatë, ky nuk është rasti me strategjinë e Maqedonisë, e cila ende e sheh luftën kundër ekstremizmit të dhunshëm si

[102] Paris attacks: Who were the attackers? (Sulmet në Paris: Kush ishin sulmuesit?) http://www.bbc.com/news/world-europe-34832512, 27.04.2016
[103] President Ivanov statement at OSCE Security Conference in Rome, Italy (Deklarata e Presidentit Ivanov në Konferencën e Sigurisë të OSBE-së në Romë, Itali) http://www.president.gov.mk/mk/2011-06-17-09-55-07/2011-07-19-10-40-39/3664-2016-03-04-11-43-09.html, 04.03.2016 së fundmi qasur më 05.07.2016
[104] Ibid.
[105] Luftëtarët e huaj të kthyer kërcënim më i madh për Maqedoninë [Повратници од војните најголема закана за Македонија] http://www.novamakedonija.com.mk/NewsDetal.asp?vest=11251510943&id=9&setIzdanie=23623 ; publikuar më 25.11.2015

diçka që është obligim vetëm i aparatit të sigurisë siç janë Ministria e Punëve të Brendshme, Ministria e Mbrojtjes, Agjencia e Inteligjencës dhe Drejtoria e Kundërinteligjencës .

Bosnja dhe Hercegovina ka paraparë që monitorimi i zbatimit të strategjisë të kryhet nga një Organ mbikëqyrës që do të krijohet posaçërisht për këtë qëllim. Ky organ siguron një qasje të koordinuar në arritjen e objektivave strategjike. Nga ana tjetër në Maqedoni strategjia e Luftës kundër Terrorizmit nuk e ka paraparë nevojën për një monitorim të dytë/organi vlerësues që do të vlerësojë punën e organeve të zbatimit, dhe si rezultat, roli i koordinatorit për Kundërvënie ndajEkstremizmit të Dhunshëm përfundon duke qenë edhe zbatuesi dhe vlerësuesi.

4.4 Kosovë

Kosova ka hartuar strategjinë e saj për Kundërvënie ndaj Ekstremizmit të Dhunshëm në bashkëpunim me të gjithë aktorët relevantë në shoqërinë e Kosovës, nga udhëheqësit fetarë dhe institucionet e sigurisë deri te OShC-të që merren me çështjet e sigurisë dhe çështjet e luftimit të ekstremizmit të dhunshëm. Të gjithë këto aktorë kanë marrë pjesë nga fazat e hershme të hartimit të strategjisë për Kundërvënie ndaj Ekstremizmit të Dhunshëm e deri në momentin kur versioni final është zhvilluar, i cili u miratua nga qeveria në vitin 2015.

Një element i veçantë pozitiv i *strategjisë për Kundërvënie ndaj Ekstremizmit të Dhunshëm dhe Radikalizmit që shpie në Terrorizëm të Kosovës* është se ajo përfshin komunitetet fetare. Gjegjësisht, bashkëpunimi dhe koordinimi me bashkësitë fetare dhe imamëve të besueshëm është theksuar në metodologjinë, aktivitetet dhe në zbatimin e kësaj Strategjie. Një qasje e tillë integruese, duke përfshirë grupet e interesit të drejtpërdrejtë, si dhe organet fetare në zbatimin e strategjive për CVE mund të kontribuojë në mënyrë të konsiderueshme për arritjen e rezultateve strategjike.[106].

Organet kryesore zbatuese për strategjinë për kundërvënie ndaj ekstremizmit të dhunshëm në Kosovë është vendosur të jenë Ministritë e Arsimit, Punës dhe Mirëqenies Sociale, Punëve të Brendshme, Ministria e Drejtësisë si institucione kyçe për implementim, dhe koordinatori për Kundërvënie ndaj Ekstremizmit të Dhunshëm nga Qeveria e Kosovës, si pjesë e një agjencie e cila bën pjesë nën këtë qeveri. Këshilli i Sigurisë së Kosovës, së bashku me koordinatorin për Kundërvënie ndaj Ekstremizmit të Dhunshëm, i cili është njiashtu këshilltar politik i kryeministrit në të njëjtën kohë, të dy së bashku janë përgjegjës për planifikimin e aktiviteteve, sigurimin e burimeve shtesë financiaredhe mbajtjen e konferencave donatore me qëllim të arritjes së zbatimit maksimal[107]. Këshilli i Sigurisë së Kosovës ka një rol

[106] Interview with Besa Ismaili, professor at the Faculty of Islamic Science – Prishtina, CVE coordinator for working with women, conducted on 21.03.2016 (Intervistë me Besa Ismaili, profesor në Fakultetin e Shkencave Islame - Prishtinë, koordinator i CVE për punët me gratë, e realizuar më 21.03.2016)

[107] Interview with Edon Myftari, PMs political advisor/CVE coordinator in Kosovo, conducted on 19.02.2016 (Intervistë me Edon Myftari, këshilltar politik i kryeministrit/koordinator i CVE në Kosovë, realizuar më 19.02.2016)

shtesë në monitorimin dhe vlerësimin e strategjisë, pasi ai vlerëson punën e të gjitha organeve të tjera zbatuese[108].

Koordinatori i për Kundërvënie ndaj Ekstremizmit të Dhunshëm i Kosovës organizoi punën e grupit punues teknik i cili ka hartuar strategjinë. Po ashtu, ai ka një rol në informimin e publikut në mënyrë të vazhdueshme për progresin për kundërvënie ndaj ekstremizmit të dhunshëm në Kosovë, duke mirëmbajtur komunikim aktiv me gazetarët, duke takuar përfaqësuesit e OShC-ve dhe duke marrë pjesë në debate, konferenca dhe të ngjajshme[109].

Ministri i Punëve të Brendshem të Kosovës, si pjesë e programit të qeverisë për Kundërvënie ndaj Ekstremizmit të Dhunshëm, ka vizituar të gjitha komunat në Kosovë dhe ka marrë pjesë në tryeza të rrumbullakëta të organizuara në pothuajse çdo qytet të Kosovës[110], me qëllim të mbështetjes së qeverive lokale në kundërvënien e fenomenit, duke i ndihmuar që të krijojnë kundër-rrëfimet e nevojshme për rritjen e ndërgjegjësimit.

Këto vizita të profilit të lartë inkurajojnë qeveritë lokale dhe policinë që të veprojnë në mënyrë më proaktive në parandalimin dhe zbulimin e shenjave të hershme të radikalizimit.[111]

Në Kosovë, autoritetet hetojnë individët që kthehen nga Siria dhe, në bazë të të gjeturave, ata vendosin se si të veprojnë. Në rastet kur njerëzit janë bërë pjesë e një grupi të moderuar, është vendosur që pasi që nuk paraqesin rrezik për Kosovën, dhe nuk kanë ndërmend të shkojnë përsëri në front, të zëvendësohet dënimi me burg me monitorim të individit[112].

Pasi të zbatohet faza fillestare e strategjisë për Kundërvënie ndaj Ekstremizmit të Dhunshëm brenda territorit të Kosovës, autoritetet e Kosovës kanë në plan të shqyrtojnë mundësitë e zgjërimit të bashkëpunimit rajonal, në aspektin se si vendet fqinje mund të japin ndihmë ose të pranojnë ndihmë, apo se si ata mund të mësojnë nëpërmjet punës së përbashkët drejt zhvillimit të masave më efektive në kundërvënien ndaj ekstremizmit të dhunshëm[113].

---

[108] STRATEGY ON PREVENTION OF VIOLENT EXTREMISM AND RADICALISATION LEADING TO TERRORISM 2015-2020; Kosovo pg. 28 (STRATEGJIA PËR PARANDALIMIN E EKSTREMIZMIT TË DHUNSHËM DHE RADIKALIZMIT QË SHPIE NË TERRORIZËM 2015 –2020 Kosovë fq. 28)

[109] Interview with official from the Kosovo Security Council, conducted on 19.02.2016 (Intervistë me zyrtar nga Këshilli i Sigurisë së Kosovës realizuar më 19.02.2016)

[110] Hyseni worried about the tendency in the Kosovo's society for radicalization [Hyseni i shqetësuar me tendencën e radikalizimit të shoqërisë në Kosovë]http://klankosova.tv/hyseni-i-shqetesuar-me-tendencen-e-radikalizimit-te-shoqerise-ne-kosove/, 28.07.2015

[111] Interview with Besa Ismaili, professor at the Faculty of Islamic Science – Prishtina, CVE coordinator for working with women, conducted on 21.03.2016 (Intervistë me Besa Ismaili, profesor në Fakultetin e Shkencave Islame - Prishtinë, koordinator i CVE për punët me gratë, e realizuar më 21.03.2016)

[112] Interview with official from the Kosovo Security Council, conducted on 19.02.2016 (Intervistë me zyrtar nga Këshilli i Sigurisë së Kosovës realizuar më 19.02.2016)

[113] Interview with official from the Kosovo Security Council, conducted on 19.02.2016 (Intervistë me zyrtar nga Këshilli i Sigurisë së Kosovës realizuar më 19.02.2016)

Grupet radikale janë vërejtur në një numër më të lartë duke vepruar kryesisht në qytetet dhe fshatrat kufitare. Pavarësisht nga kjo, deri më tani një model i themeluar ende nuk është identifikuar, ku luftëtarë të huaj punojnë së bashku në drejtim të organizimit të sulmeve apo rekrutimit. Në mënyrë të ngjashme, nuk ka pasur asnjë operacion të përbashkët të policisë MK-KOS nga asnjëri nga këto dy shtete kundër një grupit rekrutues potencial[114].

Në një sondazh në Kosovë, 57 për qind e të anketuarve muslimanë kanë deklaruar se ata i besojnë Bashkësisë Islame të Kosovës[115]. Ndërkaq, argumenti kryesor në vitin 2014 se pse të anketuarit ishin më pak të predispozuar t'ju besojnë institucioneve përfaqësuese fetare ishte i lidhur me paaftësinë e tyre për të parandaluar depërtimin e lëvizjeve ekstremiste në Kosovë. Qëllimi i vërtetë i institucioneve sipas të anketuarve ishte që të keqpërdorin një fe të veçantë për një agjendë të caktuar politike[116]. Me shfaqjen e ekstremizmit të dhunshëm, numri i zërave që kritikojnë institucionet fetare është rritur. Më herët, qytetarët nuk kanë pasur guximin të sfidojnë autoritetin e institucioneve fetare[117].

Që nga muaji prill 2015, Kuvendi i Kosovës ka miratuar një projekt-ligj që ndalon qytetarët e Kosovës të marrin pjesë në luftëra të huaja, si pjesë e ushtrive të huaja, policisë, apo formacioneve paraushtarake. Është vendosur se personat e shpallur fajtorë për këto krime do të burgosen deri në pesëmbëdhjetë vjite dhe të humbasin shtetësinë e tyre[118]. Deri në janar të vitit 2015, rreth tetëdhjetë ekstremistë të supozuar, për të cilët është dyshuar se kanë luftuar në Irak dhe Siri ose se kanë rekrutuar luftëtarë të huaj, janë arrestuar në Kosovë[119]. Është e rëndësishme të përmendet se kjo ishte një nga akcionet më të mëdha të policisë në rajon kundër ekstremizmit të dhunshëm. Megjithatë, kjo është vënë në dyshim nga ana e popullatës lokale, pasi që autoritetet liruan 60% të të arrestuarve pas procesit gjyqësor, për shkak të mos qenit në gjendje për t'i ndjekur penalisht në mënyrë efikase ose për shkak

[114] Ibid

[115] Kelmendi, Vese; KOSOVO SECURITY BAROMETER Kosovar Centre for Security Studies Special Edition: The citizens' views against violent extremism and radicalization in Kosovo http://www.qkss.org/repository/docs/Raporti_final_CVE-Barometri_anglisht_583308.pdf, pg. 12; June 2016 (Kelmendi, Vese: BAROMETRI KOSOVAR I SIGURISË Qendra kosovare për studime të sigurisë Edicion special: Mendimi i qytetarëve rreth ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizimit në Kosovë, fq. 12, Qershor 2016)

[116] http://www.qkss.org/repository/docs/Kosovo_Security_Barometer_-_Fifth_Edition_523670.pdf pg 17

[117] Kelmendi, Vese; pg. 15, June 2016 (Kelmendi, Vese; fq. 15, Qershor 2016)

[118] The Law on the Prohibition of Joining Armed Conflicts Outside State Territory: https://www.mpb-ks.org/repository/docs/LIGJI_NR._05_L_002_PER_NDALIMIN_E_BASHKIMIT_NE_KONFLIKTE_TE_ARMATOSURA_JASHTE_TERRITORIT_TE_VENDIT.pdf (Ligji për ndalimin e bashkimit në konflite të armatosura jashtë territorit të vendit)

[119] *Kosovo Police Arrest 40 Suspected ISIS Fighters*, CBN News (Aug. 11, 2014), http://www.cbn.com/cbnnews/ world/2014/August/Kosovo-Police-Arrest-40-Suspected-ISIS-Fighters/. (Policia kosovare arreston 40 luftëtarë të dyshuar të ISIS)

të mos qenit në gjendje të procesojnë dëshmitë dhe të ngrejnë padi në përputhje me rrethanat[120].

Bashkësia Fetare Islame (BFI) e Kosovës nuk ka kontroll mbi të gjitha xhamitë[121] dhe kjo mund të jetë problematike, pasi që propaganda ekstremiste mund ende të përhapet në mesin e vizitorëve të këtyre xhamive, dhe kur kjo ndodh në zonat rurale ku qytetarët lokalë kanë vetëm ato xhami për të vizituar, kjo e bën edhe më të vështirë për të ndikuar deri te këto komunitete me kundër-mesazhe.

Sipas një OJQ-je lokale në Kosovë, KIPRED, reagimi i qeverisë ndaj fenomenit të radikalizmit ka qenë shumë i vonshëm. Duke filluar në vitin 2006, disa imamë kanë filluar të promovojnë ideologji radikale në Kosovë. Këta imamë nuk janë mbajtur përgjegjës fare. Një çështje tjetër që mund të ketë kontribuar në reagimin me vonesë është se Kosova nuk kishte një agjenci të inteligjencës deri në vitin 2009, ndikimi i së cilës konsiderohet të jetë i madh. Administrimi ndërkombëtar është akuzuar shpesh gjatë kësaj kohe për mos shkëmbim të informacionit në mënyrë të mjaftueshme me policinë e Kosovës[122].

Një pyetje që lind shpesh është shkalla e ekspozimit të njerëzve ndaj propagandës radikale. Edhe pse operacionet e policisë janë treguar të suksesshëm në frenimin e bashkimit të më shumë luftëtarëve të huaj me grupet ekstremiste në Siri apo Irak, besohet se rekrutuesit ekstremistë mund ta kenë ndryshuar vetëm mënyrën se si ata veprojnë[123].

Autoritetet zyrtare dhe OShC-të në Kosovë dhe Shqipëri deklarojnë se askush nuk i është bashkuar ISIS-it për më tepër se një vit. Megjithatë, vala e parë e luftëtarëve të huaj të kthyer ka arritur më në vendet e Ballkanit Perëndimor. Sipas një sondazhi në Kosovë, mbi 51% e të anketuarve i konsiderojnë luftëtarët e huaj të kthyer si një kërcënim, pasi ata kthehen nga fusha të betejës dhe niveli i tyre i radikalizimit nuk është i njohur.

Gjithashtu nuk dihet nëse ata pendohen që i janë bashkangjitur ISIS-it ose cili është motivi i tyre për t'u kthyer. Sipas ekspertëve të CVE-së në Kosovë, sa më shumë përcjellës këto ideologji të dhunshme kanë, aq më të rrezikshme janë[124]. Këto grupe do të fokusohen në konsolidim dhe organizim më të mirë, dhe ndërkaq në të njëjtën kohë ende mungojnë programe të deradikalizmit në Kosovë dhe në rajon, duke i dhënë liri radikalizmit të lulëzojë[125].

---

[120] Report Inquiring Into the Causes and Consequences of Kosovo Citizens' Involvement as Foreign Fighters in Syria and Iraq http://www.qkss.org/repository/docs/Shkaqet_dhe_pasojat_e_perfshirjes_se_qytetareve_te_Kosoves_si_luftetare_te_huaj_ne_Siri_dhe_Irak_820753.pdf, pg.7, April 2015. (Shkaqet dhe pasojat e përfshirjes së qytetarëve të Kosovës si luftetarë të huaj në Siri dhe Irak; fq.7, Prill 2015)

[121] IRC admits that has two mosques out of control [BIK-u pranon se dy xhami i ka jashtë kontrolli] http://www.telegrafi.com/bik-u-pranon-se-dy-xhami-ka-jashte-kontrolli/, 16.02.2016

[122] Interview with Lulzim Peci Executive Director of Kosovar Institute for Policy Research and Development (KIPRED), conducted on 19.02.2016 (Intervistë me Lulzim Peci Drejtor Ekzekutiv i Institutit kosovar për kërkime dhe zhvillime të politikave KIPRED realizuar më 19.02.2016)

[123] Ibid

[124] Ibid

[125] Ibid

Mësimet kryesore që vijnë nga rajoni janë se çdo përpjekje për trajtimin e çështjes së ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizmit duhet të plotësohet me përfshirjen e komuniteteve dhe me debat më të gjerë publik mbi këtë çështje. Kosova është një shembull që ka mbulim shumë të zhvilluar në media për këtë çështje si dhe debate televizive të shumta në të cilat marrin pjesë ekspertë, udhëheqës fetarë dhe institucione shtetërore ku flitet për çështjen e luftëtarëve të huaj dhe ekstremizmin e dhunshëm.

Shoqëria civile në Kosovë gjurmët e ideologjisë radikale i gjen te sirianët/afganët/jemenasit, apo individë të tjerë me pasaporta evropiane që kanë ardhur së bashku me organizatat humanitare në periudhën pas luftës dhe kanë ofruar ndihmë financiare, ose kurse të ndryshme, të cilat shpeshherë kanë qenë të përziera me ligjerata fetare që kanë përkrahur një praktikë më të rreptë të Islamit[126].

Një çështje tjetër që mund të jetë arsyeja se pse BFI e Kosovës po humb kredibilitetin në mesin e besimtarëve të saj është se ajo vepron kryesisht me para të gatshme, gjë që krijon një boshllëk shtesë në sigurimin e llogaridhënies dhe ngre dyshime se si paraja është përdorur. Përveç kësaj, fakti se asnjë ligj specifik nuk është miratuar për të kontrolluar institucionet fetare në Kosovë gjithashtu kontribuon në mungesën e përgjithshme në lidhje me funksionimin e tyre[127].

Besohet se ideologjitë ekstremiste do të mbeten në rajon për të ardhmen e parashikueshme, pasi që Kosova do të përballet me një numër në rritje të luftëtarëve të huaj që do të kthehen[128]. Besohet se situata do të jetë e ngjashme në të gjitha vendet e Ballkanit.

4.5 Shqipëria

Në Shqipëri kriminalizimi i pjesëmarrjes në luftëra të huaja ka paraparë dënim me burg për qytetarët shqiptarë që marrin pjesë në një konflikt ushtarak jashtë vendit në kohëzgjatje prej më shumë se dhjetë vjet burgim[129].

Fenomeni - luftëtarë të huaj në Shqipëri është pasojë e një fenomeni kompleks i radikalizmit. Studimi i IDM-së ka hetuar tetë fusha në Shqipëri, ku disa prej tyre të vendosura në rajonet kufitare pranë Maqedonisë dhe Kosovës[130]. Megjithatë, studimi nuk mund të identifikonte strukturë përsëritëse të ndikimit të esktremizmit të dhunshëm në shtetet fqinje.

---

[126] Interview with NGO representative working on security issues in Kosovo, conducted on 19.02.2016 (Intervistë me përfaqësues nga OJQ që punon në sektorin e sigurisë realizuar më 19.02.2016)
[127] Ibid
[128] Ibid
[129] *Prison for Albanian Jihadists*, Gazeta Shekulli Blog (Feb. 25, 2014), http://www.gazetashekulli.org/ 2014/02/25/prison-for-albanian-jihadists/. (Burgim për xhihadistët shqiptarë, Gazeta Shekulli Blog (Shkurt 25.2014)
[130] Interview with Gjergji Vurmo Program Director of Institute for Democracy and Mediation (IDM) Albania, conducted on 10.03.2016 (Intervistë me Gjergji Vurmo Drejtor i programit në Institutin për demokraci dhe ndërmjetësi (IDM) Shqipëri, realizuar më 10.03.2016)

Bashkësia fetare islame në Shqipëri ka bërë përparime të mëdha gjatë 20 viteve të fundit. Megjithatë, ka ende një numër sfidash dhe shqetësime që po përballet - duke filluar me kthimin e pronave dhe çështje (të pamjaftueshme) të lidhura me financa, kapacitetet e klerikëve vendas (duke përfshirë teologjike) dhe aftësitë për t'u përballur radikalizmin dhe esktremizmin e dhunshëm, apo edhe një "luftë e fshehur për fuqi" përbrenda e cila ka shkaktuar që marrëdhëniet e tensionuara në mes të përfaqësuesve të rangut më të lartë dhe imamëve lokal[131].

Që nga kriminalizimi i pjesëmarrjes në luftëra të huaja në Shqipëri, 9 persona janë burgosur mbi akuzën për rekrutim apo pjesëmarrje në luftëra të huaja në Siri apo Irak[132]. Krahasuar me Maqedoninë, imamët e arrestuar në Shqipëri ende deklarojnë besimin e tyre publikisht dhe bëjnë deklarata pro-ISIS gjatë seancave gjyqësore, poashtu edhe mbështetësit e tyre vijnë në seancat gjyqësore dhe haptazi shprehin mbështetjen e tyre. Në Maqedoni të gjithë të arrestuarit për pjesëmarrje në luftëra të huaja apo rekrutim u deklaruan fajtorë dhe bënë marrëveshje me zyrën e prokurorit publik për dënime më të buta, por mbetet e panjohur se çfarë ishin pazaret me autoritetet[133].

Luftëtarët e huaj u kthyen në Shqipëri kryesisht para miratimit të ligjit që kriminalizon pjesëmarrjen në konfliktet e huaja, por besohet se ka pas raste që janë kthyer pas ndryshimit të Kodit Penal.[134]. Megjithatë, askush në Shqipëri nuk ka qenë i dënuar për pjesëmarrje në luftëra të huaja, pasi që shumica e luftëtarëve të huaj shkuan në Siri përpara kriminalizimit të pjesëmarrjes në luftëra të huaja, ndërsa nëntë personat e arrestuar, duke përfshirë edhe dy imamë të vetëshpallur, janë dënuar për lehtësim dhe financim të rekrutimit të terroristëve, por asnjëri prej tyre nuk është dënuar për pjesëmarrje në luftëra të huaja[135].

Reagimi fillestar ndaj ekstremizmit të dhunshëm ishte të koncentrohen të gjitha përpjekjet në aparatin e sigurisë, por si zhvillohej fenomeni, institucionet e sigurisë në Shqipëri modifikonin veprimin e tyre, gjë që mund të vërrehet nga hapja e tyre deri tek CshOtë dhe lejimi i përfshirjes së tyre në shumë aktivitete të luftës kundër ekstremizmit të dhunshëm.

---

131 Ibid

132 Albania jails nine men for recruiting extremists (Shqipëria arreston nëntë persona për rekrutim të ekstremistëve) http://english.alarabiya.net/en/News/world/2016/05/04/Albania-jails-nine-men-for-recruiting-extremists.html.,04.05.2016

133 "Cell Case, the accused of participating in a foreign war pleaded guilty" (Akcioni Qelia, të akuzuarit për pjesëmarrje në luftë të huaj pranuan fajësinë) http://www.akademik.mk/sluchaj-kjelija-obvinetite-za-uchestvo-vo-stranska-vojska-ja-priznaa-vinata/ , 16.05.2016 qasur për here të fundit më 06.07.2016

134 Intervistë me përfaqësues nga Shoqëria Civile në Shqipëri

135 Spahiu, Ebi; "Jihadist Threat Persists in Kosovo and Albania Despite Government Efforts" http://www.jamestown.org/programs/tm/single/?tx_ttnews[tt_news]=45551&tx_ttnews[backPid]=26&cHash=7bb1f7dcd9ed286befd58d41eca40db4#.V3zxEut97Dd, 24.06.2016 last time accessed on 06.07.2016 (Spahiu, Ebi; "Kërcënimi xhihadist vazhdon në Kosovë dhe Shqipëri pavarësisht përpjekjeve të Qeverive" qasur për herë të fundit më 06.07.2016)

Besohet se 70% e luftëtarëve të huaj janë kthyer brenda 3 muajve pas largimit të tyre, për shkak të zhgënjimeve rreth asaj që u është premtuar dhe atë që kanë hasur sapo kanë arritur atje[136]. Mendohet se ISIS ka ndikim të kufizuar në Shqipëri pasi presioni i familjes zakonisht konsiderohet të jetë i fortë dhe për shkak se imamët të cilët përhapnin propagandë u emëruan shumë herët dhe u dënuan publikisht. Mungesa e debateve publike në temën e ekstremizmit të dhunshëm, si në rastin e Maqedonisë, lejon që imamët e dyshimtë të forcojnë ndikimin e tyre dhe të vazhdojnë të përhapin mesazhet e tyre të dëmshme dhe të kultivojnë ekstremistë potencial.

Që nga viti 2014, sipas autoriteteve asnjë shtetas shqiptar nuk ka shkuar në Siri. Megjithatë, Bashkësia Islame në Shqipëri, edhe pse ka rifituar xhamitë që ishin nën kontrollin e ekstremistëve, ende është duke luftuar për t'iu kundërvënë ndikimit ekstremist, pasi ajo është raportuar të ketë kredibilitet të dyshimtë në mesin e ndjekësve të vet dhe shpesh është akuzuar për korrupsion[137].

Në Shqipëri, Strategjia për parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizimit ka planifikuar që Ministria e Çështjeve Sociale të jetë në krye të të gjitha aktiviteteve de-radikalizuese të planifikuara si pjesë e strategjisë.[138]

Megjithatë, kjo strategji nuk e sheh BFI-në në Shqipëri si aktor kryesor në deradikalizim dhe si e tillë, ajo ka marrë kritika nga shoqëria civile për mospërfshirje të mjaftueshme të komunitetit fetar. Çdo zgjidhje duhet të jetë përshtatur në një mënyrë që do të përfshijë BFI, kryesisht në identifikimin e xhamive (vendeve në rrezik) që ata mendojnë se kanë nevojë për më tepër aktivitete deradikalizimi.

Siç tregohet në rastin e Shqipërisë, institucionet e zbatimit të ligjit kanë efektin e përhapjes së frikës për rekrutuesit e mundshëm, dhe kjo është arsyeja pse më shumë fushata sensibilizuese duhet të mbahen në mesin e qytetarëve në lidhje me implikimet ligjore me të cilat do të përballen në qoftë se ata vendosin t'ju bashkohen grupeve të llojit Al-Nusra ose ISIS[139] .

---

[136] Interview with ex-foreign fighter http://www.oranews.tv/vendi/terrori-frika-e-botes-se-re-sonte-ne-2045-ne-te-te-paekspozuarit/, 19.11.2015 last time accessed on 06.07.2016 (Intervistë me një ish luftëtar të huaj; 19.11.2015; qasur për here të fundit më 06.07.2016)

[137] Spahiu, Ebi; “Jihadist Threat Persists in Kosovo and Albania Despite Government Efforts” http://bit.ly/29kKPLH, 24.06.2016 last time accessed on 06.07.2016 (Spahiu, Ebi; "Kërcënimi xhihadist vazhdon në Kosovë dhe Shqipëri pavarësisht përpjekjeve të Qeverive" qasur për herë të fundit më 06.07.2016)

[138] Strategy on Prevention of Violent Extremism and Radicalization Leading to Terrorism 2015-2020, Republic of Kosovo, http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/STRATEGY_parandalim_-_ENG.pdf (STRATEGJIA PËR PARANDALIMIN E EKSTREMIZMIT TË DHUNSHËM DHE RADIKALIZMIT QË SHPIE NË TERRORIZËM 2015 –2020, Republika e Kosovës)

[139] Interview with Ebi Spahiu, independent researcher on radicalization and foreign fighter phenomenon in Albania, conducted on 10.02.2016 (Intervistë me Ebi Spahiu, hulumtues i pavarur i fenomenit të radikalizimit dhe luftëtarëve të huaj në Shqipëri, realizuar më 10.02.2016)

5. Risocializimi dhe riintegrimi

Një nga sfidat më të mëdha të fenomenit të luftëtarëve të huaj është çfarë do të bëhet me këta individë, kur të vendosin të kthehen në shtëpi. Frika se këta individë paraqesin një kërcënim për shoqërinë është rritur nga sulmet e kryera nga ish-luftëtarë të huaj, si sulmi në muzeun hebre në Bruksel më 24 maj 2014[140], i kryer nga një francez i cili kishte luftuar në Siri një vit. Një nga vështirësitë kryesore të kësaj teme është fakti se ajo polarizon shoqërinë në përgjithësi. Ka nga ata që besojnë se ish-luftëtarët e huaj nuk mund të riintegrohen në shoqëri dhe madje edhe bëjnë thirrje për të vendosur një ndalesë për ta për të hyrë përsëri në vend. Në anën tjetër, ka nga ata që besojnë se këta individë mund të riintegrohen plotësisht në shoqëri.

Numri i ish-luftëtarëve të huaj dhe ekstremistëve të dhunshëm të cilët janë kthyer në Maqedoni është në rritje, respektivisht 86[141], në korrik të vitit 2016. Për shkak të vështirësisë së mbledhjes së provave për individët të cilët kanë udhëtuar në Siri, dëshmitë që mund të përdoren në gjykata shpeshherë janë të pakta. Si rezultat i kësaj, prokuroria nuk mund çdoherë të ngrejë padi, ose nganjëherë, paditë bien poshtë.

Procesi i risocializimit dhe riintegrimit ofron një zgjidhje alternative për ata individë të cilët nuk mund të ndiqen, por ende konsiderohen si potencial për t'u bërë ekstremistë të dhunshëm[142]. Për më tepër, ky proces është i rëndësishëm jo vetëm për njerëzit që nuk mund të ndiqen penalisht, por edhe për njerëzit që janë të dënuar me burg. Këta individë mund të tentojnë t'i përhapin idetë e tyre të dhunshme në burg, dhe mund të paraqesin rrezik, madje edhe kur përfundimisht të largohen nga burgu.

Risocializimi mund të përshkruhet si "një, ndërhyrje qëllimisht e planifikuar, që synon të ndryshojë karakteristikat e të akuzuarit (qëndrimet, aftësitë dhe proceset njohëse, shëndeti mendor dhe shpirtëror dhe aftësitë sociale, arsimore ose profesionale) që besohet të jetë shkaku i sjelljes kriminale të individit, me synimin për të reduktuar mundësinë që individi të përsërisë të njëjtën[143]". Programet risocializuese dhe riintegruese përfshijnë një element njohës (një ndryshim në bindjet dhe qëndrimet, për çka shpesh përdoret termi deradikalizim) dhe një element të sjelljes (ndalimin e aktivitete të dhunshme, për çka shpesh përdoret termi

[140] The New York Times. "Suspect held in Jewish museum killings" (I dyshuari I vrasjeve në muzeun Hebre mbahet) . 1 qershor, 2014. E qasur më 13 korrik, 2016. http://nyti.ms/2emxUvG

[141] Webfaqja e Presidentit të Republikës së Maqedonisë. "Fjalim nga Presidenti Ivanov" 22 qershor 2016. Marrë më 13 korrik 2016. http://www.president.gov.mk/mk/2011-06-17-09-55-07/2011-07-19-10-40-39/3849.html

[142] Qendra ndërkombëtare kundër terrorizmit – Hagë. 'Rehabilitim për luftëtarët e huaj?' Dhjetor 2015. Marrë më 14 korrik 2016. http://icct.nl/wp-content/uploads/2016/01/ICCT-Entenmann-Heide-Weggemans-Dorsey-Rehabilitation-for-Foreign-Fighters-December2015.pdf

[143] Qendra ndërkombëtare kundër terrorizmit – Hagë. 'Dizajnimi i programeve rehabilituese dhe riintegruese për të akuzuarit për ekstremizëm të dhunshëm'. Mars 2012. Marrë më 13 korrik 2016. http://www.icct.nl/download/file/ICCT-Veldhuis-Designing-Rehabilitation-Reintegration-Programmes-March-2012.pdf

mosangazhim[144]). Individët të cilët janë aktivë në aktivitete të dhunshme mund të heqin dorë nga rruga e dhunës, por ende i ruajnë bindjet e tyre. Programet risocializuese kanë për qëllim të lehtësojnë kthimin e një individi në shoqëri.

Programet e suksesshme duhet të kombinojnë trajtimin e dimensioneve të ndryshme të qëndrimeve, sjelljeve dhe lidhjeve shoqërore në mënyra shumë kreative[145]. Grupet ekstremiste janë të rëndësishme për individët në shumë fusha, si formimin e identitetit, ndërtimin e komunitetit, ndjesia se i përkasin një kauze më të lartë, ndjenja e sigurisë dhe kështu me radhë. Të gjitha këto fusha duhet të trajtohen.

Kur është fjala për diskursin publik në risocializimin e luftëtarëve të huaj, është e rëndësishme të theksohet se në debatet parlamentare në Republikën e Maqedonisë, gjatë diskutimit rreth miratimit të mjeteve ligjore për luftimin e fenomenit të luftëtarëve të huaj, një pjesë e deputetëve kanë qenë skeptikë për mundësinë e luftëtarëve të huaj t'i kthehen jetës normale në shoqërinë e Maqedonisë[146].

Silvana Boneva (Deputete nga VMRO-DPMNE): Autorët e këtyre krimeve nuk duhet të lejohen të kthehen në Maqedoni për shkak se ata nuk mund të risocializohen.

Roza Topuzovska Karevska (Deputete e pavarur): Nuk mund të pritet që ata persona që kanë qenë pjesë e krimeve të tilla, pas kthyerjes në Maqedoni, do të mund të jenë të përshtatshëm për këtë shoqëri.

Aktualisht në Maqedoni nuk ka asnjë program aktiv për risocializimin dhe riintegrimin e luftëtarëve të huaj që janë kthyer dhe do të kthehen në të ardhmen. Deri më tani, autoritetet maqedonase kanë dënuar 12 persona të akuzuar për bashkangjitje në organizata të huaja paraushtarake ose për financim dhe rekrutim për këto organizata. Këta individë do të jenë në kontakt me të burgosurit tjerë, të cilët veçmë janë më të ndjeshëm ndaj ideve radikale, dhe ka të ngjarë të përpiqen t'i bindin ata për t'i përhapur idetë e tyre. DSK-ja ka ndihmuar autoritetet e burgut në zhvillimin e një regjimi të veçantë në burg për shkelësit ekstremistë. Me këtë regjim, DSK-ja shpreson ta parandalojë radikalizimin e shumë të burgosurve.[147]

Mungesa e programeve për risocializimin dhe riintegrimin e luftëtarëve të huaj të kthyer në Republikën e Maqedonisë është përmendur edhe në Departamentin e ShBA-ve për Raporte

[144]Qendra ndërkombëtare kundër terrorizmit – Hagë. 'Rehabilitim për luftëtarët e huaj?' Dhjetor 2015. Marrë më 14 korrik 2016.
http://icct.nl/wp-content/uploads/2016/01/ICCT-Entenmann-Heide-Weggemans-Dorsey-Rehabilitation-for-Foreign-Fighters-December2015.pdf
[145]Tore Bjorgo, dhe John Horgan. 'Të lënit e terrorizmit mbrapa, mosangazhim individual dhe kolektiv' 'https://www.nyidanmark.dk/NR/rdonlyres/82A2FB65-27B0-4129-ACC5-284E2B4F5F43/0/leaving_terrorism_behind.pdf
[146] "Raport nga Komiteti Parlamentar mbi Sistemet Politike dhe Marrëdhëniet Ndër-Etnike." Kuvendi i Republikës së Maqedonisë. 02 shtator 2014.
[147] Intervistë me një funksionar të lartë të DSK-së, e realizuar më 19.07.2016, Shkup

Shtetërore të Vendit mbi Terrorizmin 2015[148]. Një shqetësim tjetër është fakti se burgjet në Maqedoni nuk ofrojnë ndonjë program të çfarëdollojtë për rehabilitimin e njerëzve që gjenden aty[149], gjë që tregon se do të jetë edhe më e vështirë për ta për të krijuar një program për rehabilitimin e ekstremistëve.

Në fillim të vitit 2015, ka pasur një përpjekje nga ana e komunitetit fetar islamik për të futur një program që do të kishte mbështetur luftën kundër paragjykimeve shoqërore me të cilat ballafaqohen ish luftëtarët e huaj, dhe veçanërisht familjet e tyre. Projekti u quajt STOP-RAD Terr, dhe përveç pjesës kryesore, që përqëndrohej në luftimin e radikalizmit, ky projekt synonte gjithashtu të sigurojë ndihmë për familjet e luftëtarëve të huaj në Maqedoni.[150]

Sa i përket pjesës së projektit që trajton risocializimin dhe riintegrimin, pas gjetjes së shumë familjeve që kanë humbur mbështetjen e mbajtësit kryesor të familjes së tyre (për shkak të faktit se më së shpeshti meshkujt i bashkangjiten ISIS-it apo Al Nusra-s) projekti është fokusuar në ofrimin e ndihmave humanitare këtyre familjeve, respektivisht nevoja themelore, ushqim apo pajisje higjienike.[151]

Qëllimi i dytë i projektit ishte trajtimi i çështjes se familjet e luftëtarëve të huaj shpesh janë të stigmatizuara nga shoqëria. Ato përballen me stigmatizim në punësimin e tyre në sektorin privat, ku kompanitë private refuzojnë t'i punësojnë këta persona për shkak të frikës se mund të kenë probleme me autoritetet shtetërore, pasi ata besojnë se duke punësuar një person që ka një anëtar të familjes në Siri apo Irak, do të bëhen cak i mundshëm për agjencitë e inteligjencës të cilat mund t'i konsiderojnë ata se kanë lidhje ose mbështesin grupet ekstremiste.[152]

Ndonjëherë në shoqëri mbizotëron ideja shqetësuese se anëtarët e familjeve të luftëtarëve të huaj mund të radikalizohen, dhe shumë familje vuajnë nga ky paragjykim, edhe pse zakonisht ata nuk janë të radikalizuar. Anëtarë të shumë familjeve kanë folur kundër këtij paragjykimi shumë herë publikisht. [153]

Një çështje tjetër që projekt propozimi i BFI-së synonte ta prekë ishte gjendja psikologjike e familjeve të luftëtarëve të huaj. Këto familje kanë nevojë për mbështetje psikologjike nga

[148]Departamenti i Shtetit i ShBA-ve, Byroja për Antiterrorizëm dhe Antiekstremizëm të Dhunshëm. "Raportet e Vendit mbi Terrorizmin 2015". Marrë më 13 korrik 2016. http://www.state.gov/j/ct/rls/crt/2015/257516.htm

[149] Intervistë me profesor universitar të shkencave juridike, intervista e bërë më 15 mars, 2016

[150] Kreu i BFI-së takohet me ambasadorin Bejli http://koha.mk/aktuale/35162-kreu-i-bfi-takohet-me-ambasadorin-bejli.html, publikuar më 05.02.2015. Marrë më 19.07.2016.

[151] Nga projekt-propozimi "Stop Rad Terr" nga Bashkësia Fetare Islame e Maqedonisë dhe organizata humanitare Hilal.

[152]Gjetjet nga fokus grupi me të rinjtë në Shkup, ku një nga pjesëmarrësit rrëfeu se si babai i tij kishte refuzuar të punësojë një fqinj për shkak të faktit që personi kishte një vëlla që shkoi për të luftuar në Siri. Fokus grupi në Shkup u mbajt më 18.05.2016 në ambientet e Analytica Think Tank.

[153] Babai i vajzës së radikalizuar flet për mosbesimin e tij se fëmija i tij ka shkuar në Siri – "Një vajzë 18-vjeçare i është bashkangjitur ISIS-it" http://www.telegrafi.com/vajza-18-vjecare-nga-kumanova-i-eshte-bashkangjitur-isis-it/ publikuar në korrik 2015, së fundmi qasur më 19.07.2016

profesionistë, pasi që disa prej tyre mund të kenë humbur familjarët e tyre në Siri apo Irak, dhe disa prej tyre jetojnë në frikë të vazhdueshme nga çfarë mund të ndodhë me të dashurit e tyre që janë radikalizuar dhe u janë bashkangjitur grupeve ekstremiste për të luftuar.[154]

Përveç frikës dhe problemeve të tjera shëndetësore, të tilla si depresioni dhe ankthi, me të cilat mund të përballen, rreziku që këto familje ende mund të vihen në shënjestër nga rekrutuesit e mundshëm, është shumë i lartë. Ky rrezik rritet veçanërisht kur këto familje kanë më shumë anëtarë meshkuj të moshës luftarake. Rreziku se meshkujt e tjerë nga familja, si prindërit apo vëllezërit e motrat, mund të radikalizohen gjithashtu, është shumë i lartë, pasi që të afërmit e tyre që tashmë janë në Siri apo Irak mund të jenë duke u përpjekur për t'i bindur që t'u bashkangjiten. [155]

Radikalizimi i vëllezërve dhe motrave, e veçanarisht vëllezërve ka qenë dukuri e zakonshme. Shembuj të tillë mund të gjenden në shumë raste famëkeqe sulmesh, të tilla si sulmet në Paris, sulmet maratone të Bostonit dhe shumë të tjera që janë kryer nga vëllezër[156]

Dimensioni tjetër i radikalizimit është kur njëri prej bashkëshortëve radikalizon tjetrin. Të tilla raste kemi kur një partner është në Siri, dhe kërkon nga partneri tjetër që t'i bashkangjitet, dhe, në këto raste, ata zakonisht i marrin edhe fëmijët me vete. Në Maqedoni ka informacione për tri familje, ku etërit kanë marrë familjet e tyre, duke përfshirë edhe fëmijët.[157]

Në mënyrë që këto familje të pajisen me argumentet e nevojshme kundërshtuese dhe mekanizmat se si të ballafaqohen me çështjen e të pasurit një anëtar të familjes të radikalizuar, janë të nevojshme programe të forta deradikalizuese. Deri më tani, në Maqedoni, projekti nga BFI-ja ka trajtuar vetëm çështjen e anëtarëve të familjeve të luftëtarëve të huaj, por në temat e diskutimit nuk përfshihen edhe luftëtarët e huaj të kthyer në Maqedoni. Në ligjin që kriminalizon pjesëmarrjen në luftëra të huaja për qytetarët e Maqedonisë, qeveria maqedonase në mënyrë të qartë ndalon çdo kontakt me ish-luftëtarët e huaj, pasi që çdo kontakt që nuk raportohet tek autoritetet shtetërore, mund të shihet si një akt bashkëpunimi, gjë që do ta inkriminojë personin.[158]

Prandaj, edhe BFI në vitet e fundit është përballur me vështirësi në kryerjen e aktiviteteve efektive të deradikalizmit. Ata përballen me një situatë ku ish-luftëtarët e huaj janë duke u shtyrë më tej në margjinat e shoqërisë, ose duke u izoluar totalisht ose duke u fshehur për shkak të kufizimeve ligjore që miqtë dhe familjarët e tyre të mos mundem t'u

---

[154] Nga projekt-propozimi "Stop Rad Terr" nga Bashkësia Fetare Islame e Maqedonisë dhe organizata humanitare Hilal.

[155] LIDHJET QË BASHKOJNË: SI I KEQPËRDORIN TERRORISTËT LIDHJET FAMILJARE https://www.ctc.usma.edu/posts/the-ties-that-bind-how-terrorists-exploit-family-bonds , publikuar më 19.02.2016. Së fundmi qasur më 19.07.2016

[156] Vëllezërit që punojnë bashkë në emër të terrorit. Përse kaq shumë? http://www.latimes.com/world/europe/la-fg-terror-brothers-20160323-story.html , publikuar më 23.02.2016. Së fundmi qasur më 19.07.2016

[157] Intervistë me një funksionar të lartë të DSK-së, e realizuar më 19.07.2016, Shkup

[158] Neni 322-a (6)

afrohen lirshëm. Kjo padyshim ka ndikim në zbulimin e atyre personave dhe vlerësimin e efektit të tyre në radikalizimin e mëtejshëm të të tjerëve.

Projekti i BFI-së nuk kishte mbështetje institucionale dhe nuk ka arritur të sigurojë mjetet financiare për zbatimin e tij. Edhe pse deri më tani nuk është identifikuar ndonjë veprim konkret, Presidenti, në fjalimin e tij vjetor presidencial, u ka bërë thirrje të gjitha institucioneve për të siguruar mbështetje për BFIM-në në luftimin e kësaj dukurie.[159]

Strategjia për luftën kundër terrorizmit për Maqedoninë, e miratuar në mars të vitit 2016, ka trajtuar në pika të shkurtra aktivitetet parandaluese dhe mundësitë për programet e deradikalizimit. Këto janë fragmente nga strategjia, se si adresohet deradikalizmi dhe parandalimi.[160]

- Maqedonia ka sanksionuar si vepër penale pjesëmarrjen në ushtri dhe formacione paraushtarake të huaja, por kërkon masa të vazhdueshme për funksionalizimin e saj. Paralelisht me masat parandaluese, do të marrë masa për riintegrimin e tyre në shoqëri.

- Aplikimi i masave dhe aktiviteteve komplekse arsimore, ekonomike, sociale dhe të sigurisë për të rritur ndërgjegjësimin e publikut dhe rezistencën ndaj faktorëtve motivues dhe mjeteve që nxisin radikalizimin;

- Zhvillim dhe zbatim të projekteve për deradikalizmin e individëve tashmë të radikalizuar, si dhe projekte për rehabilitimin/riintegrimin e ish-terroristëve

- Marrja e masave për të parandaluar radikalizimin në burgje.

- Ngritja e vetëdijes së qytetarëve dhe sektorit privat në luftën kundër terrorizmit dhe promovimin e tolerancës dhe mirëkuptimit publik të të gjitha llojeve të terrorizmit;

- Përforcimi i mendimeve të moderuara mbi ato ekstremiste, gjë që do të sigurojë që mendimet e ekstremistëve të mos mbizotërojnë. Me përfshirjen e drejtpërdrejtë të shoqërisë civile në promovimin e mendimeve të moderuara, vetëdija se shumica mbështet opinionet e moderuara do të rritet, dhe kjo do të shfaros rrënjët e ekstremizmit.

Siç mund të shihet nga teksti i mësipërm, strategjia rendit mundësitë për të punuar dhe zhvilluar programe të tilla në të ardhmen, por deri tani nuk ka shkuar në detaje se cilat

[159] Fjalimi vjetor i Presidentit për deputetët [ГодишнообраќањанапретседателотИвановпредпратениците] http://www.telma.com.mk/vesti/godishno-obrakjanja-na-pretsedatelot-ivanov-pred-pratenicite, publikuar më 22.12.2015, së fundmi qasur më 19.07.2016

[160] STRATEGJIA NACIONALE E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË PËR TË LUFTUAR TERRORIZMIN, 3.1. Pjesa parandaluese.

institucione do të jenë përgjegjës për kryerjen e këtyre aktiviteteve, kryesisht për shkak se Planet e veprimit ende nuk janë miratuar.

Përveç kësaj, mungesa e Planit të Veprimit për Strategjinë e Luftimit të Terrorizmit në Maqedoni, bën që trajtimi adekuat i kësaj çështjeje të bëhet edhe më i vështirë. Meqenëse nuk ka një institucion të caktuar për secilin aktivitet, nuk është e qartë se si do të ndahen paratë e buxhetit për zbatimin e kësaj strategjie, dhe nuk ka afate kohore brenda të cilëve duhet të zhvillohet çdo aktivitet, kështu që bëhet më e vështirë të dihet koha se kur mund të priten rezultatet, për të parë nëse strategjia është duke përmbushur synimet e saja në kohë.

Duke pasur parasysh se Strategjia Kombëtare për Luftën kundër Terrorizmit ka parashikuar që organet zbatuese të kësaj strategjie të jenë vetëm institucionet e sigurisë, duke përfshirë këtu edhe Ministrinë e Financave dhe departamentit të saj kundër krimit financiar, nuk është e qartë se kush nga këto organe do të jetë përgjegjës për zbatimin e aktivitete të deradikalizmit, pasi që asnjëri prej tyre nuk ka një rol edukativ, ndërsa aktivitetet e strategjisë kanë të bëjnë me arsimin.

Një qasje që zakonisht përdoret në programet e deradikalizmit në vende të tjera në botë është se këto programe ofrohen zakonisht nga organizata të mbështetura nga shteti, të cilat janë të hapura gjatë një periudhe mjaft të gjatë, me qëllim që personat e radikalizuar të kërkojnë vullnetarisht ndihmë prej tyre, ose për familjarët e ndonjë personi të radikalizuar, që të arrijnë deri te këto organizata dhe të kërkojnë ndihmë për të dashurit e tyre. Ato shpesh ofrojnë edhe seanca këshilluese online. Kjo qasje është përdorur nga një organizatë e financuar nga shteti, Hayat, e cila ka qenë partner me Zyrën Federale Gjermane për Çështjen e Emigracionit dhe Refugjatëve, me ç’rast ka mundësuar linjë telefonike kombëtare për këshillim mbi radikalizimin.

Në shembullin e Hayat-it, ekspertët bëjnë analiza dhe vlerësime të rrezikut dhe arrijnë një konkluzion nëse një person është në rrezik për t'u bërë i radikalizuar (në mënyrë të dhunshme). [161]

Pasi që këshilltari të ketë fituar një pamje të qartë të situatës konkrete të një personi të caktuar, projektohet një proces individual i këshillimit dhe një plan i hap-pas-hapshëm, duke përfshirë masa të ndryshme për të parandaluar radikalizimin e mëtejshëm apo për të ndaluar dhe kthyer mbrapa procesin. Këshillimi ofrohet falas, është konfidencial dhe në dispozicion në shumë gjuhë, si gjermanisht, anglisht dhe arabisht. [162]

Është me rëndësi të madhe që Maqedonia të mësojë nga praktikat që kanë treguar disa norma të suksesit, siç është rasti i Hayat-it, dhe se në procesin e luftimin të ekstremizmit të dhunshëm përfshihen komunitetet fetare dhe lokale dhe shoqëritë civile.

[161] Hayat – Program gjerman këshillimi për personat e përfshirë në grupet salafiste radikale http://hayat-deutschland.de/english/
[162] Ibid.

6. Pikëpamje nga rajoni – me fokus kryesor në qytetet e Shkupit, Kumanovës dhe Tetovës

Fenomeni i luftëtarëve të huaj që i bashkangjiten luftës në Siri apo Irak, edhe pse është një sfidë globale, ka prekur Maqedoninë në veçanti. Si pasojë, kjo pjesë e studimit të politikave ka për qëllim të analizojë specifikat lokale, që të gjendet faktori që i nxit shtetasit e Maqedonisë për t'u bashkuar me grupet kriminale, të tilla si ISIS. Në përpjekjen për të fituar një pamje më të qartë të situatës në Shkup, Kumanovë dhe Tetovë, u mbajtën tri fokus grupe me të rinjtë. Është zgjedhur pikërisht kjo grup-moshë për shkak se supozohet se ky grup është epiqendra e shënjestrës së propagandës së ekstremistëve të dhunshëm. Këto qytete janë zgjedhur për shkak të raportimeve të shpeshta për luftëtarë të huaj që vijnë nga këto qytete. Më pak raste janë identifikuar edhe në qytete të tjera në Maqedoni, si në Gostivar, Veles, Strugë dhe në fshatin Labunishtë (zona rurale e Strugës), poashtu në këto qytete është identifikuar edhe një prani në rritje e organizatave me motive fetare.

Fokusi kryesor ishin studentë dhe nxënës të shkollave së mesme, me qëllim që t'i analizojmë perspektivat e të rinjve mbi çështjen e radikalizmit dhe fenomenit të luftëtarëve të huaj. Çështjet të cilat janë trajtuar në fokus grupet ishin "se sa është e informuar rinia rreth radikalizimit dhe ekstremizmit të dhunshëm, nëse kanë qenë në ndonjëfarë mënyrë të prekur nga propaganda të tilla ekstremiste, si për shembull të kenë qenë të kontaktuar nga rekrutuesë potencialë, apo nëse e njohin dikë që ka shkuar në Siri ose ka qenë i radikalizuar?"

Dy nga grupet e fokusit kishin nga 6 pjesëmarrës (me gjini të balancuar), me përjashtim të fokus grupit në Kumanovë ku ka pasur 5 pjesëmarrës (3 meshkuj, 2 femra). Të gjithë pjesëmarrësit ishin studentë universitarë, përveç njërit në fokus grupin në Shkup, i cili ishte nxënës i shkollës së mesme në vitin e fundit. Në fokus grupin në Shkup, katër prej pjesëmarrësve ishin nga komuna e Çairit, ndërsa dy të tjerë ishin studentë nga Fakulteti i Shkencave Islame në Shkup, por ishin me origjinë nga Kumanova dhe Velesi. Të gjithë pjesëmarrësit në të gjitha grupet e fokusit ishin shqiptarë etnikë, dhe diskutimet janë zhvilluar në gjuhën shqipe.

Grupi i pyetjeve të përpiluara për studentët ishin pyetje të përgjithshme si: si i konsiderojnë ata kushtet socio-ekonomike në qytetet e tyre, çfarë mundësish ka për të rinjtë, me çfarë sfida përballen ata në qytetet e tyre, dhe cilat janë nevojat më urgjente për ata si të rinj.

Pjesa e dytë e pyetjeve ishte e fokusuar rreth njohurive të tyre në lidhje me fenomenin e radikalizmit, se sa ata e kuptojnë atë, çfarë mendojnë se nënkupton kjo, njohuritë e tyre mbi ekstremizmin e dhunshëm, dhe se si do t'i njihnin shenjat e radikalizimit.

Së fundi, pyetjet e fundit ishin të përqendruara mbi përvojën e tyre të dorës së parë me organizata të dyshimta, në çfarë mënyrë u janë qasur ata njerëz, nëse njohin dikë personalisht nga rrethi i tyre i ngushtë shoqëror që ka shkuar në Siri apo Irak, ose në qoftë se njohin dikë që është izoluar nga miqtë e tyre, sepse, për shembull, janë orientuar më shumë kah feja, ose

për shkak të dukjes së tyre, për shembull kanë lëshuar mjekrën, ose për femrat, mbajnë mbulesë në kokë, e që është raportuar shpesh si një arsye për të rinjtë të jenë të diskriminuar.

Më tej, janë zhvilluar intervista me dy të rinj nga qyteti i Shkupit, të cilët kanë qenë të pranishëm në xhamitë, që më parë ishin jashtë kontrollit të BFI-së. Këto dy të rinj kishin pasur rast shpeshherë të bisedojnë me miq dhe njerëz që i kanë njohur, të cilët janë përpjekur t'i bindin ata që të pranojnë interpretime të ndryshme të fesë duke pretenduar se ato janë të saktat.

Do të paraqitet një përshkrim i gjetjeve për çdo qytet, ku do të përfshihen edhe specifikat lokale që janë identifikuar aty dhe cilat modele kanë tendencë për t'u përsëritur.

Nga fokus grupet doli një gjetje e paparashikueshme: se shumica e pjesëmarrësve njihnin dikë që kishte shkuar në Siri apo Irak apo dikë që ka një anëtar të familjes që është bërë luftëtar i huaj.

Niveli i ulët i besimit në institucionet shtetërore dukej se ishte mendim i përbashkët, të cilin e ndanin të rinjtë e të gjitha fokus grupeve, një mosbesim i veçantë u shpreh në lidhje me pyetjen mbi aftësinë e institucioneve shtetërore për të bërë një ndryshim në ndalimin e dukurisë së ekstremizmit të dhunshëm.

Në këtë pjesë, të gjitha gjetjet, edhe nga fokus grupet, po edhe nga intervistat individuale, janë të strukturuara për çdo qytet veçmas, në mënyrë që të njëjtat të jenë më gjithëpërfshirëse dhe për ta shmangur përputhshmërinë me njëra-tjetrën.

Shumica e të rinjve mendonin se shteti favorizon një fe, para të tjerave (Krishtërizmin Ortodoks, të cilit besim i përkasin shumica e maqedonasve etnikë, dhe e vë atë para Islamit, me të cilën identifikohen shumica e shqiptarëve, së bashku me pakicat tjera si turqit, boshnjakët dhe myslimanët etnikë maqedonas). Shembujt që janë vënë në dukje ishin se shteti sponsorizon ndërtimin e ndërtesave kishtare dhe financimin e aktiviteteve të kishës, ndërsa Bashkësia Islame nuk merr asnjë financim nga shteti.

Të gjithë pjesëmarrësit e kanë theksuar çështjen e papunësisë së të rinjve dhe mungesën e mundësive për të rinjtë shqiptarë, si mungesa e sallave sportive, kinema dhe ngjarje kulturore. Në përgjithësi, vërehet një ndjenjë e të qenit të përjashtuar nga shoqëria.

Në pyetjen rreth diskriminimit të mundshëm në bazë fetare, shumica e pjesëmarrësve janë përgjigjur negativisht, duke theksuar se diskriminimi etnik mbizotëron mbi atë të fesë. Diskriminimi në bazë fetare duket të jetë më i ashpër vetëm kundër grave myslimane që janë të mbuluara, zakonisht në vendin e punës, pasi që rrallë herë ndodh që mbulesa të pranohet në punë. Poashtu ishin identifikuar edhe raste kur femrat e mbuluara myslimane kanë qenë temë e talljes dhe ngacmimeve nga profesorët në universitetet shtetërore. Përveç kësaj, janë vërejtur edhe raste të femrave të mbuluara myslimane që kanë qenë të penguara në marrjen e vendeve të punës në administratën publike kombëtare ose si infermiere në spitalet shtetërore.

Në asnjë nga fokus grupet nuk kemi identifikuar mbështetje për grupet e dhunshme ekstremiste si ISIS apo Al Nusra, ose për idenë për vajtje në Siri. Shumica e pjesëmarrësve ishin të mendimit se atyre që kanë qenë në Siri apo Irak duhet t'u jepet një mundësi e dytë, ndërsa nuk ishin dakord për të njëjtën dispozitë për rekrutuesit.

Raste të grave të Maqedonisë që janë radikalizuar ose kanë shkuar në Siri nuk janë mbuluar edhe aq shumë nga mediat, megjithatë ca raste janë identifikuar gjatë fazës së hulumtimit në terren.

Deri në korrik të vitit 2016, janë identifikuar katër raste të grave që janë radikalizuar:

1. Një vajzë 18-vjeçare nga Kumanova kishte shkuar në Siri në fillim të vitit 2015. Thuhet se ajo ishte martuar me dikë, pasi kishte shkuar atje. Sipas babait të saj, i cili foli në një intervistë për mediat lokale, vajza e tij fliste me një vajzë nga Kosova, para radikalizimit të saj, ndërsa në kompjuterin e saj janë gjetur video të propagandës së luftës. Është raportuar edhe nga nxënëxit e klasës dhe shokët e saj se ajo kishte shikuar këto lloje videosh, derisa ka qenë në shkollë.[163]

2. Një grua nga Struga, një maqedonase etnike, ishte konvertuar në Islam në një nga vendet e Evropës Perëndimore dhe ishte kthyer në Maqedoni në qytetin e saj të Strugës para se të udhëtonte për në Siri. Ky është një tregues i qartë se jo vetëm shqiptarët i bashkohen ISIS-it, por edhe grupe të tjera etnike, për të cilët feja e tyre e parë nuk është Islami. [164]

3. Një vajzë e re nga fshati Haraçinë, Shkup, në të 20-tat e hershme të saj kishte tentuar të shkojë në Siri. Ajo kishte arritur në Stamboll, kur babai i saj dhe të afërm të tjerë, të cilët kishin zbuluar planet e saja, ia kishin ndërprerë rrugën. Atë e kishte zbuluar vëllai i saj duke biseduar me një shqiptare tjetër nga Maqedonia, që asokohe kishte qenë në Siri, dhe e cila kishte pranuar të bëhet nusja e një luftëtari të huaj. Ky rast i radikalizimit ka ndodhur vetëm nëpërmjet internetit. Nuk dihet nëse familja e ka raportuar këtë rast tek organet shtetërore, por ka gjasa që mos ta kenë bërë, pasi që ata mund të kenë qenë të frikësuar nga paragjykimi shoqëror, me çka do të kishte mundur të ballafaqohet vajza e tyre, në qoftë se kjo gjë ishte bërë e njohur publikisht.[165]

4. Dhe, së fundmi, dy vajza nga zonat rurale të Shkupit, në janar të vitit 2016 kishin tentuar të shkojnë në Siri. Këto vajza së pari kishin udhëtuar për në Prishtinë, ku xhaxhai i një prej vajzave i kishte ndjekur dhe i kishte kthyer në shtëpi. Vajzat

[163] Vajza 18 vjeçare nga Kumanova i është bashkangjitur ISIS-it http://www.telegrafi.com/vajza-18-vjecare-nga-kumanova-i-eshte-bashkangjitur-isis-it/, publikuar në mars 2015, së fundmi qasur më 23.07.2016

[164] Intervistë me Agron Vojnika, Drejtor I Marrëdhënieve Publike në BFI, Shkup, realizuar më 04.04.2016

[165] Intervistë me familjarët e vajzës nga fshati i Haraçinës, Shkup, realizuar më 16.05.2016

> nuk pranuan të diskutojnë se kush ishte njeriu me të cilin ato kishin qenë në kontakt ose të japin ndonjë informacion më të hollësishëm se ku kanë qëndruar në Prishtinë. Megjithatë, të dyja pranuan se kishin pasur synim për të shkuar në Siri, dhe të dyja vajzat kanë qenë të mitura në kohën kur kanë tentuar të ikin. Një nga vajzat është raportuar nga njëri prej prindërve, si person i zhdukur, por nuk dihet nëse prindërit kanë vazhduar me raportimin edhe më tej, në mënyrë që të zbulohet rasti plotësisht nga autoritetet shtetërore të Kosovës, ose autoritetet maqedonase, por edhe kësaj here, paragjykimi dhe frika sociale se me çfarë implikime ligjore do të përballeshin, madje mund të kenë kontribuar që këto raste të mbeten të paraportuara.[166]

Të dhëna statistikore për rastet e luftëtarëve të huaj për çdo qytet veçmas nuk mund të merren nga institucionet e sigurisë për shkak se të njëjtat llogariten si informata të klasifikuara[167], gjë që do të pengonte ndonjë analizë të ardhshme nga ana e shoqërisë civile, që, përndryshe, mund të bëjë sugjerime dhe të kontribuojë në përpilimin e zgjidhjeve më të mira në bazë të specifikave lokale.

Rastet e luftëtarëve të huaj nga Maqedonia të cilët kanë vdekur në Siri kryesisht raportohen nga mediat që kanë ardhur deri tek një informacion i tillë nëpërmjet anëtarëve të familjes.

Disa nga rastet për të cilat kanë shkruar mediat janë:

1. Rasim Zeqiri nga Gostivari - ky ishte rasti i parë i raportuar për një luftëtar të huaj nga Maqedonia i cili është vrarë në Siri. Ai besohej të ishte në të njëzetat e tij. [168]

2. Sami Abdullahu nga Shkupi - ish-luftëtar i UÇK-së, ai ka qenë imam në Bremen, Gjermani. Vdekja e tij është raportuar në gusht të vitit 2013.

3. Adnan Rexhepi nga Kumanova - ish-luftëtar i UÇK-së që nga viti 2001. Rexhepi më parë kishte qenë i dënuar me 4 vjet burg për një vendosje të një bombe në Kumanovë, proces ky për të të cilin ai kishte deklaruar se kishte qenë i montuar. Vdekja e tij është bërë e ditur nga mediat në maj të vitit 2014.[169]

---

[166] Intervistë me familjarë të njërës nga vajzat, nga zonat rurale të Shkupit, që kan folur për këtë rast, realizuar më 18.01. 2016

[167]Ministria e Punëve të Brendshme, Informacione të siguruara duke përdorur Ligjin për qasje të lire në informatat publike, dërguar më 21.12, kërkesa nr. 214/15

[168] Shqiptari nga Gostivari vritet në Siri [Shqiptari nga Gostivari vritet në Siri] http://www.telegrafi.com/shqiptari-nga-gostivari-vritet-ne-siri/; publikuar në vitin 2013

[169] Edhe një tjetër shqiptar vritet në Siri, këtë herë nga Kumanova http://www.oranews.tv/vendi/tjeter-shqiptar-vritet-ne-siri-kete-here-nga-kumanova/; publikuar më 13.05.2014

4. Sadik Xhemaili nga Gostivari - Xhemaili ishte 24 vjeç. Është raportuar se ai kishte shkuar në Siri duke udhëtuar së pari në Shqipëri[170]. Ky i ri kishte vdekur në janar të vitit 2015, pasi kishte kaluar një vit e gjysmë në Siri.

5. Bashkim Bela nga Shkupi - Bela ishte 23 vjeç. Është raportuar se ai ishte vrarë në korrik të vitit 2014.[171]

Fuad Mustafa nga Shkupi - në të 20-tat e hershme të tij, Mustafa ishte viktima e fundit, që ka rënë duke luftuar për ISIS-in.[172]

Këto raste janë vetëm një pjesë e luftëtarëve të huaj që besohet të jenë vrarë në Siri apo Irak, por këto raste ishin vetëm rastet që janë bërë të ditur publikisht në media. Një fakt i veçantë që mund të vërehet është se deri në fillim të vitit 2013 kemi mundur të identifikojmë edhe luftëtarë të huaj më të vjetër që kanë luftuar për UÇK-në në vitin 2001, dhe të dy rastet e përmendura më lart shprehin motivet e tyre të bazuar thjesht në solidaritet ndaj popullit sirian kundër regjimit të Asadit, duke dashur të kontribuojnë për të ndaluar vrasjen masive të civilëve. Më vonë, pasi që evuloi ISIS-i, mund të vërehet se grupa e targetuar për luftëtarë të huaj në Maqedoni janë bërë të rinjtë në të 20-tat e hershme, pa aftësi të mëparshme për të luftuar, e që kryesisht janë bashkuar me motive ekstremiste.

[170] Siri, vritet në luftë për xhihad 24 vjeçari, shqiptar i Maqedonisë [Siri, vritet në luftë për xhihad 24 vjeçari, shqiptar i Maqedonisë] http://www.oranews.tv/rajoni/siri-vritet-ne-lufte-per-xhihad-24-vjecari-shqiptar-i-maqedonise/; publikuar më 28.01.2015

[171] Vritet në Siri Bashkim Bela nga Shkupi [Vritet në Siri Bashkim Bela nga Shkupi] http://koha.net/?id=27&l=16314; publikuar më 02.07.2014

[172] Edhe një shqiptar vdes si xhihadist në Siri [Edhe një shqiptar vdes si xhihadist në Siri] http://lajmpress.com/edhe-nje-shqiptar-vdes-si-xhihadist-ne-siri/; publikuar më 30.06.2016

6.1 Shkup

Në qytetin e Shkupit, në bazë të regjistrimit të vitit 2002, 28.6% e të gjithë popullsisë në Shkup janë myslimanë, me atë që shumica e tyre janë shqiptarë etnikë.[173]

Bashkësia Fetare Islame (BFI) ka bërë thirrje publike deri tek autoritetet shtetërore për të ndërmarrë diçka në lidhje me xhamitë që kanë ndërprerë së qeni nën kontroll të BFI-së, për shkak të angazhimit të imamëve të vetëshpallur.[174] Besohej se këta imamë predikonin një version të Islamit që sipas tyre ishte i ndryshëm nga ai që predikon BFI-ja, që është në përputhje me Shkollën Hanefi të jurisprudencës islame.[175]

Predikimi i imamëve të vetëshpallur bën thirrje për praktikim më rigoroz të fesë dhe u bën thirrje besimtarëve që të mos e njohin bashkësinë zyrtare fetare dhe imamët e tyre, duke i quajtur ata të devijuar nga feja, dhe duke pretenduar se vetëm versioni i tyre i Islamit është i saktë dhe i vetmi që duhet ndjekur.[176]

Këta imamë kryesisht tërheqin grupe të rinjsh të gjinisë mashkullore, dhe zakonisht predikojnë në kafene, bodrume, ose në xhami zyrtare, si në Xhaminë Jahja Pasha në Shkup. Ka informacion se nëse edhe pas operacionit policor "Celula", predikimi ekstremist është ende i pranishëm. Imamët ekstremistë dhe përcjellësit e tyre presin që imami i BFI-së ta kryejë pjesën e parë të namazit, e pastaj fillon imami që ata e njohin me namazin e tij.[177]

Në kohën kur këto xhami nuk ishin nën kontrollin e BFI-së, thirrjet për t'iu bashkangjitur formacioneve të ndryshme në Irak apo Siri janë bërë zakonisht pas namazit të mbrëmjes. Pas operacionit policor "Celula" këto xhami u vunë nën kontroll të BFI-së dhe për një periudhë të shkurtër kohore, vetëm imamët zyrtarë të BFI-së kanë udhëhequr namazin. Por, pas një kohe të shkurtër, imamët "radikalë" u rishfaqën në këto xhami. Deri më tani, këta imamë "radikalë" nuk janë parë të bëjnë thirrje të drejtpërdrejtë për t'iu bashkangjitur ISIS-it në Siri apo Irak, por pas namazit, ka ligjërata rreth vuajtjeve të muslimanëve në Siri, bombardimeve nga vendet perëndimore, dhe, në përgjithësi, propaganda anti-perëndimore të përcjellura nga shumë teori konspirative për botën perëndimore/Izraelin. Grupet që përcjellin këtë imam në

[173] Popullsia e përgjithshme e Republikës së Maqedonisë në bazë të deklarimin fetar, Regjistrimit Kombëtar 2002 http://www.stat.gov.mk/publikacii/knigaX.pdf, f. 334, 2002

[174] BFI kërkon ndihmë për të kontrolluar xhamitë, MPB-ja thotë se nuk është përgjegjëse - ligje më të rrepta të janë të nevojshme, të dyja palët janë dakord për këtë [ИВЗ бара помош за контрола на џамии, МВР вели не е надлежна – треба построги закони, согласни се двете страни] http://www.akademik.mk/ivz-bara-pomosh-za-kontrola-na-dhamii-mvr-veli-ne-e-nadlezhna-treba-postrogi-zakoni-soglasni-se-dvete-strani-4/; publikuar më 21.08.2014

[175] Intervistë me Agron Vojnika, Drejtor I Marrëdhënieve Publike në BFI, Shkup, realizuar më 04.04.2016

[176] Ibid.

[177] Intervistë me një të ri nga Shkupi, 24-vjeçar, që ka qenë dëshmitar i kësaj shumë here personalisht, intervistë e realizuar në qershor të vitit 2016.

Xhaminë e Jahja Pashës zakonisht nuk janë më të mëdha se 40 persona dhe shumica prej tyre janë meshkuj nën moshën 30-vjeçare.[178]

Imami Rexhep Memishi, i cili është dënuar nën akuzën për rekrutim dhe predikim të ekstremizmit të dhunshëm, kishte predikuar kryesisht në xhaminë Tutunsuz, një xhami e vjetër në Shkup, në lagjen e Gazi Babës, Komuna e Çairit. Pas arrestimit të tij, në këtë xhami kishte filluar të shërbejë një imam nga BFI-ja, por nuk është e qartë se çfarë ka ndodhur me përcjellësit e mëparshëm të Memishit dhe nëse ata ende shkojnë në këtë xhami pas ndryshimit të imamit. Megjithatë, faqja e Facebook-ut e Memishit dhe ligjëratat e tij ekstremiste në YouTube ende janë të qasshme dhe mund të gjenden shumë lehtë. Edhe pse ai është në burg, ende ngarkohen video në kanalin e tij në Youtube "Minber media", për të cilin kanal ekziston edhe një faqe aktive në Facebook, ku shpërndahen ftesa për ligjërata pas namazeve në xhaminë e Jahja Pashës në Shkup.[179] Një shembull i videove të tilla, që mund të gjendet online, është video-ligjërata shqetësuese e Memishit, ku ai flet për Luftën e Sirisë dhe u shpjegon besimtarëve se çfarë është martirizimi (shehid), ku ai thekson se vdekja gjatë mbrojtjes së kufijve të Shtetit Islamik (në video është quajtur Shteti Islamik, e që jodomosdoshmërisht do të thotë ISIS) lufta kundër vrasësve në Siri konsiderohet si akt i martirizimit të shenjtë (nga min 6:35 - 6:59).[180] Ka edhe video të tjera, ku ai në mënyrë të qartë thirret në thëniet e profetit Muhamed për t'i bindur njerëzit duke u dhënë atyre dëshmi fetare se ata duhet të jenë "në vendin Sham (Siri)" nga min. 17:58 - 18:32[181]. Kjo video daton nga qershori i vitit 2013, dhe ende është në dispozicion online, dhe nga komentet mund të shohim që ende shikohet në mënyrë aktive nga njerëzit.

Materiali propagandues i imamit të vetëshpallur, Memishit, edhe pse është e qartë se është një material i vjetër, i njëjti ende shpërndahet në mënyrë aktive në shumë kanale të ndryshme të mediave sociale. Kjo gjë dëshmon edhe më tepër se operacioni "Celula" e ka trajtuar çështjen e ekstremizmit të dhunshëm vetëm pjesërisht. Ai përfshinte arrestimin e rekrutuesve të cilët ishin kryesisht nga Shkupi, por nuk merrej me dëmin që këta njerëz veçmë e kanë shkaktuar. Strategjia anti-terroriste e Maqedonisë trajton çështjen e radikalizmit në internet, por nuk specifikon ndonjë aktivitet që do të përqendrohet në pastrimin e materialeve propagandistike të imamëve/individëve tashmë të dënuar.[182]

---

[178] Ibid.

[179] Faqja e Facebook-ut "Teuhid.NET - Minberi i Teuhidit" http://www.facebook.com/minbermedia dhe kanal përkatës në Youtube https://www.youtube.com/user/minbermedia/ janë llogaritë që janë identifikuar si aktive që e mbështesin imamin e dënuar nga Shkupi, Rexhep Memishi, këto faqe së fundmi janë shiquar më 25.08.2016

[180] Video e Rexhep Memishit: "Lufta e argatëve" [Lufta e argatëve – HUTBE], pjesa e martirizimit nga 6:35-6:59 https://www.youtube.com/watch?v=fRV86JozIF8, video e publikuar më 11 janar 2014, së fundmi qasur më 23.07.2016.

[181] Video e Rexhep Memishit: "Siria mes hadithit dhe realitetit" [SIRIA Mes hadithit dhe realitetit], pjesa për Sham(Sirinë) nga 17:58-18:32 https://www.youtube.com/watch?v=3j77mQlvIWg, video e publikuar më 13 qershor 2013, së fundmi qasur më 23.07.2016.

[182] Strategjia Nacionale e Republikës së Maqedonisë për Luftimin e Terrorizmit. 15 mars 2016.

Një djalë nga Shkupi që viziton xhaminë e Jahja Pashës rregullisht konsideron se në këtë xhami imponohet e njëjta retorikë dhe ideologji ekstremiste si më parë; ndryshimi i vetëm që ai sheh pas operacionit policor "Celula" është se thirrjet për t'iu bashkangjitur ISIS-it më nuk bëhen në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe të hapur nga imamët. Poashtu, mbështetja e përgjithshme për ISIS-in në Shkup ka rënë. Sipas këtij të riu, shumica e debateve që ai dëgjon e përqeshin ISIS-in për shkak se është lëvizje e dhunshme, për përdhunimin e grave dhe veprime të tjera që ata mendojnë se nuk janë në përputhje me atë që Islami i mëson.

Megjithatë, përkrahësit e ISIS-it gjenden ende në numër të madh. Thirrjet për radikalizm dhe mbështetje të ideologjive ekstremiste zakonisht bëhen nga miqtë apo të njohurit pasi të mbarojnë ligjëratat pas namazit. Kjo praktikë zakonisht zhvillohet përmes ndonjë debati teologjik, në të cilin të rinjtë e radikalizuar përpiqen ta përfshijnë këtë djalë të ri, dhe meqenëse njohuritë e tij për fenë janë më të vobekta se ato të atyre, ai shpesh mendon se i humb këta debate.

Ky djalë, në moshë 24-vjeçare, ftohet të shkojë në këto dy xhami në Shkup nga miqtë e tij të ngushtë të cilët ai e përshkruan si besimtarë të rregullt, e jo radikalë apo konservativë, dhe ai shkon në këto xhami për shkak se ato janë më të popullarizuara apo më tërheqëse për shkak të "ligjëratave" që pasojnë pas namazit, të cilat shpesh kanë të bëjnë me zhvillimet sociale në shtet ose ngjarjet politike në nivel global.

Një çështje shqetësuese që ka dalë si përfundim nga të gjitha fokus grupet, edhe në atë në Shkup, është se pothuajse të gjithë pjesëmarrësit (15 nga 17, në Shkup 5 nga 6) njihnin dikë që kishte shkuar në Siri apo Irak, apo dikë që ka ndonjë anëtar të familjes që kishte shkuar në Siri apo Irak.[183]

Një prej pjesëmarrësve në fokus grupet tregoi për një rast në Shkup, ku ishin radikalizuar dy nga miqtë e tij. Ata të dy kishin vizituar rregullisht xhamitë e përmendura. Ata ishin vëllezër dhe njëri nga vëllezërit është aktualisht në Siri, ndërsa vëllai tjetër ka udhëtuar për në Turqi, por kishte ndryshuar mendjen para se të përpiqej të dalë në Siri. Ky vëlla (në moshë 25-vjeçare) është kthyer në Maqedoni dhe ende ndan pikëpamje radikale. Ky pjesëmarrës në fokus grupet beson se ai ende është i radikalizuar, pasi që e sheh atë në xhaminë e Jahja Pashës duke u shoqëruar me imamë që janë të njohur për mos pranimin e autoritetit zyrtar të BFI-së. Poashtu, ai shpesh e lavdëron vëllanë e tij i cili është ende në Siri.[184]

Numri zyrtar i shtetasve të Maqedonisë në Siri, sipas Bashkësisë Fetare Islame të Maqedonisë, për momentin është 140, por besohet se jo të gjithë prej tyre i janë bashkangjitur ISIS-it, ose kanë shkuar për të luftuar në fushën e betejës aktuale. Sipas Bashkësisë Fetare

[183] Gjetje nga fokus grupet me të rinj në Shkup, Kumanovë dhe Tetovë; realizuar prej 18-21maj 2016

[184] Gjetje nga fokus grupet në Shkup, të mbajtura më 18.05.2016 në zyrat e Analytica-s, pjesëmarrësi ishte 22-vjeçar, mashkull, student, me adresë banimi në Komunën e Çairit

Islame, vetëm 20 prej tyre janë luftëtarë të huaj.[185] Pas operacionit policor "Celula", askush nuk ka udhëtuar në Siri apo Irak nga Maqedonia.[186]

Megjithatë, mund të vihet re një dallim në mes të numrit të luftëtarëve të huaj sipas Bashkësisë Fetare Islame dhe numrit të marrë nga institucionet e sigurisë në Maqedoni.

Sipas Bashkësisë Fetare Islame, numrat e dhëna nga shteti mund të jenë më të lartë, sepse ka një tendencë që kjo çështje të politizohet dhe shpesh të keqpërdoret kundër shqiptarëve etnikë duke u përpjekur ta portretizojnë ekstremizmin fetar vetëm si një problem shqiptar. Kjo do të dëmtonte imazhin publik të shqiptarëve, duke i paraqitur ata si problematikë dhe të prirur për terrorizëm. Sipas tyre, kjo gjë bëhet nga partitë politike të krahut të djathtë me qëllim që ata të fitojnë pikë politike.[187]

Nga ana tjetër, me atë që Bashkësia fetare pohon se aktualisht vetëm 20 nga ata persona që kanë udhëtuar në Siri apo Irak janë luftëtarë, vërehet një tendencë nga ana e tyre për ta ulur numrin.

Këto dy informacione të dryshme implikojnë lidhjet e brishta që autoritetet shtetërore i kanë me BFI-në, për ç'arsye edhe ulet mundësia për një luftë kuptimplotë kundër propagandës së ISIS-it. Besimi i ulët mes Bashkësisë Fetare Islame ishte përkeqësuar edhe më tepër në maj të vitit të kaluar, kur zyrat e BFI-së ishin nën një rrethim të armatosur për 14 ditë. Për këtë, Bashkësia Islame i akuzoi autoritetet për shkak se nuk kanë vepruar kundër sulmuesve të armatosur edhe pse u kishin kërkuar zyrtarisht dhe kishin bërë thirrje publike për ta bërë këtë.[188] Si rezultat i kësaj, gjatë asaj kohe punonjësit e BFI-së u detyruan të mos i lëshojnë zyrat e selisë për disa javë, me ç'rast shëndeti i tre punonjësve ishte përkeqësuar.[189]

Mosbesimi në mes të këtyre dy organeve pengon bashkëpunimin dhe shkëmbimin e informacioneve. Poashtu, kjo gjendje lë pasoja në veprimet e përbashkëta për kundërvënie ndaj ekstremizmit të dhunshëm, gjë që ndikon që aktivitetet e tilla të jenë më pak të pranuara

[185] BFI: rreth 140 persona shtetas të Maqedonisë gjenden në Siri dhe Irak [BFI rreth 140 persona shtetas të Maqedonisë gjenden në Siri dhe Irak] http://alsat-m.tv/News/251928/bfi-rreth-140-persona-shtetas-te-maqedonise-gjende-ne-siri-dhe-irak, publikuar më 08.05.2016

[186] Intervistë me një funksionar të lartë të DSK-së. Realizuar më 19.07.2016

[187] Intervistë me Agron Vojnika, Drejtor I Marrëdhënieve Publike në BFI, Shkup, realizuar më 04.04.2016

[188] BFI-ja vazhdon të mbetet e uzurpuar nga Shabani [BFI-ja vazhdon të mbetet e uzurpuar nga Shabani] http://alsat-m.tv/News/192810/bfi-ja-vazhdon-te-mbetet-e-uzurpuar-nga-shabani; publikuar më 08.05.2015

[189] Gjendja shëndetësore e tre punonjësve të BFI-së është përkeqësuar, Shërbimi shëndetësor emergjent ka intervenuar [Влошена здравствената состојба на тројца вработени во ИВЗ, интервенирала Брза Помош] http://fokus.mk/vloshena-zdravstvenata-sostojba-na-trojtsa-vraboteni-vo-ivz-intervenirala-brza-pomosh/; 05.05.2016

në mesin e komunitetit mysliman. Shqetësime të ngjashme janë përmendur edhe gjatë diskutimit në fokus grupet në Shkup.[190]

Në fokus grupin në Shkup, në lidhje me pyetjen "Çfarë mendojnë ata se do të thotë radikalizimi, si do të njihnin ata një person radikal," janë paraqitur përgjigje shumë të ndryshme. Disa nga ato më specifiket ishin:

- Radikalizimi vjen si rezultat i keqinterpretimeve të fesë, kur njerëzit fillojnë t'i kuptojnë gjërat fjalë për fjalë. Për shembull: fjala "luftë" ka shumë kuptime, si lufta kundër egos suaj, kundër shprehive të këqija etj, dhe nuk do të thotë luftim në një luftë të huaj. Vetëm duke ngritur vetëdijen e njerëzve për veten dhe shoqërinë e tyre mund t'i minimizojmë faktorët që çojnë një person për të marrë pjesë në luftë.[191]

- Çdo bisedë që fillojnë, ata gjejnë një mënyrë për ta lidhur me fenë. Kjo është mënyra se si unë do të dalloja nëse një person është radikal apo jo.[192]

- Studentët e Fakultetit të Shkencave Islame thanë se ata do të njihnin një radikal nga mënyra se si ata i qasen fesë.[193]

- Fjala "Islam" do të thotë paqe. Nëse një person është i dhunshëm dhe agresiv, mund të vërehet lehtë nga mënyra se si flet ai/ajo. Shumica e tyre nuk e njohin Islamin, sepse askund nuk mësojnë diçka në lidhje me të .[194]

- Radikalizimi është shfaqur si rezultat i keqinterpretimeve të ajeteve Kuranore dhe Biblike.[195]

- Kur një person ndërhyn në integritetin e një personi tjetër, një gjest i tillë mund të shihet si shenjë e radikalizmit.[196]

[190] Fokus grupi në Shkup, i mbajtur më 18.05.2016 në zyrat e Analytica-s, një vajzë 21-vjeçare, studente nga Shkupi, që jetonte në Komunën e Çairit ka shprehur mosbesimin e saj sa i përket aktiviteteve të ofruara nga shteti për t'u ballafaquar me ekstremizmin e dhunshëm.
[191] Nxënës 19-vjeçar (mashkull) nga shkolla e mesme e ekonomisë në Komunën e Çairit - Shkup, pjesëmarrës në fokus grupin në Shkup, mbajtur më 18.05.2016 në zyrat Analytica-s.
[192] Student 21-vjeçar (mashkull) nga një universitet privat në Komunën e Çairit - Shkup, pjesëmarrës në fokus grupin e Shkupit, mbajtur më 18.05.2016 në zyrat e Analytica-s.
[193] Student 21-vjeçar (mashkull) nga Fakulteti i Shkencave Islame - Shkup, pjesëmarrës në fokus grupin e Shkupit, mbajtur më 18.05.2016 në zyrat e Analytica-s.
[194] Studente 20-vjeçare (femër) nga Fakulteti i Shkencave Islame – Shkup, pjesëmarrëse në fokus grupin e Shkupit, mbajtur më 18.05.2016 në zyrat e Analytica-s.
[195] Ibid.
[196] Studente 22-vjeçar (femër) nga Universiteti Shtetëror në Shkup, poashtu nga Komuna e Çairit, pjesëmarrëse në fokus grupin e Shkupit, mbajtur më 18.05.2016 në zyrat e Analytica-s.

- Njerëzit e radikalizuar mund të njihen nga qasja e tyre në mediat sociale. Për shembull, postimi i komenteve pozitive në Facebook për të shkuar në Siri apo Irak. Nga këto gjëra mund të vlerësoni se si mendon ai person për këto çështje.[197]

Ajo që ne arritëm të vërejmë ishte se shumica e pjesëmarrësve ishin të hutuar se si të përkufizojnë një "radikal" dhe shumica e tyre nuk e shihnin radikalizimin si diçka që është kundër ligjit, vetëm shprehën keqardhjen e tyre për ata individë që izolohen nga miqtë e tyre dhe që ata nuk kontribuojnë në mënyrë aktive në shoqëri.

Ndërsa, sa i përket atyre që i bashkangjiten ISIS-it në Siri apo Irak, ata mendojnë se bëhet fjalë për njerëz të manipuluar që bashkohen për arsye të ndryshme, qofshin ato ideologjike apo financiare. Disa nga komentet më të paharrueshme ishin:

"Unë njoh një mik me të cilin jam shoqëruar tre muaj, dhe me të cilin kemi qenë shumë të afërm. Ai e përshkruan luftën si diçka shumë të këndshme, dhe ai ka dy kushërinj që janë duke luftuar në Siri. Kushërinjtë e tij vijnë shpesh në Shkup dhe ikin përsëri në Siri; nuk dihet se kur janë këtu dhe kur atje. Ky djalosh jeton në lagjen time, ai nuk ka qenë në Siri, por ai më ka pyetur nëse unë dëshiroj të shkoj, dhe ky ishte edhe momenti kur unë kam përfunduar miqësinë me të."[198]

"Unë personalisht kam miq që mbështesin luftën në Siri dhe ISIS-in dhe miq që janë kundër tyre."[199]

Gjatë fokus grupit me studentët në Shkup, kemi vërejtur se pothuajse i gjithë grupi njihte dikë që kishte shkuar në Siri ose dikë që kishte ndonjë anëtar të familjes që kishte shkuar në Siri. Një fakt shumë shqetësues doli në pah: studentët meshkuj kishin qenë të ekspozuar ndaj propagandës së këtyre anëtarëve të familjes, të cilët janë aktualisht në Shkup, duke dëgjuar tregime prej tyre për mënyrën se si kushërinjtë ose vëllezërit e motrat e tyre në Siri jetojnë jetë luksoze tani, në shtëpi me pishina, me makina luksoze dhe kështu me radhë.

Ata të gjithë u pajtuan se mediat sociale luajnë rol në të ushqyerit e ideve ekstremiste dhe duke ndihmuar njerëzit të lidhen me të tjerët që mbështesin ideologjinë ekstreme, por propaganda e mediave sociale nuk ka pasur rol të drejtpërdrejtë dhe nuk ka qenë faktori i vetëm për të bindur dikë që të shkojë në Siri. Kontakti i drejtpërdrejtë me ndonjë rekrutues besohet të jetë shkaku i radikalizmit dhe hapi i nevojshëm për të bindur dikë të shkojë në Siri dhe Irak.

Informacionet e marra nga institucionet shtetërore janë të kufizuara në lidhje me vendndodhjen aktuale të luftëtarëve të huaj ose çfarë po ndodh me ta. Sipas një interviste me

[197] Studente 20-vjeçare (femër) nga Universiteti Shtetëror në Shkup, poashtu nga Komuna e Çairit, pjesëmarrëse në fokus grupin e Shkupit, mbajtur më 18.05.2016 në zyrat e Analytica-s.
[198] Student 21-vjeçar (mashkull) nga një universitet privat në Komunën e Çairit - Shkup, pjesëmarrës në fokus grupin e Shkupit, mbajtur më 18.05.2016 në zyrat e Analytica-s.
[199] Nxënës 19-vjeçar (mashkull) nga shkolla e mesme e ekonomisë në Komunën e Çairit - Shkup, pjesëmarrës në fokus grupin në Shkup, mbajtur më 18.05.2016 në zyrat Analytica-s.

një të ri në Shkup, një luftëtar i huaj, në të njëzetat e hershme të tij, aktualisht është duke jetuar në qytetin e Kaçanikut, në Kosovë për shkak të frikës se do të arrestohet nga autoritetet maqedonase. Ky djalë sapo ka ndihmuar mikun e tij të blejë mallra që do të dërgohen për ish-luftëtarët e huaj. Kjo vetëm thekson rëndësinë e të paturit e një qasjeje rajonale për çështjen e ekstremizmit të dhunshëm, ose të paktën bashkëpunim të mirë bilateral në lidhje me këtë çështje në mes të shteteve fqinje.

Pas operacionit policor "Celula 1" nuk janë vërejtur thirrje të drejtpërdrejta për t'iu bashkangjitur ISIS-it ose për të ikur në Siri për të luftuar. Megjithatë ka pasur një rritje të aktiviteteve që bëjnë thirrje për kyçje më të madhe në fe dhe fushata të ndryshme për ndjekjen e fesë më rreptësisht. Një pasojë e mundshme nga kjo ishte që të tri shkollat e mesme më të mëdha shqiptare në Shkup u përballën me një rënie të konsiderueshme në numrin e studentëve që duan ta festojnë natën e maturës, një mbledhje tradicionale festive në vitin e fundit të shkollës së mesme. Në të kundërtën, ka pasur rritje në numrin e nxënësve që nuk duan ta festojnë natën e maturës për arsye fetare. [200] Shkolla e mesme "Cvetan Dimov" në komunën e Çairit nuk kishte organizuar fare natë festive të maturës, për shkak të faktit se shumica e nxënësve e konsideronin natën e maturës si "haram" (e ndaluar) sipas Islamit.

Sipas një mësimdhënësi nga shkolla e mesme "Cvetan Dimov", kjo situatë ishte rezultat i ca mësimdhënësve të caktuar brenda shkollës që organizonin dhe i udhëzonin nxënësit të ndjekin fenë më rigorozisht, duke mbledhur grupe meshkujsh për të shkuar në ndonjë klasë të zbrazët për t'u falur, edhe pse kjo deklaratë vjen nga një intervistë e vetme me një profesor atje, e që nuk është verifikuar në terren.[201]

Për më tepër, është vërejtur se shpeshherë haptazi bëhet shpërndarja e materialeve promovuese fetare, si broshura, në shumicën e shkollave të mesme shqiptare në Shkup, si në shkollën e mesme profesionale ekonomike "Arseni Jovkov", gjimnazin "Zef Lush Marku", shkollën e mesme profesionale kimike "Marija Kiri-Sklodovska", shkollën e mesme profesionale mjekësore "Dr. Pançe Karagjozov" dhe gjimnazin "Cvetan Dimov". Tri nga këto shkolla gjenden në Komunën e Çairit, me përjashtim të shkollës së mesme të kimisë e cila ka programe në gjuhën shqipe dhe maqedonase dhe gjendet në Komunën e Karposhit dhe shkollën mjekësore "Dr. Pançe Karagjozov", e cila gjendet në Komunën Qendër. Në këtë shkollë mësimi zhvillohet në dy gjuhë. Në këtë shkollë, broshura janë dhënë vetëm për nxënësit shqiptarë, në gjuhën shqipe. Broshura kundër festimit të natës së maturës, bazuar në argumente fetare, janë shpërndarë në mesin e nxënësve të shkollave të mesme. Siç u përmend edhe më lartë, numri i nxënësve që duan ta festojnë këtë mbrëmje është ulur. Është e rëndësishme të theksohet se Ligji për arsimin e mesëm në mënyrë të qartë ndalon organizimin e çdo lloj aktivitetesh fetare në ambientet e shkollave të mesme dhe ka parashikuar gjoba deri në 1600 euro për shkollat që kanë lejuar këtë. Organizata "Thirja

[200] Matura mes 'sfilatës' dhe 'haramit' [Matura mes 'sfilatës' dhe 'haramit'] http://www.magazina.al/matura-mes-sfilates-dhe-haramit/; publikuar më 23.05.2016

[201] Intervistë me një professor nga shkolla e mesme "Cvetan Dimov", intervistë e realizuar më 05.06.2016.

Islame" vetëm në vitin 2016 ka bërë të paktën tri fushata fetare në të gjitha shkollat e lartëpërmendura. Fushatat trajtojnë tema të tilla si se si të falen (Vlera e namazit), që është mbajtur në shkollën e mesme "Zef Lush Marku" - Shkup më datë 27.04.2016.[202] Më parë, të rinjve të kësaj shkolle u janë dhënë broshura kundër kremtimit të Vitit të Ri[203], dhe sipas një pjesëmarrësi nga fokus grupin në Shkup, broshura të tilla shpesh ishin shpërndarë edhe në shkollën e tij "Arseni Jovkov"[204], me ç'rast ai ka folur edhe për mësimdhënësit që përpiqen të identifikojnë nxënësit që janë më shumë të interesuar për fe dhe t'u sugjerojnë atyre nxënësve të ndjekin ngjarje të caktuata fetare. Organizata "Thirja Islame" shpesh ka zhvilluar fushata nëpër shkolla, e që shpesh bëjnë thirrje për një mënyrë më konservative të praktikimit të Islamit, megjithatë është vërejtur se kjo organizatë e afërt me imamin nga Kumanova, Sadulla Bajrami, i cili shpesh është kritikuar për deklaratat e tij të diskutueshme, të tilla si "ata që nuk mund ta falin namazin e së premtes për shkak të punës, duhet ta lënë punën"[205] ose "të studiuarit e degës së drejtësisë është gjest joislamik". Si përgjigje për këto deklarata, kreu i Bashkësisë Fetare Islame të Maqedonisë ka reaguar publikisht duke e gjykuar këtë imam dhe deklaratat e tij të diskutueshme.[206]

6.2 Kumanova

Kumanova është një qytet që ndodhet në pjesën veriore të Republikës së Maqedonisë. Sipas regjistrimit të vitit 2002, rreth 30% e popullsisë së tij janë myslimanë. Ajo kufizohet me komunën e Likovës, një komunë e zonës rurale të Kumanovës që kryesisht përbëhet nga fshatra shqiptare, ku 90% e popullsisë në këtë komunë janë myslimanë. Ky rajon i Likovës është i njohur për një shkallë të lartë të migrimit dhe papunësisë në mesin e të rinjve.

Rasti më tronditës në Kumanovë për një person që është në hapat e radikalizimit, është rasti i vajzës 18-vjeçare e cila besohet se aktualisht ndodhet në Siri dhe është martuar për një luftëtar të huaj.[207]

---

[202] Vlera e namazit 27.04.2016 në Zef Lush Marku ["Vlera e Namazit" (27-04-2016) në ZEF LUSH MARKU] http://www.thirrjaislame.com/thirrja/?p=21300, faqja së fundmi është vizituar më 28.07.2016

[203] Pse "Viti i ri" 16.12.2015 – Shkolla e mesme Zef Lush Marku ["Përse Viti i Ri" 16-12-2015 Shkolla e mesme "ZEF LUSH MARKU"] http://www.thirrjaislame.com/thirrja/?p=19675, faqja së fundmi është vizituar më 28.07.2016

[204] Nxënës 19-vjeçar (mashkull) nga shkolla e mesme e ekonomisë në Komunën e Çairit - Shkup, pjesëmarrës në fokus grupin në Shkup, mbajtur më 18.05.2016 në zyrat Analytica-s.

[205] Imam Bajrami – Nëse nuk mund të shkoni në xhuma, lëreni punën e shtetit [Imami Bajrami: Nëse nuk mund të shkoni në xhuma, lëreni punën e shtetit] http://www.gazetaex-press.com/lajme/imami-bajrami-nese-nuk-mund-te-shkoni-ne-xhuma-lereni-punen-e-shtetit-60189/?archive=1; publikuar më 17.11.2014

[206] Kryetari i BFI-së: Hoxha Bajrami i paguar për ti larguar besimtarët nga islami i vërtetë [Kryetari i BFI-së: Hoxha Bajrami i paguar për ti larguar besimtarët nga islami i vërtetë] http://www.zhurnal.mk/content/?id=1672612242559; publikuar më 26.07.2016

[207] Një vajzë 18 vjeçare nga Kumanova i është bashkangjitur ISIS-it [Vajza 18 vjeçare nga Kumanova i është bashkangjitur ISIS-it] http://www.telegrafi.com/vajza-18-vjecare-nga-kumanova-i-eshte-bashkangjitur-isis-it/; publikuar në vitin 2015.

Përveç këtij rasti, në fokus grupin në Kumanovë, pjesëmarrësit e rinj kanë ndarë pikëpamjet e tyre mbi shkallën e radikalizmit dhe fenomenit të luftëtarëve të huaj. Ata besojnë se ky fenomen nuk është aq i pranishëm tek ta, në krahasim me qytetin e Shkupit, dhe se bëhet fjalë për kryesisht individë të caktuar që për arsye të ndryshme personale janë radikalizuar.[208]

Lidhur me pyetjen se si do të njihnin ata një person që është radikalizuar, kanë mbizotëruar mendime të ngjashme me ato të fokus grupeve të tjera. Mënyra që ata e kanë identifikuar si më e zakonshmja për t'i njohur personat e radikalizuar, ishte mospranimi i mendimeve të të tjerëve gjatë ndonjë bashkëbisedimi me njerëz që mendojnë ndryshe nga ata, sidomos kur bëhet fjalë për tema fetare. Ata pretendojnë se e dinë versionin e vërtetë të Islamit.

"Mjekra e tyre duket ndryshe nga mjekra të tjera që janë në modë, sepse ata nuk kanë mustaqe, gjë që i bën ata të identifikohen se e mbajnë mjekrën për shkaqe fetare, e që nuk është ndonjë shenjë e radikalizimit. Si miq, ne megjithatë i mirëpresim në shoqërinë tonë, por duket sikur ata dëshirojnë të jenë më të izoluar dhe të shoqërohen vetëm me njerëz që janë të ngjashëm me ta, sepse ata nuk e miratojnë mënyrën tonë të jetesës.

"Një tjetër shenjë e radikalizimit është postimi i lajmeve apo videove agresive nga Siria (si prerje të kokës) në profilet e tyre në mediat sociale."

Në lidhje me arsyet pse dikush i është bashkangjitur ISIS-it ose ka shkuar në Siri, shumica e arsyeve të renditura në fokus grupin në Kumanovë ishin të lidhura ose me ideologjinë, pra, këta njerëz e kanë përqafuar fort atë ideologji apo me solidaritetin për popullin sirian dhe qëndrimet kundër regjimit të Asadit. Ndër arsyet tjera të renditura nga ky grup ishin padrejtësia sociale në Maqedoni, ku shteti nuk i trajton në mënyrë të njëjtë dy fetë më të mëdha, dhe është e pranishme tendenca që muslimanët të portretizohen si ekstremistë, por në të njëjtën kohë, ekstremizmi i krishterëve ortodoksë, që shumë herë ndihmohet nga vetë shteti, shihet nëpërmjet gishtave. Si shembull për ilustrim, ata e përmendën kryqin 40-metërsh të lartë në Komunën e Aerodromit në Shkup dhe tjetri në Komunën Butel, që ishte planifikuar të ndërtohet. Në raste të tilla, ata e shohin këtë si provokim dhe i bën të ndjehen të padëshirueshëm në këtë vend.

Një nga pjesëmarrësit në fokus grupin, i riu 18-vjeçar nga Shkupi, që kishte qenë i pranishëm në një ligjëratë nga një imam radikal, siç e quan ai, thotë se të gjitha politikat ditore në shtet përdoren si justifikim për t'i bindur myslimanët se ata janë viktimat në këtë vend dhe se në Siri, apo në shtetin islamik, ata do të kenë liri dhe një jetë të mirë.

Ata kanë nënvizuar nevojën për të pasur dikë që ka qenë në Siri dhe është kthyer përsëri këtu, që të ndajë përvojën e tij me të rinjtë, pasi që ata dëgjojnë një sërë mitesh nga këta imamë apo nga miqtë e tyre, por nuk kanë informacione të besueshme, që do t'i përdornin si argument kundër tyre. Në lidhje me diskriminimin fetar, shumica e pjesëmarrësve u

[208] Gjetjet nga fokus grupi me të rinjtë në Kumanovë, realizuar më 21.05.2016

përgjigjën se ata mendojnë se mund ta praktikojnë fenë e tyre lirisht, por që ndjehen më të diskriminuar në baza etnike, me atë që komunitetet e tjera myslimane në Maqedoni, si turqit dhe boshnjakët, nuk referohen në media si myslimanë në radhë të parë, ndërsa sa herë që ndonjë lajm është i lidhur me shqiptarët, vëmendja bartet më tepër mbi fenë e tyre.

Organizatat që promovojnë ideologji radikale kanë ndikim më të madh mbi të rinjtë që nuk kanë njohuri paraprake rreth Islamit ose që kanë nivel të ulët arsimor, e nganjëherë mbi ata që e kanë braktisur shkollën.

Një mendim që mbizotëronte në mesin e grupit ishte se shteti lufton ekstremizmin vetëm për t'i treguar Perëndimit, si BE-së apo SHBA-ve, se ata janë duke e luftuar atë, por këto operacione kryhen vetëm pjesërisht dhe, në të vërtetë, ky fenomen nuk po luftohet, meqenëse pjesa më e madhe e propagandës është duke u përhapur në mënyrë shumë publike dhe nuk po mbahet në fshehtësi, prandaj mund të thuhet se shteti ka informacione në lidhje me të.

Mungesa e debateve shkollore apo debatet e varfëra në lëndën e filozofisë nëpër shkolla, i lë të rinjtë të mangët në të kuptuarit e fesë dhe rolin e saj, prandaj edhe është e lehtë të manipulohet me ta. Ata besojnë se organizatat ekstremiste janë më mirë të organizuara se çdo organizatë tjetër rinore dhe kjo është arsyeja pse ato kanë treguar sukses më të madh në tërheqjen e më shumë të rinjve.

Sa i përket çështjes së kriminalizimit të pjesëmarrjes në luftëra të huaja, shumica e pjesëmarrësve kanë shprehur shqetësime në lidhje me këtë, pasi që ata besojnë se ish-luftëtarët e huaj janë poashtu viktima, meqenëse shteti nuk ka arritur t'i parandalojë imamët radikalë me predikimet e tyre, por të gjithë janë pajtuar që rekrutuesit duhet të ndiqen penalisht.

Lidhur me pyetjen se kujt do t'i besonin më shumë për të zhvilluar aktivitete për të luftuar ekstremizmin e dhunshëm, kishte përgjigje të ngjashme që silleshin rreth Ministrisë së Arsimit, BFI në bashkëpunim me prindërit. Ata gjithashtu vlerësuan se në këto aktivitete nuk duhet të përfshihen vetëm myslimanët, por edhe komunitetet e tjera fetare, të cilët duhet të mësojnë për Islamin, si dhe, edhe myslimanët duhet të mësojnë për fetë e tjera në Maqedoni, si Krishterizmi, pasi që ata mendojnë se mungesa e njohurive i bën ata më pak tolerant ndaj bashkësive tjera në Maqedoni.

6.3 Tetova

Është një qytet që ndodhet në pjesën perëndimore të Maqedonisë, shumica e popullatës të së cilit janë shqiptarë, konsiderohet se 70% e popullsisë i përkasin fesë islame. Pjesa më e madhe e zonës rurale në rajonin e Tetovës është në komunën e Tearcës, ku 90% e popullsisë besohet se janë myslimanë.

Rajoni i Tetovës shërben si një shembull se edhe pse ka një përqindje të madhe të myslimanëve, numri i luftëtarëve të huaj është i vogël. Edhe pse nuk ka të dhëna statistikore për çdo qytet veçmas, gjatë aktiviteteve kërkimore, në Tetovë nuk janë gjetur raste të rënda të

luftëtarëve të huaj apo propagandë e theksuar ekstremiste, por vetëm raste sporadike dhe përpjekje të organizatave të dyshimta për të instaluar ndikimin e tyre.

Nga fokus grupi me të rinjtë në Tetovë, një studente e re femër përshkroi një rast kur një organizatë kishte marrë me qira një apartament në katin e parë të ndërtesës së tyre dhe kishte filluar t'i ftojë njerëzit që banojnë aty në ligjërata fetare. Pas një kohe shumë të shkurtër, njerëzit që jetonin në atë ndërtesë, ishin organizuar dhe kishin nënshkruar një kërkesë të përbashkët që organizata të dëbohet nga ndërtesa, dhe e kishin arritur këtë gjë.

Rastet e luftëtarëve të huaj që kanë vdekur në Siri apo Irak që vijnë nga qyteti i Tetovës, deri më tani, nuk janë identifikuar publikisht.

Deri më tani vetëm dy persona nga qyteti i Tetovës janë arrestuar për shkak të pjesëmarrjes në luftëra të huaja ose për rekrutimin e luftëtarëve të huaj. I pari është arrestuar si pjesë e operacionit policor "Celula" dhe tashmë është dënuar me 3 vjet e 1 muaj burgim[209], ndërsa personi i dytë nga Tetova është arrestuar si pjesë e operacionit policor "Celula 2". Ai është i akuzuar për pjesëmarrje në një luftë të huaj në Siri apo Irak.[210]

Të njëjtat pyetje janë parashtruar edhe në fokus grupin në Tetovë, se si do të njihnin një person të radikalizuar, nëse kanë pasur përvojë të njohin dikë që është radikalizuar ose që ka shkuar në Siri apo Irak, nëse kanë pasur rast të ftohen për t'iu bashkangjitur atyre grupeve, dhe një pyetje më e përgjithshme, se çka është ajo që ata mendojnë se i çon këta individë drejt radikalizimit dhe për çfarë ndjejnë mungesë ata si të rinj në qytetin e Tetovës.

Përgjigjet që vijnë nga fokus grupi në Tetovë ishin më specifike në krahasim me dy grupet e tjera në Kumanovë dhe Shkup. Në pyetjen nëse ata njohin dikë që kishte ikur në Siri apo Irak, edhe pse shumica e pjesëmarrësve u shprehën se njohin disa persona, nuk bëhej fjalë për raste që ata i njihnin personalisht, por që kishin dëgjuar nga dikush nga rrethi i tyre shoqëror, pa e njohur personin direkt.[211] Në krahasim me grupet në Shkup dhe Kumanovë, pjesëmarrësit e këtij grupi përmendën më tepër individë apo të afërm të njerëzve nga rrethi i tyre i ngushtë shoqëror ose familjar.

